INTERNATIONAL UNIVERSITY OF STRUGA

NR 22/2019

# The Heritage

ISSN 1857-7482
10.21520/R.22-2019

UNIVERSITETI NDËRKOMBËTAR NË STRUGË

Institute for Economic Development and Environmental Management

# THE HERITAGE

REVISTË PERIODIKE

**Nr. 22/2019**

**Editor in Chief**: Msc.Lirinda Vako *l.vako@eust.edu.mk*

**Co- Editor in Chief**: Msc. Abidin Trena *a.trena@eust.edu.mk*

**sEditors**: PhD. Biljana Ciglovska *b.ciglovska@eust.edu.mk,*

PhD. Nazmie Merko – Zabzun *n.merko@eust.edu.mk,*

Msc.Senada Laçka *s.lacka@eust.edu.mk*

**Technical Secretary**: Msc. Rezarta Zhaku – Hani *r.hani@eust.edu.mk,*

## Editorial Bord:

1. **Daniela Pirvu** - University of Pitesti Romania
2. **Peter Mezei** - University of Szeged, Hungary
3. **Fabio Grassi** – Roma di Sapienca University, Italy
4. **Shemshedin Plojovic** – International University of Novi Pazar**,** Serbia
5. **Enver Duran** – Trakya University, R. Turkey
6. **Radoje Radic** – University of Banja Luka, Republic of Srpska
7. **Suzana Bubic** – University of Mostar, Sarajevo
8. **JelenaLekic** –University of Novi Pazar, R. Serbia
9. **Joseph Minsfud** – Emuni University - R. Slovenia
10. **Lorena Bort-Mir -** University Jaume I - Spain
11. **Sonja Keppler -** Allensbach University, Germany
12. **Anahit Formanyan -** Shirak State University Armenia
13. **DariuszWoźniak** - National Louis University, Poland
14. **Ninel Kioseva** - New Bulgarian University, Bulgaria
15. **Violeta Kassarova** - New Bulgarian University, Bulgaria
16. **Vasudeva Rao Aravind** - Clarion University, USA

17. **Mirza Kulenovic** - University College "CEPS - Center for Business Studies", Bosnia and Herzegovina
18. **Selimić Mirzo** - MA in Criminalistics-University College "CEPS - Center for Business Studies", Bosnia and Herzegovina
19. **Nermin Palić** -MA in Traffic Engineering- University College "CEPS - Center for Business Studies", Bosnia and Herzegovina
20. **Džemal Cinac** -MA in Traffic Engineering-University College "CEPS - Center for Business Studies", Bosnia and Herzegovina
21. **Anastas Angjeli, Akademik -** Mediterranean University of Tirana, Albania
22. **Bashkim Rama** -International University of Struga, R. of North Macedonia
23. **Armen Kadriu** -International University of Struga, R. of North Macedonia
24. **Gezim Selimi** -International University of Struga, R. of North Macedonia
25. **Dashmir Nasufi** -International University of Struga, R. of North Macedonia
26. **Shpetim Latifi -** International University of Struga, R. of North Macedonia
27. **Jeton Shaqiri** -International University of Struga, R. of North Macedonia
28. **Guximtar Rushani -** International University of Struga, R. of North Macedonia

INTERNATIONAL
UNIVERSITY OF STRUGA

ISSN 1857-7482

10.21520/R.22-2019

*Botim shkencor i Universitetit Ndërkombëtar në Strugë*

www.eust.edu.mk/Heritage/

Nr.22, 2019

# Contents

PËRFAQËSIMI DHE RRËGULLIMI ME LIGJ I TIJ NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË ..... 5

MONITORING THE IMPLEMENTATION OF REPORTING STANDARDS, AN INSTRUMENT OF THEIR CONTINUOUS IMPROVEMENT ..... 14

KOMUNA SI VETËQEVERISJE LOKALE ..... 22

EMIGRIMI I KAPITALIT NJERËZOR NGA REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT ..... 35

TË DREJTAT E NJERIUT DHE SFIDAT E SË ARDHMES ..... 52

ADVENTAGES AND DISADVENTAGES ON USING VIDEOS IN THE CLASSROOM ..... 64

POLITIKA E ZGJËRIMIT TË BE-SË, SFIDAT E EVROPIANIZIMIT TË R. TË MAQEDONISË (SË VERIUT) PAS MARRËVESHJES TË PRESPËS ..... 71

ZHVILLIMI I MARRËDHËNIEVE EKONOMIKE DHE TREGTARE TË VENDEVE TË RAJONIT TË BALLKANIT ..... 88

DIRECT LEARNING STRATEGIES ..... 95

PARANDALIMI I KRIMINALITETIT ..... 105

# PËRFAQËSIMI DHE RRËGULLIMI ME LIGJ I TIJ NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

**Bsc. Armand Braho**

**(a.braho17@eust.edu.mk)**

**Msc.Amarilda Dule**

**(a.dule@eust.edu.mk)**

**Abstrakt**

Përfaqësimi është një ndër institutet më të rëndësishme në të drejtën civile. Ajo lind në momentin kur një person, ka nevojë imediate që t'ja delegojë të drejtat një personi tjetër, për arsye personale ose ligjore.

Në Republikën e Shqipërisë përfaqësimi është rrëgulluar mjaftë mirë në Kodin Civil të vendit. Në të njëjtin, rrëgullohen me përpikmëri mbartja e të drejtave të përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit, që nga moment që lind kjo marrëdhjënje juridike deri sa ajo shuhet.

Jo në të gjitha ç'ështjet mund të kemi përfaqësues, në të Drejtën Civile, përcaktohen dhe këto raste, që specifikiohen me detaj dhë në këtë punim. Që nënkuptohet se jo gjithçka mund të jetë e drejtë për t'u dhënë për përaqësim. Në këto raste ruhen të drejtat e individit, kryesisht në shprehjen e vullnetit direkt.

Përfqësimin mund ta shohim në tre forma të cilat janë: ( Përfaqësimi Ligjor, Përfaqësimi Statuor dhe Përfaqësimi më Autorizim ( Prokurë ). Të njëtjtat herë janë të drejta të garantuara dhe hërë janë të drejta të dhuruara.

***Fjalë Kyçe:*** *Përfaqësim, E Drejtë, Delegim, Institut.*

## 1 - HYRJE

Punët juridike nënkuptojne çdo shprehje të vullnetit me të cilen krijohet,ndryshohet ose pushon ndonjë marrëdhenie juridike civile.Shprehje të vullnetit përfaqesojnë faktet juridike me të cilat krijohen marrëdhenie të ndryshme juridike , një lloj shprehjeje të vullnetit dallohet për nga efekti këto janë shprehje të vullnetit me të cilën jo vetëm që ndryshohet ndonjë marrëdhënie juridike por me të cilat bartet ndonjë marrëdhënie juridike por me të cilat bartet ndonjë send apo ndonjë vlerë tjetër pasurore nga një pasuri në tjetrën .Nga kjo mund të konstatohet se me punë juridike ,si mjet të qarkullimit juridike ,nënkuptojmë shprehjen e vullnetit e cila krijon të drejta relative.

Në këtë kuadër kur I referohemi punëve juridike padyshim Përfaqësimi nuk është gjë tjetër veçse ndërmarrja e punëve juridike ne emër dhe llogari te huaj .Personi i cili ndërmerr punët juridike në emër dhe në llogari te tjetrit quhet përfaqësues ,ndërsa personi në emër të të cilit ndermerën ato pune juridike quhet I përfaqësari.

Si personat fizik ashtu edhe personat juridik mund të autorizojnë personin tjetër te ndërmarrë punet e caktuara juridike në emër dhe në llogari të tij. Ky lloj perfaqesimi zakonisht behet me shpërblim ,nga edhe quhet perfaqësimi kontraktues . Perfaqesimi ligjor rrjedh nga vete ligji. Të përfaqesuarit janë personat e mitur ,pa zotësi veprimi ,me zotësi veprimi të kufizuar për punë juridike të caktuara ,personat madhorë të cilëve u është vazhduar e drejta prindërore dhe personat madhor të cilëve u është marrë zotesia e veprimit .

## 2 - PËRFAQËSIMI DHE LLOJET E TIJ

Në lëndën E Drejta Civile, përfaqësimi është një marrëdhënje e cila kryhet midis subjekteve të së drejtës. Ndryshe përfaqësimin mund ta kuptojmë si, ***“Prezantim I një subjekti në emër dhë llogari të dikujt tjetër”***[1]**,** Pra shprehimisht ne kuptojmë delegimin e atributeve nga një subjekt tek tjetri. Ku krijohet një marrëdhënje midis ***autorizuesit*** dhe të ***autorizuarit.***

[1] Shih: Fq.181, E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme, Valentina Kondili, 2008

Njëkohësisht "Përfaqësimi" është shprehje e vullnetit direkt të autorizuesit, kundrejt të autorizuarit, në mënyrë deklarative ose kontraktuese në varësi të dispozitave përcaktuese për këtë marrëdhënje juridike. Duhet saktësuar që subjekti i cili merr atributin për të përfaqësuar një subjekt tjetër, mund të mbarti jo më shumë të drejta dhe detyrime seç ka subjekti autorizues. Përkufizimi për përfaqësimin parashikohet dhe në Kodin Civli të Republikës së Shqipërisë, ku shprehimisht thuhet: "***Me përfaqësimin një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuari).***"[2]

Sot ligjërisht njihën tre llojet e ndryshme të përfaqësimit, ku mund të përmëndim:

a) Përfaqësimi Ligjor;
b) Përfaqësimi Statuor;
c) Përfaqësimi me Autorizim;

Të treja format e mësipërme të autorizimit janë shprehje e vullnetit të plotë të palëve për t'u prezantuar në emër dhe logari të një subjekti konformë ligjeve dhe dispozitave positive. Por ç'është Përfaqësimi Ligjor:

## 2 - PËRFAQËSIMI LIGJOR

Përfaqësimi ligjor është një formë direktë e përfaqësimit, ky lloj përfaqësimi është taksativ dhe i detyruar nga ligji. ***"Në këtë rast përfaqësuesi përcaktohet në bazë të ligjit dhe jo në bazë të vullnetit të përfaqësuarit."***[3]Shprehimisht nga nga ky fakt kuptojmë se atributet për përfaqësim krijohen dhe lindin nga ligji, ku palët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara paraprakisht. Në këtë rast nuk këmi të bëjmë më vullnet të dhënë nga i përfaqësuari, por kemi të bëjmë më detyrim të përcaktuar nga ligji.

Një ndër rastet kur kemi të bëjmë më përfaqësim ligjor, është dhe rasti i marrëdhënjes "prind, fëmijë". Ku prindi ka detyrim ligjor, që ta përfaqësoj fëmijën në marrëdhënje me të tretët.

---

[2] Shih: Neni 64 I Kodit Civil, Republika e Shqipërisë, Azhornuar 2017
[3] Shih: Fq. 342 E Drejta Civile, Prof. Dr. Abdulla Aliu, Prishtinë 2013

Deri në moshën e përcaktuar nga ligji, automatikisht prindërit kanë detyrimin për të përfaqësuar fëmijën në mënyrën ligjore.

Ky fakt konfirmohet dhe nga Kodi Civil: ***"I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, është i pazoti për të vepruar. Ai mund të kryejë veprime juridike që i përshtaten moshës së tij dhe që përmbushen aty për aty, si dhe veprime juridike që i sjellin dobi pa asnjë kundërshpërblim. Veprimet e tjera juridike i kryen në emër të tij përfaqësuesi ligjor."***[4]. Në rolin e përfaqësuesit ligjor mund të jetë dhe kujdestari ose mbikqyrësi. Kjo llojë e kalimit të atributeve, bëhët për shkak se (autorizuesi) fëmija, nuk ka aftësi të plotë për të vepruar dhe për të marrë veprime të ndryshme juridike në raport me të tjerët.

Përfaqësimi Ligjor ndërlidhet dhe në raste të tjera ku, detyrimisht i përfaqësuari ligjor, nuk mund të ndërrmari veprime juridike, për shkak kufizimi i aftësisë për të vepruar.

## 3 - PËRFAQËSIMI STATUOR

Me përfaqësim statuor do të kuptojmë, një lloj të delegimit të kopetencave për të përfaqësuar një subjekt nga përfaqësuesi i paraparë në statut. ***"Ç'ështja e përfaqësimit nga ana e organit përkatës të përsonit juridik, rregullohet më statutin e personit juridik ose për disa përsona juridik dhe me ligjin përkatës."***[5]

Për ta thjeshtësuar, nëse marrim një shembull konkret, statuti i një Organizate Joqeveritare përcakton se cili pozicion do të mund ta përfaqësoj këtë subjekt në marrëdhënje me të tretët. Pra, kryetari i një organizate mund të jetë përfaqësuesi i përcaktuar nga statuti për të përfaqësuar organizatën në veprimet e ndryshme juridike që kryhen në emër të po të njëjtës.

## 4 PËRFAQËSIMI ME AUTORIZIM (PROKURË)

Përfaqësimi me prokurë është një ndër format më klasike të përfaqësimit. Në kohën e sotme ky lloj përfaqësimi është tejet i përhapur në karakter të përgjithshëm, i cili haste që tek proçeset

[4] Shih: Neni 8, Kodi Civil, Republika e Shqipërisë, Azhornuar 2017
[5] Shih: Fq 409, Hyrje në të Drejtën Civile, Prof. Dr.Osman Kadriu, Shkup 2009

gjyqësore, ku pala pjesmarrëse në gjykim, autorizon në bazë të ligjit një person qoftë ky fizik apo juridik për ta përfaqësuar në gjykim. Ose dhe raste të tjera, të palëve që janë në procese administrative apo hyjnë në një marrdhënje juridike, ku këta të fundit përfaqësojnë dikë tjetër për ndjekur këto çështje.

Duhet pasur parasysh që kjo mënyrë e përfaqësimit të quhet e ligjshme, duhet detyrimisht që të kryehet në bazë të ligjit, ku mund të përmëndim vullnetin e palës autorizuese të shprehur lirshëm, para organeve ku dhe artohet prokura, pra noterisë. Prokura njihet si mënyra kontraktuale e përfaqësimit, por në raste specifike ajo mund të bëhët dhe në mënyrë deklarative. ***"Prokura, që lind në bazë të deklarimit të vullnetit të të përfaqësuarit përmban autorizimin për përfaqësim që jepet me punë juridike të autorizuarit (kontratë) nga ana e autorizuesit."***[6] Pra nëse shohim, prokura është dhenja e vullnëtit të njëanshëm nga ana e autorizuesit (personit që jep autorizimin), për një person tjetër në aspekt gjeneral ose të posaçëm.

Në Kodin Civil të R.Sh do të shohim se autorizimi (prokura) përkufizohet: ***"Prokura është dokumenti në të cilin i përfaqësuari, me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagreve që i ka dhënë përfaqësuesit."***[7] Që do të thotë se përveç përkufizimit të prokurës, kjo dispozitë përcakton që në autorizim duhet të shprehet dhe "vëllimi i targerave" ose më saktë kapacitetin e kopetencave të deleguara për përfaqësim.

***4.1- Kapaciteti i targrave të dhëna nga autorizimi***

Më sipër folëm në përgjithsi për përfaqësimin me anë të prokurës, shumë e dobishme është dhe korniza e përcaktuar e vullneti të të përfaqësuarit. Duhet thënë se kjo kornizë është e dobishme të drejtat e dhëna si atribut në prokurë të mos keqpërdoren nga ana e të autorizuarit dhe as të mos tejkalohen nga ana e tij.

Prandaj autroizimet ndahen në:

a) Autorizim Gjeneral (mandatum generalis)
b) Autorizim i Posaçëm (mandatum specialis)

---

[6] Shih: Fq. 347 E Drejta Civile, Prof. Dr. Abdulla Aliu, Prishtinë 2013
[7] Shih: Neni 70 I Kodit Civil, Republika e Shqipërisë, Azhornuar 2017

### *4.1.1 Autorizimi gjeneral (mandatum generalis)*

Vetë nga fjala Autorizim Gjeneral do të kuptojmë një lloj të autorizimit të përgjithshëm ku atorizuesi i jep të autorizuarit një sërë targrash për çështje të ndrshme dhe të përgjithshme. ***"Prokura është e përgjithshme kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit tagre për të kryer veprime juridike të shumëllojshme, të cilat kanë të bëjnë me një tërësi të drejtash të të përfaqësuarit, përveç atyre që i ka përjashtuar shprehimisht."***[8]

Nëse siellim një shembull konkret: Autorizuesi i jep të drejtën e përfaqësimit me prokurë të autorizuarit, që ky i fundit të kryej të gjitha marrëdhënjet juridike në lidhje më një pronësi të tijën. Ku mund të përfshihen pagesa e taksave, lidhja e kontratave të tjera në lidhje me të njëjtën pasuri, etj. Por në të gjitha rastete e kalimit të atributeve, kjo marrëdhënje duhet të jëtë kryer në mënyrë kontraktuale që të quhet e ligjshme (de juro), ku aspekti gjeneral të jetë përcaktuar më parë në prokurë . "***Prokura bëhet gjithmonë me shkresë."*** [9]

Në të gjitha rastetet edhe tek përfaqësimi general, së pari duhet që pala ta përcaktoj me detaj, se ç'farë i jep të përfaqësuarit për të përfaqësuar. Nga ana tjetër I përfaqësuari duhet të mos e keqperdori këtë të drejtë të dënë. ***"Natyrisht që dhe tek ky lloj I autorizimit, I autorizuari duhet ti mbrojë interesat e pushtetdhënësit"***[10]

### *4.1.2 Autorizim i posaçëm (mandatum specialis)*

Me këtë lloj autorizimi do te kuptojmë, një lloj të prokurës së posaçme lidhur vetëm më një çështje konkrete. Në këtë lloj autorizimi do të kuptojmë kornizat kufizuese për përfaqësim të një çështje të përcaktuar në aktin noterial (prokurë). ***"Prokura është e posaçme kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit tagrin për të kryer një ose disa veprime juridike të caktuara, që karakterizohen nga një qëllim i përbashkët"***[11]

Në një rast konkret, referuar një Prokure të Posaçme: Autorizuesi i ka dhënë të autorizuarit një sërë të drejtash të kufizuara në klauzolën e prokurës. Psh: të autorizuarit i jepet e drejta për Rregjistrim, kualidim, pagesa për taksat e ndrshme, sigurimin e automjetit dhe të drejtën për të

---

[8] Neni 71 I Kodit Civil, Republika e Shqipërisë, Azhornuar 2017
[9] Neni 72 I Kodit Civil, Republika e Shqipërisë, Azhornuar 2017
[10] Shih: Fq 404, Hyrje në të Drejtën Civile, Prof. Dr.Osman Kadriu, Shkup 2009
[11] Neni 72 I Kodit Civil, Republika e Shqipërisë, Azhornuar 2017

udhëtuar me të njëjtin automjet.[12] Pra të drejtat për të përfaqësuarin janë të kornizuara, ku ky i fundit nuk ka mundësi të shesi automjetin. ***"Prokurë e posaçme është ajo prokurë, që i jepet përfaqësuesit për të kryer një veprim juridik të caktuar."***[13]

## 5 - AFATI I NDËRPRERJES SË AUTORIZIMIT (PROKURËS)

Vërtetë autorizimi është shprehje e vullnetit njëanës të lirë, por nga ana tjetër është dhe shprehja e vullnetit të të autorizuar për ta marrë përsipër një çështje për ta përfaqësuar ose për ti gëzuar atrbutet e saj. Pra të dyja subjektet e autorizimit, (i autorizuari dhe autorizuesi) janë palë direkte të cilat me veprimet e tyre mund te ndërpresin autorizimin. Ndërprerja e autrizimit bëhet në këto raste:

a) I autorizuari ose autorizuesi tërhiqen nga e drejta per të autorizuar apo për t'u autorizuar.
b) Kur njëri nga subjektet humb aftësinë për të vepruar ose vdes.
c) Kur përfundon lënda mbi të cilën është dhënë autorizimi.
d) Kur përfundon afati i paraparë në autorizim, etj.

Shprehimisht në nenin 76 të Kodit Civil citohet: ***"Prokura mbaron kur: a) përfaqësuesi ka kryer veprimet juridike për të cilat ajo ishte dhënë; b) është plotësuar afati për të cilin ajo ishte dhënë; c) kur ka vdekur përfaqësuesi apo i përfaqësuari, ose kur njëri prej tyre ka humbur zotësinë për të vepruar; ç) ka mbaruar personi juridik përfaqësues apo i përfaqësuar; d) kur i përfaqësuari ka shfuqizuar prokurën ose përfaqësuesi ka hequr dorë prej saj. Pas mbarimit të prokurës perfaqësuesi, me kërkesën e të përfaqësuarit duhet t'i kthejë atij aktin e prokurës."***[14]

[12] Prokurë e Posaçme Nr.2051 Rep, Nr 1426 Kol, dt 02.10.2017
[13] Shih: Fq.201, E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme, Valentina Kondili, 2008
[14] Shih: Neni 76 I Kodit Civil, Republika e Shqipërisë, Azhornuar 2017

## 6 RASTET E PËRJASHTUARA NGA PËRFAQËSIMI

Duhet thënë se jo çdo çështje mund ti jepet dikujt për të të përfaqësuar, kryesisht në çështjet të cilat duhet të shprehet vullneti direkt i individit, në mënyrë individuale dhe personalisht në këto çështje është e pa mundur që dikush ti japi të drejtat e tij dikujt tjetër të paraqitet në emër dhe llogari të tij. Në këto raste të prjashtuara nga përfaqësimi është:

a) Testamenti
b) Lidhja e Kurorës
c) Heqja dorë nga shtetësia.[15]

Duhet pasur parasysh që të treja veprimet e mësipërme duhen bërë në individualitet nga personi, dhe ky fundit vetëm në këto raste nuk mund ti delegojë kopetenca askujt tjetër. Sepse për të treja veprimet e mësipërme nuk mundet askush tjetër të përfaqësoj, përveç vetë përsonit.

## 7 - RASTET E PAVLEFSHMËRISË SË TË DREJTËS SË PËRFAQËSIMIT

Duke thënë se garantimi i të drejtave të një individi, duhet kuptuar që dhe në institutin e përfaqësimit kemi raste kur kjo proçedurë rezulton e pa vlefshme, vetëm që të mbrojë individin nga abuzime të mundshme.

E drejta e përfaqësimit kryesisht bëhët e pavlefshme tëk Autorizimi. Duhet thënë se nga që Autorizimi është vullnet i deleguar, në emër dhe për llogari të një personi, është mjaftë e lëhtë të abuzohet me këtë fakt. Kryesisht kjo ndodh kur Autorizimi jepet në momente:

1- Kërcënimi;
2- Lajthimi;
3- Mashtrimi, etj.

Menjëhërë pas verifikimit të këtyre elementeve tek Përfaqësimi me Autorizim, shpallet pavlefshmëria e menjhershme e tij.

[15] Shkëputur nga lekisonet E Drejta Civile Dt.07/05/2019, Lektor Doc.Dr. Sejfulla Osmani.

## KONKLUZION

Në përfundim të këtij punimi, realisht arrita që gjatë këtij punimi të qartësoja dhe argumentoja disa nga elementet më qënjësore të "përfaqësimit" si një ndër institutet e së Drejtës Civile.

Kjo një marrëdhëjne tepër kompakte midis dy ose më shumë palësh, e cila në raste specifike garantohet nga ligji dhe në raste të tjera lidhet si një marrëdhënje kontraktuale midis palëve dhënse dhe mbartëse të detyrimeve ndërmjet (autorizimit).

Sot kjo formë e delegimit të kopetencave është një ndër mënyrat më të mira që palët të përfaqësohen për një ose disa arsye. Shpesh herë përfaqësimi është një mënyrë që palët në vetvete ti thjeshtësohen punët juridike dhë në të tjera raste që palëve ti mbrohen të drejtat dhe detyrimet.

Duhet thënë se te treja mënyrat e përfaqësimit qoftë ai, ligjor, statuor dhe me autorizim sot thjeshtësojnë punën e qindra personave në institucione shtetërore.

**Biblografia:**


- E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme, Valentina Kondili, Geer 2008
- Hyrje në të Drejtën Civile, Prof.Dr. Osman Kadriu, Shkup 2008
- E Drejta Civile, Prof.Dr Abdulla Aliu, Prishtinë 2013
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Azhornuar 2017
- Prokurë e Posaçme Nr 2051 REP, Nr 1426 KOL dt. 20.10.2017
- https://www.osce.org/albania/121115?doënload=true
- Leksionet e D.Civile pranë UNS.

ISSN 1857-7482, Nr. 22, 2019 www.eust.edu.mk/Heritage/

# MONITORING THE IMPLEMENTATION OF REPORTING STANDARDS, AN INSTRUMENT OF THEIR CONTINUOUS IMPROVEMENT

**Ph.D (c) Brikena Tolli**
**(brikenatolli@gmail.com)**
**Marin Barleti University**

**Abstract**

Current practice shows that there are various problems in applying financial reporting standards by for-profit or non-profit entities. Incorrect implementation is related to several factors, including the degree of difficulty in formulating the standards or in other words the lack of comprehensive guidance on their correct application by all entities. The lack of a monitoring structure for their implementation does not allow the field regulator to accurately identify problems in the implementation of standards that are directly related to the standard itself. Nothing would be resolved by a monitoring unit, if it were about an unwillingness or lack of incentives for an entity to present its financial statements in a truthful and reliable manner. There are other mechanisms that need to be incorporated into legal or sub-legal acts that, together with clarity and understanding of standards, would make standards easily and voluntarily enforceable.

In the new law on accounting and financial statements such a competence, the monitoring of financial statements in the light of the implementation of MRS and IFRS, is entrusted to the NQF, but the approach and operating procedures of such an entity are not determined.

This paper aims to analyze the approaches and procedures of some standard drafting bodies in developed countries in Europe with the aim of identifying the most successful international practices that can be effectively applied in our country.

The paper will present an introduction to the problem, a review of the literature on the issue raised for discussion, the findings, and their analysis. In the end the paper ends up with conclusions and recommendations.

**Keywords:** *NAS, IFRS, Financial reporting , Monitoring of IFRS.*

## 1 - HYRJE

Nga problematikat e ngritura në kumtesat e konferencave të KKK, IEKA-s apo shoqatave profesionale spikat shqetësimi se njësitë ekonomike përballen me vështirësi dhe problematika të ndryshme në lidhje me zbatimin praktik të SKK-ve. Kjo për shkaqe të shumta duke përfshirë vështirësitë që erdhën nga ndryshimet në trajtimet kontabël në krahasim me vitet e mëparshme, vështirësitë në interpretim të standardeve të reja, mungesës së informacionit, mungesës së trajnimeve të personelit kontabël që merret me hartimin e PF, pra të një formimi të kufizuar profesional apo mungesë së etikës së punës, etj.

Studimi i gjetjes së shkaqeve të vështirësive të hasura nga njësitë ekonomike në zbatimin praktik të SKK-ve do të ishte një pikënisje shumë e mirë për zgjidhjen e ngërçeve në zbatimin korrekt të tyre.

## 2 - QËLLIMI I STUDIMIT DHE METODOLOGJIA

Me anë të analizës krahasuese të modeleve të ndryshme të aplikuara nga vendet e BE në kërkim të praktikave më të mira, ky studim synon të identifikojë: c**ilët janë komponentët që përcaktojnë një autoritet të suksesshëm monitorues që i përshtatet rastit të Shqipërisë?**

### Rishikim i literaturës

Me ligjin Nr.9228, datë 29.4.2004, ndryshuar me Ligjin Nr. 9477, datë 09.02.2006 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" duke filluar nga 1 janar 2008 për herë të parë hynë në fuqi SKK-të, të cilat përcaktuan parime të përgjithshme kontabël për hartimin e pasqyrave financiare.

Gjithashtu ky ligj ndante njësitë ekonomike në dy grupe, ato të cilat ishin të detyruara në zbatimin e SRNF-ve në hartimin e pasqyrave financiare dhe ato të cilat ishin të detyruara në zbatimin e SKK-ve.

Në vitin 2009 u hartua dhe u publikua nga BSNK[1] një standard i veçantë për njësitë e vogla dhe të mesme (SRNF për NjVM). Kjo qasje duhej aplikuar edhe në Shqipëri, pra të lehtësohej barra e raportimit për grupin e njësive të vogla dhe të mesme. Në vendin tonë

[1] BSNK - Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit

zbatoheshin SKK-të, të cilat ishin hartuar në koherencë me SRNF-të e plota, për të gjitha njësitë ekonomike pa marrë parasysh madhësinë e tyre (mikro, të vogla, të mesme apo dhe shumica prej të mëdhave).

KKK i ndodhur përpara këtij fakti, pas një analize të plotë, doli në përfundimin që SKK-të ekzistuese duhet të rishikoheshin për t'u bërë të krahasueshme me SRNF për NjVM-të. Në përfundim SKK-të ekzistuese u përmirësuan duke përfshirë vetëm ato ndryshime që ishin esenciale dhe duke i dhënë jetë kështu SKK-ve të përmirësuara, të cilat u futën në fuqi në janar të 2015-s. Këto standarde sollën një përmirësim cilësor në hartimin e pasqyrave financiare duke dhënë një informacion më të plotë rreth pasqyrës së pozicionit financiar, pasqyrës së performancës si dhe pasqyrës së mjeteve monetare në përputhje me SNRF-n e re për NjVM-të. KKK publikon për komente çdo ndryshim të SKK-ve. Shoqatat e profesioneve të lira në fushën e kontabilitetit dhe auditimit apo çdo palë tjetër interesi janë të inkurajuar të çojnë komente përpara se çdo standard të publikohet për zbatim. Ata mund të sugjerojnë ndryshime të cilat nëse shikohen të arsyeshme nga KKK mund të reflektohen në standarde. Kjo do të thotë që këto palë interesi janë një laborator i vogël testimi i zbatimit në praktikë të standardeve dhe një motor nxitës që ndihmon hartuesit e pasqyrave financiare në zbatimin korrekt të standardeve.

Deri sot nuk ekziston një autoritet që të monitorojë zbatimin korrekt të SKK-ve në hartimin e pasqyrave financiare me synimin e përmirësimit të vazhdueshëm të tyre.

Në ligjin për auditimin ligjor janë përcaktuar njësitë ekonomike të cilat janë të detyruara të kryejnë auditim ligjor të pasqyrave financiare vjetore nga ana e audituesve ligjor apo shoqërive të auditimit. Pra për një pjesë të njësive ekonomike kontrolli i zbatueshmërisë korrekte të standardeve të kontabilitetit është i siguruar nga ana e audituesve ligjorë. *(Këtu hasim problemin që audituesit ligjorë për shërbimin e ofruar prej tyre paguhen nga shoqëritë që auditohen dhe kjo gjë rrit riskun që ndikon në cilësin e auditimit, por ky probem nuk është subjekt i këtij studimi).*

Por, njësitë ekonomike të cilat janë të detyruara të auditohen përfaqësojne një përqindje të vogël të totalit të njësive ekonomike në vendin tonë. Nga disa informacione jozyrtare rezulton që, vetëm 10% e njësive ekonomike që zbatojnë SKK-të auditohen. Po 90% të njësive kush do t'i monitorojë sesi i zbatojnë standardet dhe cilat janë vështirësitë që ata hasin në zbatimin e SKK-ve apo SNRF-ve? Auditimi ligjor siç shikohet nuk zgjidh problemin e cilësisë së zbatueshmërisë së SKK-ve. Për t'i ardhur në ndihmë kësaj situate në ligjin e ri nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i cili ka fyrë në fuqi në janar të 2019, neni 24, pika (f) thuhet shprehimisht

që “Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka për detyrë të monitorojë zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar nga ana e njësive ekonomike”.

Kjo sfidë e re e ligjit ngre një sërë pikëpyetjesh për shkak të mungesës së procedurave dhe kapaciteteve për përmbushjen e saj. KKK nuk ka eksperiencë në një monitorim të tillë, prandaj duhen përcaktuar mekanizmat për identifikimin e problemeve, strukturat përgjegjëse, si edhe networku i autoriteteve që do të ndërveprojnë ndërmjet tyre.

## 3 - METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur në realizimin e punimit ka të bëjë me testimin e një modeli ekzistues duke bërë përshtatjet e duhura sipas kushteve dhe rrethanave në të cilat do të zbatohet. Në propozimin tim kam shfrytëzuar informacionin e disa organizmave standarde hartuese në vende të zhvilluara në Evropë. Ndër praktikat më të suksesshme ndërkombëtare dhe të cilat mund të aplikohen në mënyrë më eficiente në vendin tonë është modeli i Këshillit të Raportimit Financiar Anglez (UK Financial Reporting Council). Të gjithë komponentët e modelit të zbatimit të monitorimit të standardeve të parashikuar nga UKFRC do të vlerësohen si të mundshëm për t’u aplikuar dhe si të mundshëm për të dhënë rezultate përmes dy mënyrave: pyetësorët, të cilët do të përdorin vlerësimin sipas shkallës LIKERT dhe mënyra tjetër janë intervistat me përgjigje të hapura, të cilat do të mbledhin mendimin profesional të akademikëve dhe profesionistëve të praktikës për të vlerësuar efektivitetin e secilit nga komponentët e modelit të përzgjedhur për të aplikuar.

Të dhënat primare do të sigurohen përmes pyetësorëve dhe intervistave, ndërsa të dhënat sekondare do të mblidhen nga hulumtimet në literaturën e shkruar apo në publikime dhe raporte të organizatave të huaja.

## 4 - GJETJE, DISKUTIME DHE ANALIZA

Nga përpunimi i 40 pyetësorëve sipas shkallës LIKERT dhe i 10 intervistave me përgjigje të hapura, u konstatuan disa gjetje.

Në konkluzione e intervistave të hapura u arrit në gjetjet e mëposhtme.

Monitorimi i zbatimit korret të SKK-ve shikohet si kusht i domosdoshëm për rritjen e cilësisë së raportimit financiar përmes krijimit të një mekanizmi të qëndrueshëm të monitorimit.

Pra një mekanizëm që do të ngrihet me objektivin për të kontrolluar zbatimin korrekt të SKK-ve, por i projektuar për të operuar në vazhdimësi duke krijuar një bazë solide në prodhimin e cilësisë së lartë dhe efektive të raportimit financiar.

Ngritja e këtij mekanizmi të qëndrueshëm të monitorimit të zbatimit të SKK-ve duhet të ketë si synim përmirësimin e vazhdueshëm të tyre përmes lehtësimit dhe thjeshtësimit në zbatim, relevancën e tyre, publikimin e komentarëve, etj, në përgjigje të interesave të përdoruesve të pasqyrave financiare dhe në përmirësimin e klimës së "doing business" në Shqipëri.

Të gjithë investitorët ekzistues dhe ata potencialë, huadhënësit dhe kreditorët kanë nevojë që informacioni kontabël që merret nga PF të jetë i raportuar saktë dhe në përputhje me standardet e kontabilitetit në mënyrë që ata të bëjnë vlerësimet e tyre në lidhje me (sigurimin) burimet e njësisë ekonomike, pretendimet kundër njësisë ekonomike, perspektivën e saj dhe efikasitetin e bordit të drejtimit të njësisë ekonomike. Gjithashtu, do të ndihmonte investitorët të mbikëqyrin sjelljen e menaxhimit, duke zbuluar nëse biznesi menaxhohet në përputhje me objektivat e tyre.

Në kuadër të zbatimit të ligjit të ri për KPF, KKK duhet të shfrytëzojë përvojën e homologëve të vet në vendet e tjera dhe njëkohësisht të bashkëveprojë me të gjitha palët e interesuara për të krijuar një mekanizëm të qëndrueshëm për sigurimin e informacionit prej tyre dhe dhënies së një feedback-u dhe produkti kontabël në kohë reale. Përvoja që do të krijojë do të çojë në përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të monitorimit të zbatimit në praktikë të SKK-ve. Por modelet e implementuara me sukses në vendet e zhvilluara nuk janë absolutisht të suksesshme në çdo rrethanë nëse ato nuk përshtaten me kushtet aktuale të çdo vendi ku aplikohen.

KKK nuk mund dhe nuk duhet të rishikojë të gjitha pasqyrat financiare të publikuara. Metodologjia e monitorimit e përzgjedhur duhet të përshkruajë kriteret kryesore për zgjedhjen e pasqyrave financiare për rishikim dhe monitorim vjetor.

Nga përpunimi i pyetësoreve u arrit në gjetjet, të cilat evidentojnë disa komponentë të domosdoshëm që autoriteti monitorues duhet të ketë në përbërje:

- Stafi monitorues

Ngritja e një komiteti të posaçëm për monitorim. Përbërja e stafit që do të monitorojë zbatimin e standardeve duket të ketë një përfaqësim të gjerë dhe të balancuar, i cili duhet të ketë në përbërjen e tij kontabilistë, avokatë, biznesmenë, hartues dhe përdorues të PF, përbërje e cila

do të mbronte më mirë interesat e biznesit. Pra ngritja e një paneli shqyrtimi të raportimit financiar brenda KKK-së me përfaqësues si nga stafi i KKK-së, ashtu edhe nga palët e interesit.

- Detyrat

Nxitje e njësive ekonomike për korrigjim vullnetar të gabimeve relevante në PF për shkak të moszbatimit korrekt të SKK-ve. Në kërkesën për vetëkorrigjim duhet të mbahet parasysh raporti kosto-përfitim në mënyrë që të promovohet me sukses procesi i monitorimit.
Gjetjet e komitetit mund të vihen në vëmendje të autoriteteve të tjera me qëllim të një përmirësimi të një kuadri më të gjerë të raportimit financiar.

- Procedurat e përzgjedhjes së njësive ekonomike që do t'i nënshtrohen monitorimit

Modeli për përzgjedhjen duhet të bëhet sipas një matrice të riskut. Si faktorë përcaktues të riskut identifikohen disa:

- rëndësia e industristrive për ekonominë kombëtare në të cilën operon njësia ekonomike;
- rreziku që mbart njësia ekonomike për shkak të faktorëve ekonomikë;
- zhvillimet rregullatore ose ndikimi i kërkesave të reja të raportimit financiar.

Pesha dhe rëndësia që ka secili faktor duhet të miratohet me vendim të veçantë nga KKK çdo vit. Përzgjedhja mund të nxitet edhe nga çështje specifike të kontabilitetit të cilat mund të çojnë në gabime për shkak të subjektivitetit në gjykim.
Modeli i seleksionimit bazuar në risk plotësohet me përzgjedhjen rastësore për të siguruar që të gjithë njësitë ekonomike të jenë të ekspozuar ndaj shansit për t'u përzgjedhur për monitorim.
Gjithashtu duhet të monitorohen edhe të gjitha ato kompani të cilat e kërkojnë atë vullnetarisht apo për të cilat ka ankesa që mund të vijnë nga burime të ndryshme.

- Objektivat dhe qëllimet e monitorimit:

- Të jetë burim i dobishëm udhëzimi eficient dhe efektiv;
- Të inkurajojë përmirësime në cilësinë e raportimit financiar të ardhshëm;
- Të kombinojë efikasitetin e procesit me qëndrueshmërinë e tij.

Një sistem i shëndoshë i raportimit financiar promovon konkurrencën e ndershme dhe gjithashtu lehtëson lëvizjen e lirë të kapitalit. Kjo, nga ana tjetër, ndihmon në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të biznesit duke sjellë një rritje të mirëqenies së një vendi.

## KONKLUZION

Punimi, pas analizave dhe diskutimeve të autorit, mbështetur në gjetjet e realizuara, arrin në disa konkluzione dhe rekomandime. Në përfundim arrihet në konkluzionin që monitorimi është një instrument i rëndësishëm për të kuptuar arsyet e (mos)zbatimit korrekt të standardeve nga njësitë ekonomike si dhe mekanizmat zhbllokues. Në rast se vështirësia qëndron tek teksti ai riformulohet dhe nëse vështirësia qëndron tek udhëzimet apo ilustrimet ato mund të hartohen dhe të publikohen nga rregullatori i fushës.

Një tjetër konkluzion i dalë nga punimi është që monitorimi nuk mund të jetë detyrë e audituesve apo organizmave kontrollues (si p.sh, zyra e tatim taksave), sepse audituesit nga njëra anë mbulojnë një numër shumë të kufizuar njësish ekonomike me shërbimet e tyre, ndërsa DPT për nga vetë sa parashikohet në ligj ka një rol mbikqyrës dhe ndëshkues. Pra detyra e monitorimit për përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të raportimit i ngarkohet rregullatorit.

Përsa i përket rekomandimeve ato i referohen qasjes dhe procedurave, pra sistemit që duhet ngritur për monitorimin e vazhdueshëm të SKK-ve dhe SNRF-ve.

Së pari, kërkohet një mbështetje me ekperiencë nga ndonjë organizëm i huaj me qëllim që të tejkalohen vështirësitë e aplikimit për herë të parë. Nuk rekomandohet aplikimi pa përshtatje i modeleve të huaja, pavarësisht faktit nëse janë shumë të suksesshme në vendin e tyre.

Së dyti, rekomandohet rritja e kapaciteteve të rregullatorit përfshirë stafin dhe logjistikën me qëllimin realizimin e detyrës.

Së treti, përsa i përket procedurave rekomandohet që përzgjedhja e njësive ekonomike të bëhet e mbështetur te risku duke marrë në konsideratë dhe efektivitetin e kostos. Rekomandohet që përzgjedhja të jetë gjithëpërfshirëse duke mundësuar monitorimin e njësive të ndryshme përsa i përket formës së tyre juridike, madhësisë, pronësisë, vendase apo të huaja dhe sektorëve ku ato operojnë. Gjithashtu rekomandohet që KKK të vendosë ura bashkëpunimi edhe me oragnizma të tjerë vendas si psh, QKB, DPT apo shoqatat e profesionit me qëllim që të mund të sigurojë në kohë, pa kosto dhe me cilësi të gjithë informacionin e nevojshëm.

Rekomandimi i fundit por jo më pak i rëndësishmi do të ishte që gjetjet mbi baza vjetore t'i raportoheshin organizmave ligj hartuese, ligj zbatuese apo rregullatorëve të tjerë të fushës me qëllim që të harmonizohej përpjekja për të rritur cilësinë e raportimit financiar në Shqipëri.

**Biblografia**:


- www.kkk.gov.al
- https://www.frc.org.uk/accountants/accounting-and-reporting-policy/uk-accounting-standards
- https://ec.europa.eu/info
- https://www.ifrs.org/groups/ifrs-foundation-monitoring-board/
- https://www.esma.europa.eu/
- Monitoring of Compliance and Enforcement for High-Quality Corporate Reporting: Guidance On Good Practices Discussion Paper, UNITED NATIONS CONFERENCE ON TRADE AND DEVELOPMENT, April 2017.

ISSN 1857-7482, Nr. 22, 2019 www.eust.edu.mk/Heritage/

# KOMUNA SI VETËQEVERISJE LOKALE

**BSc. Marina Rrika**

**(m.rrika@eust.edu.mk)**

**BSc. Marta Geshtenja**

**(m.geshtenja@eust.edu.mk)**

**Abstrakt**

Qëllimi i këtij punimi është të hulumtojmë dhe kuptojmë rolin e komunës si vetëqeverisje lokale lidhur me mënyrën e funksionimit dhe organizimit të saj. Kjo ka qënë edhe arsyeja e cila na nxiti që të zgjedhim pikërisht trajtimin e kësaj teme, duke sjellë në vëmendje komunën si pjesë e vetëqeverisjes lokale në Republikën Maqedonisë së Veriut, më konkretisht analizimin e Komunës së Strugës.

Ky punim ka në thelb studimin dhe analizën e funksionimit të saj dhe përgjigjen e hipotezës:

a) A funksionon informimi i qytetarëve rreth buxhetit, fondeve, projekteve dhe funksionimin konkret të Komunës së Strugës?

**Fjalët kyçe:** *Komuna e Strugës, Ndarje administrative, qytetarë, informim, vetëqeverisje etj.*

## 1 - HYRJE

Vetëqeverisja lokale është një nga format e decentralizimit të pushtetit qëndror, prandaj është e nevojshme që të informohemi rreth organizimit dhe funksionimit të saj. Komuna përbën një nga format e përfaqësimit të qytetarëve në një territor të caktua; prandaj në punim trajtohet vetëqeverisja locale, elementët e saj, komuna dhe kompetencat, organizimi I organeve të saj dhe në fund pjesëmarrjen direkte të qytetarëve në vendimet e komunës.

Një pjesë tjetër e punimit lidhet me komunën e Strugës, organizimin dhe funksionimin e saj si dhe me informimin e qytetarëve lidhur me komunën.

Në fund i është dhënë përgjigje hipotezës dhe referencat lidhur me punimin.

## 2 - VETËQEVERISJA LOKALE

Vetëqeverisja lokale paraqet një formë të udhëheqjes së bashkësive lokale ku qytetarët në mënyrë direkte ose nëpërmjet përfaqësuesve që i zgjedhen nga ata vetë, vendosin për interesat dhe punët me rëndësi lokale. Vetëqeverisja është një formë e decentralizimit të pushtetit cka e bën atë një institucion demokratik shumë me rëndësi për demokratizimin e një sistemit politik.

Vetëqeverisja lokale e Republikës së Maqedonisë së Veriut është materie kushtetuese. Ajo është vlerë themelore e rregullimit kushtetues. Pjesa e pestë ë Kushtetutës mban titullin " Vetëqeverisja lokale ", parimisht është vërtetuar pozita e saj kushtetuse në sistemin politik. Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë të Veriut, kushtetuta ua garanton të drejtën e vetëqeverisjes lokale , duke vërtetuar karakterin demokratik të vetëqeverisjes lokale.

Koncepti kushtetues i vetëqeverisjes lokale e thekson demokracinë direkte në procesin e vendosjes në nivel lokal.

### *2.1 Elementët e saj*

Vetëqeverisja lokale përmban elementët e saj si formë politike e bashkësive lokale ajo pa dyshim është kategori e sisitemit politik, ndërsa deri diku edhe e të drejtës kushtetuese. Ajo shihet

si shprehje e të drejtës së popullsisë në bashkësi të caktuar. Parimisht është institut demokratik, shumë me rëndësi për demokratizimin e sistemit politik. Atë e karakterizojnë karakteristika të caktuara organizative pa të cilat nuk ka vetëqeverisje lokale : Së pari popullsia e një territori të caktuar lokal, ajo direkt ose nërpërmjet organeve të tyre i kryen funksionet e pushtetit lokal dhe të gjitha funksionet e tjera të lidhura me kompetenca vendore, Është pikërisht organi përfaqësues që me realizimin e kompetencave të veta ndikon në jetën e bashkësisë. Ai zgjedh organet dhe institutet e veta. Vetëqeverisja lokale ka mbështetjen e vet material ku marrëdhëniet e organeve më të larta dhe qëndrore janë të themeluara me kushtetutë dhe me ligj. Ato së pari janë të krijuara për vlerësimin e ligjëshmërisë së punës të organeve, ndërsa vetëm në pjesën e deleguar edhe vlerësimin e punës së përgjithshme.

## 3 - KOMUNA

Komuna është njësi e vetëqeverisjes lokale, si bashkësi e banorëve të një territori të caktuar, e përcaktuar me ligj, e cila përmes organeve dhe përmes administratës si dhe veprimtarive të organizuara publike, mundëson kryerjen e kompetencave të përcaktuara me ligj. Cdo komunë ka emrin dhe territorin e vet. Gjithashtu ajo përmban stemën dhe flamurin e saj. Secila komunë ka buxhetin e vet, cështjet lidhur me të cilin rregullohen me ligj.

Sipas Nenit 3 të Ligjit për Qeverisje Lokale komunat përcaktohen si:[1]

(1) Njësi të vetëqeverisjes lokale

(2) Komunat janë persona juridik.

(3) Komunat i kryejnë kompetencat e tyre përmes organeve të zgjedhura drejtpërsëdrejti nga qytetarët.

### *3.1 Dispozitat e komunës[2]*

Sipas nenit 7 i cili lidhet me Dispozitat e komunës kryerjen e kompetencave të veta komuna e bënë sipas statutit dhe dispozitave. Me statutin e komunës regullohen: organizimi dhe puna e

[1] Neni 3 I LQL

organeve të komunës;organizimi dhe puna e komisioneve të këshillit; mënyra e informimit të qytetarëve; rastet e përjashtimit të publikut nga seancat e këshillit; mënyra dhe procedura e paraqitjes së kërkesave dhe propozimeve për punën e organeve të komunës dhe veprimi me to; realizimi i anketave dhe grumbullimi I propozimeve nga qytetarët; mënyra e kryerjes së obligimeve nga lëmia e mbrojtjes në gjendje lufte si dhe çështje të tjera me rëndësi për vetëqeverisjen lokale.

Lidhur me Aktet e komunës ato shpallen para se të hynë në fuqi. Edhe mënyra e shpalljes të dispozitave rregullohet me statutin.

### *3.2 Kompetencat e komunës*[3]

Në kompetencat e përgjithshmetë saj, komunat, në suaza të ligjit, kanë të drejtë në territorin e vet t'i kryejnë punët e interesit publik me rëndësi lokale, që nuk janë të përjashtuara nga kompetencat e tyre ose nuk janë në kompetencë të organeve të pushtetit shtetëror.

Komunat në mënyrë të pavarur, në suaza të ligjit, i regullojnë dhe kryejnë punët e interesit publik me rëndësi lokale, të përcaktuara me këtë ose ligj tjetër dhe janë përgjegjëse për kryerjen e tyre. Me ligjin me të cilin rregullohen kompetencat e tjera të komunave caktohen edhe burimet financiare për kryerjen e atyre kompetencave.

Komunat janë kompetente për kryerjen e një sërë punëve si:

Planifikimin urbanistik, qoftë ky urban ose rural, dhënia e lejes për ndërtim të objekteve me rëndësi lokale të përcaktuara me ligj, rregullimi i hapsirës dhe rregullimi i tokës ndërtimore. Së dyti mbrotjen e mjedisit jetësor dhe natyrës - masa për mbrojtje dhe pengimin nga ndotja e ujit, ajrit, tokës, mbrojtja e natyrës, mbrojtja nga zhurmimi. Së treti planifikimi i zhvillimit ekonomik lokal duke përcaktuar përparësive zhvillimore dhe strukturale, përkrahja e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të iniciativave në nivel local.

Një nga kompetencat e tjera lidhet me veprimtaritë komunale si furnizimi me ujë për pije; përcjellja e ujit teknologjik; përcjellja dhe pastrimi i ujrave të ndotura; ndriçimi publik; dërgimi dhe trajtimi i ujrave atmosferik; mirëmbajtja e higjienës publike; grumbullimi, transportimi dhe

---

[3] Kapitulli 3, KOMPETENCAT E KOMUNAVE

procedimi me mbeturinat e ngurta komunale; rregullimi dhe organizimi i trafikut publik lokal të udhëtarëve; furnizimi me gaz natyror dhe energji ngrohëse; mirëmbajtja e varreve, varrezave, krematoriumeve dhe dhënia e shërbimeve mortërore; ndërtimi, mirëmbajtja, rekonstruimi dhe mbrojtja e rrugëve lokale, rrugëve dhe objekteve të tjera të infrastrukturës; rregullimi i regjimit të komunikacionit; ndërtimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimeve rrugore të komunikacionit, ndërtimi dhe mirëmbajtja e hapësirës publike të parkimit; mënjanimi i automjeteve të parkuara gabimisht; mënjanimi i automjeteve të dëmtuara nga sipërfaqet publike; ndërtimi dhe mirëmbajtja e tregjeve; pastrimi i oxhaqeve;mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i parqeve, gjelbërimit, park-pyjeve dhe sipërfaqeve rekreative; rregullimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i shtratit të lumenjve në pjesët e urbanizuara; përcaktimi i emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera të infrastrukturës. Lidhur me nivelin kulturore ka këto kompetenca si: përkrahja institucionale dhe financiare të enteve dhe projekteve kulturore; kultivimi i folklorit, zakoneve, artizanateve të vjetra dhe vlerave të ngjashme kulturore; organizimi i manifestimeve kulturore; nxitja e formave të llojllojshme specifike të krijimtarisë. Në aspektin sportiv kemi zhvillimin e sportit masiv dhe i aktiviteteve rekreative; organizimi i shfaqjeve dhe manifestimeve sportive; mirëmbajtja dhe ndërtimi i objekteve për sport; përkrahja lidhjeve sportive.

Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve është një kompetenc tjetër e komunës e cila lidhet me mundësimin e çerdheve për fëmijë dhe shtëpi të pleqve; realizimi i përkujdesjes sociale për persona invalidë; fëmijëve pa prindër dhe përkujdesje prindërore; fëmijëve me probleme edukativo-sociale; fëmijëve me nevoja të veçanta; fëmijëve nga familjet njëprindërore; fëmijëve në rrugë; personave të ekspozuar rrezikut social; personave të prekur nga keqpërdorimi i drogës dhe alkoolit; ngritja e vetëdijes së popullatës; strehimi i personave të rrezikuar social; realizimi i së drejtës dhe edukimi i fëmijëve të moshës parashkollore.

Arsimi përbën një fushë tjetër të kompetencave I cili lidhet me themelimin, financimin dhe administrimi i shkollave fillore dhe të mesme, në bashkëpunim me pushtetin qendror, në pajtueshmëri me ligjin, organizimi i transportit.

Në kompetencat të cilat komuna është e detyruar të zbatoj me ligj bëjnë pjesë dhe një sërë punësh të të tjera të përcaktuara me ligj. Kompetencat kryhen pikërisht në përputhje me standardet

dhe procedurat e caktuara paraprakisht me ligj. Me ligj përcaktohen gjithashtu punët në kompetencë të komunës të cilat ajo është e detyruar ti kryej.

## 4 - ORGANIZIMI DHE PUNA E ORGANEVE TË KOMUNËS[4]

Organet e komunës janë dy këshilli dhe prefekti. Me anë të këtyre dy organeve organizohet dhe funksionon puna në këtë institucion.

Këshilli është organ përfaqësues i qytetarëve i cili vendos në suaza të kompetencave të komunës. Për shqyrtimin e çështjeve dhe përcaktimin e propozimeve nga lëmenjt përkatëse këshilli nga përbërja e vet mund të formojë komisione të përhershme dhe të përkohshme. Përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të komisioneve rregullohen me statutin dhe përkon me përfaqësimin proporcional të partive politike në këshill.

Këshilli përbëhet nga përfaqësues të qytetarëve të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë. Numri i tyre përcaktohet varësisht nga numri i banorëve në komunë dhe nuk mund të jetë më pak se nëntë as më shumë se 33 anëtarë.

Më konkretisht numri I anëtarëve të këshillit varion si më poshtë:

| banorë | anëtarë të këshillit |
|---|---|
| deri 5000 | 9 |
| prej 5001 deri 10.000 | 11 |
| prej 10.001 deri 20.000 | 15 |
| prej 20.001 deri 40.000 | 19 |
| prej 40.001 deri 60.000 | 23 |
| prej 60.001 deri 80.000 | 27 |
| prej 80.001 deri 100.000 | 31 |
| mbi 100.000 | 33 |

[4] V. ORGANIZIMI DHE PUNA E ORGANEVE TË KOMUNËS

Anëtarët e këshillit zgjedhen me mandat katërvjeçar. Ata i përfaqësojnë qytetarët dhe në këshill vendosin sipas bindjeve të tyre. Ai nuk mund të revokohet.

Përsaipërket këshillit ai ka një sërë kompetencash. Së pari sjell statutin e komunës dhe dispozita të tjera. Sjell buxhetin dhe llogarinë vjetore të komunës. Ai përcakton shumën e burimeve personale të të ardhurave të financimt të komunës, themelon veprimtari publike dhe bënë mbikqyrjen mbi punën e tyre. Këshilli emëron anëtarë të këshillave drejtues të veprimtarive publike të cilat i themelon; Sjell gjithashtu programe për punë dhe plane financiare për financim të veprimtarive publike që i ka themeluar komuna. Ai miraton raportet për realizimin e buxhetit dhe llogarinë vjetore të komunës.

Seancat e tij thirren sipas nevojës, por më së paku njëherë në tre muaj. Ato thërriten nga kryetari i këshillit me iniciativë të vet, me kërkesë të prefektit ose me kërkesë të më së paku ¼ të anëtarëve të këshillit më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së sajë.  Seancat e këshillit janë publike. Për përjashtimin e prezencës së publikut në seancë vendoset nëse për të ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të përcaktuara me statut, me dy të tretën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit. Në debatin për buxhetin e komunës, llogarinë përfundimtare të buxhetit dhe planet urbanistike, prania e publikut nuk mund të përjashtohet. Anëtarët e këshillit kanë të drejtat dhe obligimet e tyre.  Ata kanë të drejtë dhe obligim të jenë prezent dhe të marrin pjesë në punën e këshillit dhe në komisionet e tij të përhershme dhe të përkohëshme. Gjithashtu kanë të drejtë në seancat e këshillit të japin iniciativa dhe propozime dhe t'i parashtrojnë pyetje prefektit. Anëtari i këshillit nuk mund të thirret në përgjegjësi penale ose të arrestohet për mendimin e shfaqur ose për votim në këshill.

*4.1 Kryetari i këshillit*

Në krye të Këshillit ndodhet kryetari I saj, zgjedhja e të cilit bëhet nga përbërja e anëtarëve të këshillit, me mandat katërvjeçar. Për kryetar të këshillit zgjedhet kandidati i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit. Nëse në rrethin e parë asnjëri nga kandidatët për kryetar nuk ka fituar numër të mjaftueshëm të votave, kalohet në rrethin e dytë të votimeve për dy kandidatët që në rrethin e parë kanë fituar më shumë vota. Kryetar zgjidhet ai I cili fiton më shumë vota nga rrethi I dytë I zgjidhjeve. Edhe kryetari I këshillit ka obligime të cilat përfshijnë  thërritjen dhe  udhëheqjen e seancave të këshillit, ai kujdeset për organizimin dhe

punën e këshillit dhe I nënshkruan dispozitat që i ka sjellur këshilli dhe në afat prej tre ditësh nga dita e sjelljes ia dorëzon prefektit për publikim.

*4.2 Prefekti*

Prefekti zgedhet çdo katër vite në zgjedhje të përgjithëshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë në përputhje me ligjin me të cilin rregullohen zgjedhjet lokale. Ai e përfaqson dhe prezanton komunën, kontrollon ligjshmërinë e dispozitave të këshillit, shpall dispozitat e këshillit në gazetën zyrtare të komunës. Prefekti siguron zbatimin e vendimeve të këshillit, siguron kryerjen e punëve të cilat me ligj i janë deleguar komunës. Ai inicon dhe propozon sjelljen e dispozitave nga kompetencat e këshillit. Gjithashtu propozon buxhetin vjetor të komunës dhe llogarinë vjetore të buxhetit të komunës. Ai realizon buxhetin e komunës, zgjedh drejtorë të veprimtarive publike që i ka themeluar komuna, në bazë të konkursit publik. Rregullisht e njofton këshillin për kryerjen e kompetencave të veta në përputhje me statutin. Ai vendos në punë administrave për të drejtat, obligimet dhe intereset e personave juridik dhe fizik, në përputhje me ligjin. Prefekti sjell rregullore për sistematizimin e vendeve të punës të administratës komunale, udhëheq me administratën komunale. Vendos për punësimin, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësistë e të punësuarve në administratën e komunës, nëse ndryshe nuk është e përcaktuar me ligj; Gjithashtu ai siguron shfrytëzim të drejtë dhe ligjor, mirëmbajtje dhe mbrojtje të pronës së komunës, në përputhje me ligjin dhe statutin dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me statutin. Prefekti mund të autorizojë nënpunës udhëheqës së komunës që të udhëheq procedurën dhe të vendos për punë administrative si dhe të nënshkruaj akte.

## 5 - PJESËMARRJA DIREKTE E QYTETARËVE NË VENDIMIN E KOMUNËS

Pjesëmarrja direkte e qytetarëve në vendimin e komunës , paraqet tre forma të demokracisë direkte: iniciativa qytetare; tubimi i qytetarëve dhe referendumi.

Iniciativa qytetare përbëhet në të drejtën që qytetarët t'i propozojnë këshillit të komunës sjelljen e aktit të caktuar ose zgjidhjen e çështjeve të caktuara nga kompetencat e saj. Ligji e përjashton iniciativën e qytetarëve për çështje financiare. Për iniciativën qytetare këshilli është i

detyruar të debatojë nëse atë e përmbajnë 10% nga zgjedhësit e komunës edhe atë në afat prej 90 ditësh, si edhe t'i lajmërojë inisiatorët për sjelljen e vendimit.

Tubimin e qytetarëve e thirr prefekti me iniciativë personale, me kërkesë të këshillit ose me kërkesë të së paku 10% të zgjedhësve të komunës. Organet komunale kanë detyrë në afat prej 90 ditësh ti shqyrtojnë konkluzionet e sjellura në tubim, t'i marrin parasysh gjatë sjelljes së vendimeve, si edhe t'I informojnë qytetarët për vendimet e sjella.

Këshilli i komunës është i detyruar të shhpallë referendum kur atë e kërkojnë 20% e zgjedhësve, ndërsa mund të shpallë referendum edhe për çështje nga kompetencat e saj. Rezultatet e referendumit janë të domosdoshme për këshillin.

Për përforcimin e funksionit të shoqërisë civile dhe përgjegjësisë së pushtetit publik, u ofron qytetarëve të drejtën për të dërgojnë parashtresa dhe propozime për punën e organeve të administratës komunale, si edhe për detyrimin e organit përkatës t'i japë përgjigje me sqarim parashtruesit, më vonë në afat prej 60 ditësh nga dita e parnimit. Në rast së punohet për çështje që nuk janë në kompetencat e komunës, organi komunal është i detyruar t'a dërgojë të njëjtën deri te organi kompetent dhe ta lajmërojë parashtuesin për këtë. Gjatë përgatitjes së dispozitave këshilli i komunës dhe prefekti mund të organizojnë tribuna publike dhe anketa.

## 6 - KOMUNA E STRUGËS

Komuna e Strugës është njësi e vetëqeverisjes lokale, kështu, në mënyrë të pavarur, në kuadër të ligjit, komuna kryen punë me interes publik të rëndësisë lokale.

Në bazë të ligjit, Komuna e Strugës kryen planifikim urbanistik, mbron ambientin jetësor dhe natyrën, planifikon zhvillimin ekonomik lokal, kryen veprimtari komunale, kryen punë nga sfera e kulturës, sportit, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, bën themelim, organizim dhe administrim me shkollat fillore dhe të mesme, ndërmerr masa për mbrojtjen shëndetësore dhe shpëtim të qytetarëve dhe të mirave materiale në gjendje lufte, fatkeqësie natyrore, si dhe kryen mbrojtje nga zjarret përmes njësive territoriale zjarrfikëse.

Me qëllim kryerjen e punëve nën kompetencë të komunës, organizohet administrata e komunës në sektorë, njësi dhe inspektoriat komunal. Organizimin, fushëveprimin dhe mënyrën e kryerjes së punëve nga ana e administratës komunale e përcakton Këshilli i komunës, me propozim të Kryetarit të komunës.

Çështjet administrative të komunës realizohen nga të punësuarit në administratën komunale. Të punësuarit në administratën lokale kanë status të nëpunësit shtetëror, të cilët kryejnë punë profesionale, normativo-juridike, administrative, mbikëqyrëse, planifikim, punë materiale financiare, punë të kontabilitetit, punë informatike dhe punë të tjera në pajtim me ligjet. Nëpunësi në administratën komunale të Komunës së Strugës obligohet që punët dhe detyrat administrative t'i kryejë me vetëdije, në mënyrë profesionale, efikase, të rregullt dhe në kohë, jonjëanshëm dhe pa ndikime politike.

*6.1 Rajoni i komunës së strugës*[5]

Nga neni 10 i ligjit për organizimin territorial përcaktohen këto vendbanime lidhur me komunën e strugës:

Komuna e Strugës – qyteti Strugë dhe fshatrat: Bezovë, Bixhevë, Bogojc, Boroec, Bërçevë, Burinec, Veleshtë, Vishnë, Vranishtë, Glloboçicë, Belicë e Epërme, Tatesh i Epërm, Belicë e Poshtme, Dellogozhdë, Dobovjan, Tatesh i Poshtëm, Drasllajcë, Drenok, Zagraçan, Zbazhd, Jabllanicë, Kalishtë, Koroshishtë, Llabunishtë, Llakaicë, Livadhi, Llozhan, Llokovë, Llukovë, Mali Vllaj, Misleshevë, Misllodezhdë, Modriç, Moroishtë, Nerez, Novo Sellë, Oktis, Radozhdë, Ladorishtë, Frangovë, Shum, Piskupshtinë, Podgorc, Pohum, Prisovjan, Rëzhanovë, Sellc, Tashmarunishtë, Toska dhe Xhepin.

*6.2 Këshilli dhe kompetencat*

Këshilli i Komunës së Strugës është i përbërë nga 27 përfaqësues të qytetarëve. Ata mblidhen një herë në muaj dhe për arsye më të rëndësishme mund të mblidhën dhe më shpesh. Në krye të tij qëndron kryetari I këshillit.

---

[5] III. RAJONI I KOMUNAVE DHE VENDBANIMET NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Këshilli i Komunës është kompetent për një sërë funksionesh.

Së pari ai aprovon statutin dhe dispozitat e tjera të komunës. Gjithashtu merret dhe me aprovimin e buxhetit të komunës dhe llogarinë vjetore të saj. Së dyti, përcaktimin e lartësisë së burimeve të të ardhurave personale për financim të komunës, në suazat e përcaktuara me ligj. Ai merret me themelimin e shërbimeve publike dhe bën mbikëqyrje mbi punën e tyre. Gjithashtu emëron anëtarët e bordeve drejtuese të shërbimeve publike, që i themelon vetë ai.

Këshilli i komunës merret me aprovimin e planeve për punë dhe planeve financiare për financimin e shërbimeve publike, që janë themeluar nga komuna; aprovimin e raportit për kryerjen e buxhetit dhe aprovimin e llogarisë vjetore të komunës. Është pikërisht Këshilli I

Komunës ai që vendos për dhënien e lejës për kryerje të veprimtarisë me interes publik. Gjithashtu merret me aprovomin e raportit për punë dhe llogarive vjetore të shërbimeve publike, që i ka themeluar vetë ajo.

Ai vendos për mënyrën e përdorimit të pronësisë së komunës, gjithashtu vendos për mënyrën e kryerjes së kontrollit financiar të buxhetit të komunës, në pajtim me ligj.

Së fundmi merret me shqyrtimin dhe aprovimin e raportit për siguri publike në territorin e komunës, të cilin e dorëzon deri te ministri për punë të brendshme dhe avokati popullor.

*6.3 Sektorët dhe njësitë*[6]

Komuna e Strugës ndahet në pesë sektorë që përfshijnë:

1. **Sektori për çështje juridike dhe punë të përgjithshme**.

   Ky I fundit ndahet në 3 njësi:

   - Njësia për çështje juridike dhe normativ
   - .Njësia për punë të përgjithshme
   - .Njësia për bashkëpunim me bashkësit lokale dhe mbrojtje dhe shpëtim
2. **Sektori për çështje financiare** I cili përfshin këto njësi:
   - Njësia për koordinim buxhetor dhe njësia për kontroll buxhetor
   - Njësia për kontabilitet dhe pagesa

- Njësia për tatime dhe taksa komunale
- Njësia për furnizime publike

3. **Sektori për veprimtari publike**

Përfshin tre njësi që janë: njësia për arsim dhe kulture, për sport dhe shoqata të qytetarëve dhe njësia për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore

4. **Sektori për përkrahje të kryetarit, organizim të punës së këshillit dhe teknologjis informatike përfshin dy njësi, që janë: njësia për përkrahje të kryetarit dhe organizim të punës së këshillit dhe njësia për teknologji informatike.**
5. **Njësia për turizëm përfshin njësitë për zhvillim ekonomik local dhe për bashkëpunim ndërkombëtar dhe fonde evropiane.**

*6.4 Informimi i qytetarëve*

Organet e komunës, komisionet e këshillit dhe veprimtaritë publike të themeluara nga komuna, janë të obliguara pa kompensim t'i informojnë qytetarët për punën e tyre, si dhe për planet dhe programet që janë me rëndësi për zhvillimin e komunës, në mënyrë të përcaktuar me statutin. Komuna është e obliguar qw qytetarëve t'iu mundësojë qasje në informatat themelorepër shërbimet që ua siguron.

Komuna e struges ka njefaqe zyrtare qe pershkruan organizimin , funksonimin , sektoret ,njesite dhe lighet qe votohet.

Komuna e Struges jep infomacionet e nevojshme lidhur me komisionet dhe kryetarin e tyre. Nje menyre tjeter e informimit eshte te shkuarit drejtperdrejt ne komune ose nepermjet kerkesave zyrtare. Nje nga format me te mira te informimit jane mbledhjet e hapura te keshillit per qytetaret.

## KONKLUZION

Qëllimi i ketij punimi ishte dhënia e përgjigjes lidhur me informimin e qytetarëve rreth buxhetit, fondeve, projekteve dhe funksionimin konkret të Komunës së Strugës. Duke qenë se informimi i publikut është një nga obligimet e komunës do të thotë që funksionon informimi I qytetareve, por ky informim varet nga interesimi i tyre lidhur me problematikat dhe komunën në përgjithësi.

Ne si studente nuk e patëm të vështirë të mërrnim informacion lidhur me organizimin dhe jo vetëm të komunës. Informacioni u morë duke shkuar drejtëpërdrejt në komunë, ku zhvilluam një intervistë me Sekretaren e Përgjithshme të komunës, e cila na dha informacionet e nevojshme mbi funksionimin, shtrirjen dhe efikasitetin e punës së saj .

**Biblografia:**


- http://www.aa.mk/WBStorage/Files/poglavje16_AL.pdf
- http://www.struga.gov.mk/wp-content/uploads/2018/04/Ligji-per-organizim-territorial.pdf
- http://bn-mk.org/old/crbn-mk.courriers.info/decentralizimi-ne-maqedoni.html
- http://mls.gov.mk/images/laws/Ligji%20i%20veteqeverisjes%20lokale.pdf

# EMIGRIMI I KAPITALIT NJERËZOR NGA REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

**Prof.Dr. Gëzim Selimi**

**(g.selimi@eust.edu.mk)**

**Abstrakt**

Çdo vend (shtet) që t'i realizon qëllimet dhe strategjinë e përcaktuar, detyrimisht duhet jo vetëm të disponon me burime (resurse) të nevojshme, por edhe t'i përdorë të njëjtat në mënyrë sa më racionale, efikase dhe efektive. Faktorët e prodhimit apo burimet me të cilat disponon një shoqëri tregtare janë: toka, kapitali, puna dhe sipërmarrësi ose thënë ndryshe: burimet financiare, fizike, të informacionit dhe ato njerëzore (humane).

Kur flasim për burimet njerëzore mendojmë për njerëz të cilët i kryejnë punët, puna e të cilëve kërkon organizim për realizimin e qëllimeve. Ata kanë vlerë dhe dobishmëri duke qenë se ndihmojnë në procesin e prodhimit apo ndihmojnë në zinxhirin krijimit të vlerës të shfrytëzueshme. Njerëzit janë pasuria më e madhe e një vendi, andaj është e papranueshme që ata të barazohen me faktorët tjerë të prodhimit.

Për realizimin e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik çdo vend, së pari, duhet të sigurojë burime materiale dhe financiare dhe së dyti, edhe burimet e nevojshme njerëzore, që kanë qenë dhe akoma janë burimi më i çmuar dhe më i dalluar i çdo vendi. Qeveria e çdo vendi i realizojnë qëllimet dhe strategjinë e vendosur me anë të njerëzve, me aktivizimin e burimeve njerëzore, duke shfrytëzuar përpjekjet fizike e mendore të tyre në pozita dhe vende të caktuara në bazë të strukturës së caktuar organizative. Burimet njerëzore kanë rëndësi jetësore dhe vendimtare për suksesin e veprimtarisë së çdo ekonomie vendore. Burimet njerëzore janë burimi më i mirë që mund të çojë vendin në përparësi konkurruese ndaj vendeve tjera dhe luan rol të rëndësishëm si në arritjen e qëllimeve organizative ashtu edhe në plotësimin e objektivave tjera të vendit.

**Fjalë kyçe:** *Emigrim, kapital njerëzor, zhvillim, faktorë.*

## 1 - HYRJE

Ekonomia e dijes paraqet përhapjen masive të edukimit pasuniversitar, duke arritur, krahas specializimit të ngushtë profesional, edhe marrjen e njohurive bazike financiare dhe orientimin drejt sektorit të shërbimeve. Pra, burimet njerëzore, paraqesin treguesin më të rëndësishëm të të gjitha ndryshimeve në ekonominë e tregut, në risitë teknologjike dhe përhapjen e saj të shpejtë, si dhe është garant në realizimin e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik dhe sigurimit të mirëqenies shoqërore.

Ekonomin e lirë vazhdimisht e përcjellë fenomeni i migrimit, i cili ka qenë pjesë e historisë njerëzore që prej fillimeve të tij. Njerëzit kanë migruar nga një kontinent në tjetrin, nga një vend tek tjetri apo kanë lëvizur edhe brenda vendit. Fenomeni i migrimit ka qenë i domosdoshëm për historinë njerëzore, kulturën dhe civilizimet. Vendet në zhvillim kanë një përqindje të lartë të punëtorëve të kualifikuar të cilët janë të gatshëm të kërkojnë një punë në vendet me ekonomi të zhvilluar. Largimi i njerëzve të arsimuar apo profesionistëve nga një vend, sektor i ekonomisë, apo të ngjashme për një pagë apo kushte më të mira të jetesës përbën "ikjen e trurit".

Ky fenomen i largimit apo shtegtimi i kapitalit njerëzor, është i pranishëm dhe aktual në të gjitha vendet ish komuniste dhe tani anëtare të BE-së si dhe në trojet shqiptare duke përfshirë këtu edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Emigrimi i inteligjencës, individëve të mirë-arsimuar për një pagë apo kushte më të mira, duke shkaktuar në vendet e tyre të origjinës humbjen e njerëzve të aftë, apo "ikjet", është një plagë e rëndë në decenien e dytë të shek. 21.

## 2 - MIGRIMI I FUQISË PUNËTORE

Migrimi gjithnjë është duke u bërë një çështje thelbësore dhe shumë aktuale në të gjitha vendet në zhvillim andaj ka nevojë për një trajtim sa rajonal aq edhe global. Pra, është i domosdoshëm një koordinim i tillë në mënyrë që bashkëpunimi ndërkombëtar të jetë i suksesshëm. Por, çfarë është migrimi? Migrimi është lëvizja e njerëzve nga njëri vend në tjetrin. Njohim dy lloj migrimesh:

- **Migrimi i brendshëm** është kur njerëzit migrojnë brenda të njëjtit vend ose rajon.
- **Migrimi ndërkombëtar** është kur njerëzit migrojnë nga një shtet në tjetrin.

Dy termat kyç të migrimit janë:

- **Emigrimi –** kur dikush lë vendin.
- **Imigrim** – kur dikush hyn në vend; - apo, vendimi për të ardhur/shkuar për të jetuar përgjithmonë në ndonjë vend të huaj.

Migrimi mund të përkufizohet si një "proces që lëviz, kalimin e një kufiri ndërkombëtar, apo brenda vendit. Përfshin çdo lloj të lëvizjeve të njerëzve, çfarëdo që të jetë gjatësia e atyre lëvizjeve, përbërjet/marrëveshjet apo shkaqet; përfshin refugjatët, të zhvendosurit, personat, njerëzit e shpërngulur, dhe emigrantët ekonomik.

Regjioni ynë ka përjetuar një rritje të lartë të përqindjes së punëtorëve të kualifikuar dhe me arsim të lartë të cilët janë të gatshëm të kërkojnë një punë në ekonomitë e industrializuara, ku vazhdimisht rritet numri i emigrantëve që jetojnë në vendet e zhvilluara. Që nga kah dekada e dytë e shek. 21 ballafaqohemi me fenomenin e ashtuquajtur "Ikja e trurit" ose e njohur si "Brain Drain". Me "ikje e trurit" nënkuptojmë humbjen e intelektualëve të aftë dhe të fuqisë punëtore të kualifikuar me anë të lëvizjes së lirë të punës në drejtim të mjediseve më të favorshme gjeografike, ekonomike apo profesionale.[1] Largimi i njerëzve të arsimuar apo profesionistëve nga një vend, sektor i ekonomisë, apo të ngjashme për një pagë apo kushte më të mira të jetesës poashtu përbën "ikjen e trurit".[2]

Emigrimi i fuqisë punëtore të kualifikuar është një shqetësim i madh për rajonin. Realizimi i planeve për zhvillimin ekonomik për shkak të numrit më të vogël të profesionistëve, teknikëve si dhe menaxherëve hasin në vështirësi për implementimin e tyre, andaj duhet që afaristët të paguajnë paga të larta për të punësuar menaxher dhe konsulentë të huaj. Në të njëjtën kohë, qindra apo mijëra punëtorë të kualifikuar apo të trajnuar si dhe me shkollim të lartë lënë vendin për t'u punësuar në vendet e zhvilluara. Me ikjen e trurit dhe migrimin e popullsisë aktive rajoni pëson humbje të mëdha pasi efektet e mundshme negative të ikjes në rritjen ekonomike, edukimin, shpërndarjen e të ardhurave dhe të mirëqenies është evident.

[1] (The Free Dictionary), 'Brain Drain', e qasshme në: http:/www.thefreedictionary.com/brain+drain
[2] Merriam Ëebster – since 1828, 'Brain Drain', e qasshme në: http://www.merriam-webster.com/dictionary/brain%20drain , (shikimi i fundit më 7 Janar 2016)

### *2.1. Faktorët që e përcaktojnë emigrimin e kapitalit njerëzor*

Migrimi ndikon në të dy vendet, vendin që lë pas, si dhe vendin ku emigrantët vendosen. Arsyet për emigrim mund të jenë të ndryshme si: ekonomike, sociale, politike apo mjedisore.[3] Zakonisht njihen *faktorët nxitës* (*push factors*), faktorët që inkurajojnë apo nxisin njerëzit të lënë vendin ku ata jetojnë dhe të lëvizin në drejtim të vendeve tjera, si dhe *faktorët tërheqës* (*pull factors*), faktorët që tërheqin njerëzit për të kaluar në një vend të ri.[4]

Tab.nr.1 Faktorët nxitës dhe tërheqës të migrimit

| FAKTORËT NXITËS | FAKTORËT TËRHEQËS |
|---|---|
| 1) Kushtet e dobëta të jetesës ( mungesa e transportit, mungesa e strehimit); | 1) Standard i sofistikuar i jetesës; Mundësi më të mira ekonomike |
| 2) Paga të ulëta; | 2) Të ardhura dhe paga më të larta, Përfitime më të larta; |
| 3) Papunësia apo punësimi i pjesshëm; | 3) Mundësia e punësimit; Punësim më i lartë; |
| 4) Zhvillimi i ulët ekonomik; | 4) Zhvillim ekonomik |
| 5) Trazirat sociale, paqëndrueshmëria politike, konfliktet dhe luftërat; | 5) Stabiliteti politik |
| 6) Diskriminimi në punë; | 6) Kushtet e mira të punës |
| 7) Dëshira për një kualifikim më të lartë; | 7) Mundësi të zhvillimit të avancuar profesional |
| 8) Institucione të papërshtatshme; | 8) Institucione të përshtatshme; |
| 9) Mungesa e shërbimeve; | 9) Shërbime më të mira; |
| 10) Mungesa e sigurisë, nivel i lartë i krimit; | 10) Siguri më e lartë, nivel i ulët i krimit, |
| 11) Thatësia, përmbytje; varfëria. | 11) Rrezik më i ulët nga fatkeqësitë natyrore. |
| 12) Mungesa e kushteve adekuate të punës; | 12) Kushteve adekuate të punës |

[3] British Broadcasting Corporation (BBC), 'Geography – Migration Trends, po aty, faqorja 1, e qasshme në:http://www.bbc.co.uk/schools/gcsebitesize/geography/migration/migration_trends_rev2.shtml ,(shikimi i fundit 5 Janar 2016)
[4] Po aty,

| | |
|---|---|
| 13) Mungesa e pajisjeve për kërkim dhe zhvillim; pamjaftueshmëria e fondeve kërkimore, mungesa e mjeteve dhe aparaturës profesionale; | 13) Burime të shumta për hulumtim, objekte moderne për pajisjet laboratorike; |
| 14) Mungesa e lirisë dhe autonomisë; | 14) Meritokracia, transparenca; |
| 15) Mungesa e traditës shkencore dhe kulturës | 15) Prania e një tradite të pasur shkencore dhe kulturore; |
| 16) Dëshira për një jetë më të mirë | 16) Më shumë pasuri/mirëqenie; |
| 17) Përkeqësimi i përsosmërisë së sistemit arsimor; | 17) Skemat moderne arsimore; |

### *2.2 Ndikimet pozitive dhe negative të emigrimit*

Lëvizja e fuqisë së re punëtore e veçanërisht të asaj të kualifikuar dhe e intelektualëve sugjeron se vendi ofrues është në rrezik të shterimit nga furnizimi i natyrshëm i kapitalit njerëzor. Papunësia, varfëria, arsimi, siguria, etj. luajnë rol kyç në migracionin rural-urban si dhe një rol të madh në migrimin ndërkombëtar të individëve, nga vendet e varfra në ato të pasura.

Migrimi i punonjësve dhe rrjedha e trurit mund të shihet si një dukuri negative për vendin e burimit, pikërisht për shembull, në zëvendësimin jo adekuat të punëtore të kualifikuar me atë të pakualifikuar. Por ka mendime se një migrim i tillë ka edhe ndikim pozitiv si për shembull, në formimin e kapitalit njerëzor, në tregun e punës, në të hyrat publike dhe në rritjen ekonomike.

Në vazhdim në tabelën e më poshtme do të pasqyrojmë anët pozitive dhe negative të emigrimit.

Tabela nr.2. Anët pozitive dhe negative të emigrimit

| ANËT POZITIVE | ANËT NEGATIVE |
|---|---|
| 1) Emigrantët e rrisin mirëqenien; | Emigrimi ndikon në mbingarkesë të punës ndaj atyre të cilët kanë mbetur, modelim të dobët në vendin e punës, ka implikime negative për shëndetin e qytetarëve. |

| | |
|---|---|
| 2) Mirëqenia e emigrantëve u mundëson dobi edhe anëtarëve të familjes; | Emigrimi detyron përdorim dhe zëvendësim i punëtorëve me shkallë nën nivelin e duhur të kualifikimit; |
| 3) Emigrantët dërgojnë remitanca te familja; | Largimi i profesionistëve cilësor rezulton me humbjen e njohjes ndërkombëtare të institucioneve të vendit; |
| 4) Emigrantët kanë ndikim pozitiv në politikat dhe institucionet e vendit; | Shumë emigrantë detyrohen të rrinë me vite të tëra derisa të marrin dokumentet në shtetet pa parë familjet e tyre dhe mundësi e vogël për të krijuar familjen me një bashkëkombëse. |
| 5) Popullsia e vendit amë mund të ketë mundësi të mira për të investuar në kapitalin njerëzor. | Ngadalëson krijimin e vendeve të reja të punës dhe pengon efikasitetin |
| 6) Kërcënimi i migracionit mund të shërbejë si një kontroll mbi sjelljen e politikanëve në vend (për shembull: mund të ndryshojë pagat e ulëta, demokratizimin politik, të drejtat e njeriut, politika fiskale, etj.); | Me ikjen punonjësve aktiv, rezulton në zvogëlimin e kursimeve, në mbledhjen e taksave, si dhe humbjen e burimeve të lidershipit apo liderëve cilësor, zvogëlon vëmendjen nga problemet e brendshme. |
| 7) Emigrantët mund të kthehen në shtëpi duke sjellë teknologji dhe dije të reja; | Vetmia pa familje e pa miq të vërtetë shkakton depresionin te shumë emigrantë |
| 8) Emigrantët mund të lehtësojnë lidhjet tregtare; | Humbet kostoja ekonomike ( shpenzimet qeveritare) për trajnimin, aftësimin dhe shkollimin e personave që emigrojnë |

## 3. EMIGRIMI I KAPITALIT NJERËZOR NË RMV

### *3.1. Konteksti gjeografik, demografik, ekonomik dhe arsimor*

Republika e Maqedonisë së Veriut është e rrethuar nga vargmale të shumta dhe e ndarë në 8 regjione të ndryshme dhe ka një sipërfaqe prej 25.713 Km2. RMV gjendet në qendër të pjesës

juglindore të Gadishullit Ballkanik dhe nëpërmjet territorit të saj kalojnë dy autostrada të rëndësishme ajo e korridorit 6 dhe 8 që lidhen me Greqinë dhe me Republikën e Shqipërisë.

Republika e Maqedonisë së Veriut në vitin 2016 ka pasur këto të dhëna demografike, ekonomike dhe sociale.

Tabela nr.3. Të dhënat demografike tw RMV në vitin 2016

| | |
|---|---|
| Numri i popullsisë | 2.073.702 |
| % sipas gjinisë | M-50.1% F-49.9% |
| Banorë për 1/Km2 | 81 |
| Jetëgjatësia ndër vite | M-73.5 F-77,4 |
| Mosha mesatare e popullatës | 39 vite |
| Student të diplomuar<br>% e studentëve deri diplomike | 10.465<br>79 % |
| Fuqia punëtore | 948.599 |
| Të punësuar | 723.550 |
| Të papunësuar | 225.049 |
| % e papunësisë | 23.7% |
| %e varfërisë, % nga popullsia | 21.5% |

Burimi: Makstat.gov.mk

Pjesa më e madhe e popullatës është e re dhe mosha meatare e popullatës është 39 vite. E tërë popullata ndikohet nga gjendja ekonomike, e në veçanti, të rinjtë, gratë dhe fëmijët. Shkalla më e lartë e papunësisë është sidomos në radhët e popullatës së re (grup-mosha 16-24 vjeçare), ndër gratë dhe në zonat rurale. Në RMV në vitin shkollor 2016/17 janë regjistruar në shkollën fillore 20.602 nxënës, në shkollat e mesme 21.577 nxënës dhe në shkollat e larta 8.333 studentë.

RMV është shtet ku dominon sektori i bujqësisë dhe bënë pjesë në grupin e shteteve në zhvillim dhe një pjesë e konsiderueshme e popullatës janë shfrytëzues të mbështetjeve të ndryshme financiare. Në tabelën e më poshtme do të pasqyrojmë disa nga këto përkrahje financiare të popullatës.

Tabela nr. 4 Shfrytëzuesit e ndihmave sociale

| Lloji i përkrahjes financiare | Numri i shfrytëzuesve |
|---|---|
| Shfrytëzues minoren të ndihmës sociale | 14.758 |
| Shfrytëzues të moshës madhore të ndihmës sociale | 43.040 |
| Numri i familjeve shfrytëzues të ndihmës sociale | 26.160 |
| Numri i fëmijëve shfrytëzues të shtesave për fëmijë | 11.300 |

Burimi: Makstat.gov.mk

Mosha mesatare e popullatës është 39 vjeçare, që konsiderohet relativisht e re në krahasim me disa nga shtetet e rajonit. RMV ka një kontingjent të konsiderueshëm të rinjsh të cilët janë nxënës dhe student të rregullt. Në tabelën e më poshtme po ashtu, do të pasqyrojmë numrin e nxënësve të rregullt nëpër shkollat e fillore dhe të mesme.

Tabela nr.5 Numri i nxënësve dhe studentëve të rregullt të regjistruar

| Lloji i shkollës | Nr. i nxënësve/studentëve | Viti shkollorë |
|---|---|---|
| Shkolla fillore | 188.102 | 2018/19 |
| Shkollat e mesme | 71.650 | 2018/19 |
| Student të regjistruar në studime deridiplomike | 56.941 | 2017/18 |
| Numri i studentëve të diplomuar | 7.698 | 2018 |

Burimi: Makstat.gov.mk

Emigrimi nga trojet e RMV ka filluar qysh herët dhe veçanërisht është evident emigrimi i dhunshëm i popullatës shqiptare dhe turke pas luftërave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore drejt Turqisë dhe SHBA-ve. Emigrimi politik ka vazhduar deri kah fundi i viteve 70 të shekullit 20. Në vend të kësaj popullate të emigruar dhunshëm vendosen imigrantë po ashtu politik serb me çka në shumë regjione dhe qytete e ndryshojnë tërësisht strukturën kombëtare. Valë tjetër e emigrimit të popullatës nga Maqedonia e Veriut janë vitet e 70-80 të shekullit 20, ku emigrojnë një numër i madh i të ashtuquajturit punëtor të përkohshëm në shtetet e Evropës Perëndimore, SHBA, Kanada dhe Australi ku tendenca për emigrim, në radhë të parë, ka qenë e nxitura nga

përndjekja politike e më së shumti për arsye ekonomike, etj. Pra, arsyet kryesore të emigrimit konsiderohet të kenë qenë: arsyet politike, arsyet ekonomike, arsyet sociale, etj.

Republika e MV ballafaqohet me të ashuquajturën “murtaja e bardhë” në përmasa të mëdha dhe të pandalshme. Nga ata që emigrojnë, pjesa dërmuese e tyre janë persona të papunë të moshës së re, fakt që me siguri në të ardhmen do të ndikon negativisht në tregun e punës. Pjesa dërmuese e personave që emigrojnë e bëjnë këtë në kërkim për një jetë më të mirë. Sipas disa të dhënave më se 30% njerëzve me shkollim të lartë jetojnë apo punojnë jashtë territorit të RMV. Sipas të dhënave të BB numri i qytetarëve që jetojnë dhe punojnë jashtë territorit të vendit është mbi gjysmë milioni që paraqet ¼ e popullatës së përgjithshme të vendit. Po ashtu, është me rëndësi të theksohet fakti se afër 80% e studentëve të fakulteteve të shkencave natyrore mendojnë, planifikojnë dhe përgatiten të emigrojnë jashtë vendit.

Në raport të strukturës së moshës, popullata në Maqedoni gjithnjë e më shumë po plaket. Në periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2017, pjesëmarrja e popullsisë së re (0-14) në popullsinë e përgjithshme është zvogëluar nga 18.5% në 16.5%, ndërsa pjesëmarrja e popullatës së moshuar (mbi 65 vjet) është rritur nga 11.4% në 13,7%. Në vazhdim do të paraqesim tabelën në të cilën pasqyrohet punësimi dhe papunësia ndër vite.

Tabela nr.6 Punësimi dhe papunësia në RMN nga viti 2007 -2017

| Viti | 2007 | 2012 | 2017 |
|---|---|---|---|
| Të punësuar | 590.234 | 650.554 | 740.648 |
| % e të punësuarve | 36.2% | 39.0% | 44.1% |
| Të papunësuar | 316.905 | 292.502 | 213.564 |
| % e papunësisë | 34.9% | 31.0% | 22.4% |

Burimi: Makstat.gov.mk

Hapja e fakulteteve publike (disperzimi i tyre) nëpër shumë qytete të RMV bëri që të rritet numri i të diplomuarve dhe njëherit të rritet edhe numri i të papunëve me shkollim të lartë. Në

ISSN 1857-7482, Nr. 22, 2019 www.eust.edu.mk/Heritage/

dekadën e fundit, papunësia tek personat që kanë kryer fakultet rritet me një tempo më të madhe, në krahasim me punësimin e tyre. Për këto vite janë punësuar afër 6.000 të diplomuar, por në të njëjtën kohë janë rekrutuar mbi 41.424 kuadro me fakultet të kryer që kanë marë statusin e "të papunësuarve".

Tabela nr.7 Të punësuarit dhe të papunësuarit me fakultet në RM nga viti 2010-2015

| Vitet | Të punësuar me fakultete | Të papunë me fakultete |
|---|---|---|
| 2010 | 112.982 | 36.652 |
| 2011 | 134.922 | 41.878 |
| 2012 | 135.698 | 45.768 |
| 2013 | 127.333 | 44.003 |
| 2014 | 134.103 | 40.389 |
| 2015 | 152.108 | 41.424 |

Burimi: Makstat.gov.mk

Nëse vazhdon të kjo tempo e ngadalshme e punësimit, sipas parashikimeve pas 30 vitesh do të bëhet një numër i madh i të papunëve, që do të jetojnë nga ndihmat sociale. Së shpejti mund të shndërrohemi si disa ish shtete socialiste që u bënë shtete të pensionistëve.

Një nga treguesit që mund të detekton më shpejt emigrimin e popullsisë është pakësimi i fuqisë punëtore, veçmas tek njerëzit me moshë prej 15-49 vitesh. Gjatë vitit 2015 në këtë grup moshe, në tregun e punës ka një zvogëlim prej mbi 12.500 personash, si të gjinisë femërore ashtu edhe asaj mashkullore. Nga ky fakt del edhe konkluzioni që vazhdimisht kemi më pak të papunësuar, popullatë më të vogël me aftësi punuese dhe gjithnjë e më pakë banorë. Shkalla e papunësisë nuk do të pësojë ndryshime të mëdha për shkak të emigrimit, pasi ajo është raporti në mes numrit të papunësuarve dhe numrit të personave të aftë për punë. Pra, personi i papunësuar i

cili emigron do të ndikon edhe tek të papunësuarit edhe tek numri i popullatës aktive për punë, kështu që raporti në mes këtyre dy numrave nuk do të ndryshojë në masë të madhe.

Arsyet kryesore të emigrimit të popullatës janë ekonomike, politike dhe sociale. Në pyetësorin e përgatitur rreth arsyes së emigrimit janë përgjigjur 127 të anketuar. Prej tyre janë 98 që mendojnë te emigrojnë apo kanë tentuar më së paku një herë të emigrojnë, ndërsa pjesa tjetër (29) janë individ që kanë emigruar dhe janë të punësuar në shtetet e Evropës perëndimore. Të anketuarit janë banorë nga më shumë qytete të RMV.

Pyetësori

(1 nuk ka ndikim, 2 ndikim mesatar dhe 3 ndikim të lartë)

| Nr. ren. | Arsyet e emigrimit | 1 | 2 | 3 |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Papunësia apo punësimi i pjesshëm 2+76+261= 339 | 2 | 38 | 87 |
| 2. | Pagat e ulëta 326 | 7 | 41 | 79 |
| 3. | Dëshira për një jetë më të mirë, 313 | 7 | 33 | 80 |
| 4. | Zhvillimi i ulët dhe i ngadalshëm ekonomik 306 | 17 | 41 | 69 |
| 5. | Mungesa e shërbimeve 298 | 21 | 41 | 65 |
| 6. | Mungesa e lirisë dhe autonomisë në vendin e punës 294 | 38 | 47 | 54 |
| 7. | Mungesë e kushteve adekute në vendin e punës 290 | 15 | 61 | 51 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 8. | Institucione të pa përshtatshme dhe joefikase<br>278 | 30 | 43 | 54 |
| 9. | Dëshira për një kualifikim më të lartë<br>244 | 41 | 55 | 31 |
| 10. | Përkeqësimi i sistemit arsimor;<br>243 | 45 | 48 | 34 |
| 11. | Paqëndrueshmëria politike, konfliktet, luftërat<br>236 | 51 | 43 | 33 |
| 12. | Trazirat sociale (grevat, demonstratat)<br>229 | 49 | 54 | 24 |
| 13. | Mungesa e fondeve për kërkim dhe zhvillim, mungesa e mjeteve dhe pajimeve profesionale<br>225 | 57 | 42 | 28 |
| 14. | Mungesa e sigurisë dhe niveli i lartë i krimit<br>219 | 55 | 52 | 20 |
| 15 | Mungesa e transportit dhe strehimit<br>211 | 58 | 54 | 15 |
| 16 | Diskriminimi në vendin e punës në baza nacionale, fetare<br>208 | 58 | 57 | 12 |
| 17. | Mungesa e traditës shkencore dhe kulturës<br>195 | 74 | 38 | 15 |
| 18 | Pavarësi nga prindërit<br>180 | 84 | 33 | 10 |

Ashtu siç theksuam se njëra ndër arsyet kryesore që emigrojnë banorët e RMV janë faktorët ekonomik. Nga pyetjet e parashtruara (nëse i shumëzojmë vlerat) shikohet qartë se papunësia apo punësimi i pjesshëm është shkaku kryesorë i emigrimit me 339 pikë. Si shkaktarë i dytë i emigrimit me 326 pikë është paga e ulët që e marrin punonjësit nga punëdhënësit. Dëshira për një jetë më të mirë (313 pikë) dhe zhvillimi i ulët dhe i ngadalshëm ekonomik po ashtu janë faktorë që e nxisin popullatën të emigrojë.

Përveç shkaktarëve ekonomik edhe ato politik dhe social po ashtu ndikojnë në emigrimin e popullsisë. Mungesë e shërbimeve (298), mungesa e lirisë dhe autonomisë (294), institucione të pa përshtatshme dhe joefikase (278), dëshira për një kualifikim më të lartë (244), përkeqësimi i sistemit arsimor (243) ndikojnë dukshëm në emigrimin e popullsisë nga RMV.

Paqëndrueshmëria politike, konfliktet dhe luftërat (236), trazirat sociale (grevat, demonstratat) (229), janë faktor me ndikim mesatar që ndikojnë në emigrimin. Edhe pse është menduar se problemet politike kanë ndikim të lartë në emigrim, sipas rezultateve nga ky pyetësorë del se ato janë faktorë të grupit të tretë. Mungesa e fondeve për kërkim dhe zhvillim, mungesa e mjeteve dhe pajimeve profesionale (225), mungesa e sigurisë dhe niveli i lartë i krimit (219), mungesa e transportit dhe strehimit (211) po ashtu i takojnë grupit të tretë të faktorëve që e nxisin emigracionin nga RMV.

Diskriminimi në vendin e punës në baza nacionale dhe fetare (208), mungesa e traditës shkencore dhe kulturës (195) si dhe pavarësia nga prindërit (180) janë tre faktorët që më së paku kanë ndikim në emigrimin e popullatës.

## KONKLUZION

Trendi i emigrimit të popullatës vazhdon nga RMV, shteti nuk ka të dhëna të saja statistikore për emigrimin, por emigrimi i tyre ndikon në humbjen e potencialit njerëzor dhe fuqisë punëtore e nevojshme për zhvillimin në të ardhmen. Emigrimi i madh, përveç tjerash do të ketë edhe pasoja të mëdha demografike që do ndikojnë në të gjitha sferat e shoqërisë.

Problemi kyç është regjistrimi, të gjitha numrat që publikohen duhet të merren me një rezervë. Regjistrimi është kurcial që të fitohet një pasqyrim real i gjendjes. Në mungesë të regjistrimit, të ballafaquar me emigrimin e vazhdueshëm të njerëzve, vështirë është që në bazë të tregut të fuqisë punëtore të pasqyrohet gjendja reale.

Të bëhet strategji në nivel shtetëror për ndalimin e emigrimit dhe kthimin e atyre që kanë emigruar;

Qeveria e RMV duhet të ndërpret heshtjen mbi problematikën e emigracionit dhe duhet të jetë e gatshme të merr pjesë në debatet e vështira mbi emigracionin;

Qeveria të ndërmerr masa makroekonomike që do të mundëson një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;

T'u mundësohet bizneseve të japin paga më të larta punonjësve duke i ulur kontributet nga paga dhe tatimin mbi pagat dhe të krijohen kushte më të mira për jetë;

Dhënien e përkrahjeve financiare, subvencioneve dhe lehtësimeve të ndryshme tatimore, veçanërisht të rinjve për themelimin e bizneseve të tyre;

Të bëhen lehtësime tatimore për themelimin e ndërmarrjeve nga ana e emigrantëve që do të ktheheshin të jetojnë dhe veprojnë në vend;

Të themelohet park teknologjik me ndërmarrje të themeluara nga persona të emigruar jashtë vendit;

Nevojiten politika për kyç jen e të rinjve në proceset shoqërore;

Përkrahja e bizneseve ekzistuese, në aspektin financiar, për çdo punësim të të rinjve dhe atyre që kanë kryer fakultet apo nivele më të larta të edukimit.

Reformimin e sistemit arsimor, duke filluar që nga ai fillor e deri në sistemin e lartë arsimore, duke vendosur programe dhe metoda të reja arsimore, duke i përshtatur edhe kërkesave të tregut të fuqisë punëtore. Arsimi i mesëm të reformohet tërësisht duke përgatitur për punë.

Afrimi me BE-në nuk do ta ndërpret migrimin, ndoshta edhe e përkeqëson gjendjen, prandaj qeveria duhet që së bashku me BE-në të analizojnë pasojat e emigrimit. Shtetet anëtare të BE-së të mundësojnë hapjen e vendeve të punës në RMV, të përforcojnë kapacitetet nga sfera e shkencës, hulumtimit dhe teknologjisë, që në afat të shkurtër do të sjellë dobi dhe do t'i motivon njerëzit të ngelin në vendin e tyre. BE banorëve të RMV t'u ofron leje pune për 3 apo 4 muaj – veçanërisht në fushën e turizmit, ushqimit organik, energjinë rinovuese, etj. që do t'i aftësonte dhe përgatitë me shkathtësi dhe njohuri të reja që ato të hapnin bizneset e tyre në vendin e origjinës.

**Biblografia:**


- Arnold, Guy, 2012, Migrimi: ndryshimi i botës, Londër: Pluto.
- Allyn and Bacon. Bernard, Russel, H., 2006, Metodat e hulumtimit në antropologji. Qasjet cilësore dhe sasiore [Botimi i katërt], Lanham: Shtypi "Alta Mira".
- Bauer, T. et al. (2000). What are Migration Networks? Discussion Paper No. 200. Bonn: Institute for the Study of Labor (IZA).
- Berg, Bruce, L., 2001, Metodat cilësore të hulumtimit në shkencat sociale [Botimi i katërt], Boston:
- Bonifazi, Corrado, et. al., (Bot.), 2008, Migrimi Ndërkombëtar në Evropë: Prirjet e reja dhe metodat e reja të analizës, Amsterdam:
- Brettell, Caroline, Hollifield, James, Frank (Bot.) 2008, Teoria e Migracionit. Të flasim përtej disiplinave, Nju Jork: Routledge.
- Brown, Susan, K., Bean, Frank D. 2006, Modelet e asimilimit, të vjetrat dhe të rejat: shpjegimi i një procesi afatgjatë, http://www.migrationpolicy.org/article /

- Castles, Stephen, de Haas, Hein, Miller, Mark, J. (Bot.), 2013, Koha e migrimit: Lëvizjet ndërkombëtare të popullsive në botën moderne, Londër: Palgrave.
- Dahinden, J.. (2005). Pristina-Schlieren: Albanische Migrationsnetzwerke im transnationalen Raum. Zurich, Switzerland: Seismo Verlag.
- De Haas, H. (2005). International migration, remittances and development: Myths and facts. Third World Quarterly, 26(8), 1269-1284.
- Duckworth. Emmel, Nick, 2013, Kampionimi dhe përzgjedhja e rasteve në hulumtimin cilësor: një qasje realiste, Londër:
- ESPON, 2015, Aspektet territoriale dhe urbane të dyndjeve të emigrantëve dhe refugjatëve, https://www.espon.eu/main/,
- Faist, T. (2008). Migrants as transnational development agents: An inquiry into the newest round on the migration-development nexus. Population, Space and Place, 14, 21-42.
- Glick-Schiller et al. (1992). Towards a transnational perspective on migration: race, class, ethnicity, and nationalism reconsidered. New York: The New York Academy of Sciences..
- Gemi, Eda, Ulasiuk, Iryna, Triantafyllidou, Anna, 2013, Emigrantët dhe praktikat e medias dhe të shtypit,
- “Programi i mbështetjes së Këshillave për Integrimin e Emigrantëve, për sa i përket planifikimit dhe zbatimit të veprimtarive të integrimit, në nivel vendor”. Fondi Evropian i Integrimit të shtetasve nga vendet e Botës së Tretë,
- Integrimi i emigrantëve në shoqëritë evropiane: ndryshimet e kombeve dhe prirjet e konvergjencës, Stuttgart: Lucius dhe Lucius. INSTAT&IOM 2014,
- Levitt, P. (1998). Social remittances: Migration driven local-level forms of cultural diffusion. International Migration Review, 32(4), 926-948.

- Pries, L. (2008). Die Transnationalisierung der sozialen Welt. Frankfurt am Main, Germany: Suhrkamp Verlag.

- Metodat cilësore në studimet e migrimit: një këndvështrim kritik dhe realist, Londër: Routledge. Kasimis, Charalambos, Kassimi, Chryssa, 2004,

- Hulumtimi cilësor nga fillimi në fund, Londër: Shtypi "Guilford".

- Zlotnik, Hania, 1998, Migrimi ndërkombëtar 1965-96: Një vështrim, Vështrimi i popullsisë dhe zhvillimit, 24(3), f. 429-468.

# TË DREJTAT E NJERIUT DHE SFIDAT E SË ARDHMES

**MSc. Abidin TRENA**

**(a.trena@eust.edu.mk)**

**Abstrakt**

Suksesi në realizimin e të drejtave të njeriut kërkon sukses edhe në fusha të tjera, përfshirë ndërtimin e qeverive më të afta, të përgjegjshme, të efektshme dhe jo të korruptuara, që kanë të bëjnë me shtetet e dështuara, rritjen e produktivitetit ekonomik, përmirësimin e statusit të fuqisë së grave, përmirësimin e arsimit, etj. dhe menaxhimin e tensioneve ndërkombëtare dhe konflikteve. Realizimi i të drejtave të njeriut në të gjithë botën është një punë e vështirë që kërkon shumë veprimtarë që kryejnë lloje të ndryshme pune. Të drejtat e njeriut tani pranohen më gjerësisht sesa janë pranuar ndonjëherë. Ato bëhen pjesë e monedhës së marrëdhënieve ndërkombëtare, dhe shumica e vendeve marrin pjesë në sistemin e të drejtave të njeriut. Megjithatë, duke i analizuar trendet bashkëkohore dhe nevojat e shoqërisë sës sotme, të drejtat e njeriut nuk janë në nivelin e duhur qoftë për nga zbatimi i tyre, qoftë për nga rregullimi që i'u është bërë atyre me kodifikimet juridike nga shtetet individuale.

**Fjalë kyçe:** *e drejtë, sfidë, barazi, evoluim*

## 1 - HYRJE

Definimin e të drejtave të njeriut e gjejmë në përkufizimin që jep Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, sipas së cilës, Të drejtat e njeriut janë të drejta të natyrshme për të gjitha qeniet njerëzore, pavarësisht kombësisë, vendbanimit, seksit, origjinës kombëtare ose etnike, ngjyrës, fesë, gjuhës ose ndonjë statusi tjetër. Të gjithë ne kemi të drejtë në mënyrë të barabartë për të drejtat tona njerëzore pa diskriminim. Këto të drejta janë të gjitha të ndërlidhura, të ndërvarura dhe të pandara.[1]

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të drejta, të cilat i përkasin çdo njeriu që nga lindja. Ato nuk 'fitohen' dhe nuk varen nga statusi i individit në fjalë. Ato janë universale, të pandashme, të patjetërsueshme dhe të padhunueshme, d.m.th.: Universale – Të drejtat dhe liritë themelore u përkasin të gjitha qenieve njerëzore, në mënyrë të barabartë dhe pa u diskriminuar për asnjë shkak apo arsye. Ky parim është parashikuar në nenin 1 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, sipas të cilit: "Të gjithë njerëzit janë të lindur të lirë, me dinjitet dhe të drejta të barabarta". Universaliteti i të drejtave nuk prek diversitetin e individëve ose të kulturave të ndryshme. Universalitet nuk do të thotë uniformitet.

Të pandashme dhe të ndërvarura – I referohet faktit se të gjitha të drejtat kanë rëndësi; ato duhet të konsiderohen kolektivisht, dhe nuk duhet të ndahen. Parimi i ndërvarësisë, nënvizon sidomos faktin se të drejtat janë të ndërlidhura me njëra - tjetrën dhe mosrealizimi i një të drejte mund të sjellë mohimin ose mosrealizimin e një të drejte tjetër.

Të patjetërsueshme dhe të padhunueshme – I referohet faktit që të drejtat e njeriut nuk mund t'i hiqen apo t'i mohohen askujt, qoftë edhe me pëlqimin dhe miratimin e tij, dhe asnjëri nuk mund të heqë dorë nga këto të drejta.

Duhet theksuar se koncepti "Të drejtat e njeriut" nuk është parim thjesht deklarativ. Të drejtat janë të detyrueshme për realizim në natyrën e tyre, dhe duhen gëzuar nga të gjithë individët.

Në këndvështrimin e mësipërm, nënvizojmë fjalët e Deklaratës së Konferencës Botërore për të Drejtat e Njeriut dhe Planin e Veprimit të Vjenës (1993), ku afirmohet në paragrafin e pestë se: "Të gjitha të drejtat e njeriut janë universale, të pandashme, të ndërvarura dhe ndërlidhura.

[1] Web faqja e Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, "Çfarë janë të drejtat e njeriut?", https://www.ohchr.org/EN/Issues/Pages/WhatareHumanRights.aspx, shikuar më 15 nëntor 2019

Komuniteti ndërkombëtar duhet t'i trajtojë ato në të gjithë botën në një mënyrë të drejtë dhe të barabartë, me të njëjtën rëndësi dhe më të njëjtën peshë".[2]

Të drejtat e njeriut përbëjnë një sërë normash që rregullojnë trajtimin e individëve dhe grupeve nga shtetet dhe aktorët joshtetëror në bazë të parimeve etike në lidhje me ato që shoqëria i konsideron themelore për një jetë të mirë. Këto norma janë të përfshira në sistemet juridike kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat specifikojnë mekanizmat dhe procedurat për t'i mbajtur përgjegjësit e detyrave dhe sigurojnë dëmshpërblim për viktimat e pretenduara të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Aspirata për të mbrojtur dinjitetin njerëzor të të gjitha qenieve njerëzore, paraqet thelbin e konceptit për të drejtat e njeriut. Kjo aspiratë e vë qenien njerëzore në qendër të interesit. Kjo aspiratë është e bazuar në sistemin e përbashkët universal të vlerave të përkushtuara të të drejtës për jetë, si një e drejtë e paprekshme, dhe ofron një kornizë për ndërtimin e sistemit të të drejtave të njeriut, të mbrojtur nga normat dhe standardet e pranuara ndërkombëtarisht. Gjatë shekullit XX, të drejtat e njeriut janë zhvilluar si formulime morale, politike dhe ligjore dhe udhërrëfyese për zhvillimin e një bote të lirë nga frika dhe skamja.

## 2 - DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 1 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR), të miratuar nga Kombeve të Bashkuara në vitin 1948, u referohet shtyllave kryesore të sistemit të të drejtave të njeriut, të cilat janë liria, barazia dhe solidariteti. Liritë, siç janë liria e mendimit, ndërgjegjes, besimit, sikurse edhe ajo e opinionit dhe shprehjes, janë të mbrojtura nga të drejtat e njeriut. Ngjashëm, të drejtat e njeriut garantojnë barazi, siç është mbrojtja e barabartë kundër të gjitha formave të diskriminimit për të gëzuar të gjitha të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe barazinë e plotë ndërmjet grave dhe burrave[3].

Solidariteti tregon të drejtat ekonomike dhe sociale, si të drejtën për sigurim social, shpërblim (pagë) të drejtë, një standard të mirë për jetesë, shëndet dhe qasje në arsim, të cilat janë

---

[2] Kathleen Imholz, Elsa Toska (Dobjani), Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut – Manual për administratën publike, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2016, fq.17

[3] Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR), https://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/

pjesë përbërëse të strukturës së të drejtave të njeriut. Këto të drejta janë të sistemuara në pesë kapituj; të drejtat politike, civile, ekonomike, sociale dhe kulturore dhe janë të definuara juridikisht në dy Pakte paralele, të cilat së bashku me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, krijojnë Ligjin mbi të Drejtat e Njeriut.

"Të gjitha të drejtat e njeriut për të gjithë" ishte parulla e Konferencës Botërore për të Drejtat e Njeriut në Vjenë, të vitit 1993. Të drejtat e njeriut, janë ato që u japin fuqi individëve dhe bashkësive të kërkojnë transformimin e plotë të shoqërisë në drejtim të realizimit të plotë të të gjitha të drejtave të njeriut. Konfliktet duhet të zgjidhen me mjete paqësore, duke u bazuar në sundimin e ligjit dhe në strukturën e të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, të drejtat e njeriut mund të ngatërrohen mes vete; ato kufizohen nga të drejtat dhe liritë e të tjerëve ose nga kërkesat morale, publike, ose të rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme të një shoqërie deomokratike[4]. Të drejtat e të tjerëve, jo vetëm që duhet të tolerohen, por edhe duhet të respektohen. Të drejtat e njeriut nuk mund të përdoren për shkeljen e të drejtave njerëzore të të tjerëve[5] ; kështu që, edhe pse në disa situata të jashtëzakonshme dhe raste ekstreme, mund të vihen disa kufizime, të gjitha konfliktet duhet të zgjidhen në frymën e të drejtave të njeriut.

Prandaj, çdokush - gratë, burrat, të rinjtë dhe fëmijët duhet t'i dijnë dhe kuptojnë të drejtat e tyre njerëzore, që janë të rëndësishme për interesat dhe qëllimet e tyre. Kjo mund të arrihet përmes arsimimit dhe mësimit për të drejtat e njeriut, arsimim ky që mund të jetë zyrtar, jozyrtar ose joformal. Kuptimi i parimeve dhe procedurave të të drejtave të njeriut, ua mundëson njerëzve të marrin pjesë në vendimet që përcaktojnë jetën e tyre, të punojnë drejt zgjidhjes së konflikteve dhe ruajtjes së paqes të bazuar në të drejtat e njeriut, e cila është një strategji frytdhënëse e bazuar në interesat e popullit për zhvillim njerëzor, social dhe ekonomik.

Arsimimin për të drejta të njeriut duhet ta bëjnë të gjitha palët ose pjesëmarrësit, shoqëria civile, sikurse edhe qeveritë dhe kompanitë transnacionale. Përmes njohurive për të drejtat e njeriut, mund të zhvillohet vërtet një "kulturë mbi të drejtat e njeriut", e bazuar në respektimin, mbrojtjen, përmbushjen, zbatimin dhe praktikimin e të drejtave të njeriut. E drejta për arsimim për të drejtat e njeriut mund të nxirret nga, sipas të cilit "çdokush ka të drejtën për arsimim . . .

[4] Neni 29, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR), https://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/
[5] Neni 30, po aty.

Arsimimi duhet të orientohet drejt zhvillimit të plotë të personalitetit të njeriut dhe forcimit të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut . . .”[6].

## 3 - AKTE TË TJERA MBI TË DREJTAT E NJERIUT

Resoluta 49/184, e 23 dhjetorit 1994, e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, duke proklamuar Dekadën e OKB-së për Arsimim për të Drejtat e Njeriut, flet për procesin e mësimit të përhershëm dhe gjithëpërfshirës, ndërsa Plani Veprues i Dekadës së OKB-së për Arsimim në fushë të të Drejtave të Njeriut 1995-2004, jep definicionin e detajuar për Arsimimin për të Drejtat e Njeriut dhe elaboron përmbajtjen dhe metodikën e mësimit[16]. Rezoluta 49/184 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, e 23 dhjetorit 1994, duke shpallur Dekadën e OKB-së për HRE (Arsimim për të Drejtat e Njeriut ) thekson: “shkollimi mbi të drejtat e njeriut duhet të përfshijë më tepër se vetëm pjesën informative dhe duhet të jetë proces i përhershëm dhe gjithëpërfshirës në të cilin njerëzit e të gjitha niveleve të zhvillimit dhe shtresave të shoqërisë mësojnë për respektin ndaj dinjitetit të të tjerëve, si dhe për mjetet dhe metodat e sigurimit të atij respekti në të gjitha shoqëritë[7].”

Plani Veprues i Dekadës së Kombeve të Bashkuara për Arsimim mbi të Drejtat e Njeriut (1995-2004), thekson: . . . shkollimi për të drejtat e njeriut duhet definuar si trajnim, shpërndarje dhe përpjekje për informim, përmes transmetimit të diturisë dhe aftësive, me qëllim të ndërtimit të kulturës universale për të drejtat e njeriut, si dhe krijimit të sjelljeve në drejtim të:

(a) Forcimit të respektimit për të drejtat dhe liritë fundamentale të njeriut;

(b) Zhvillimit të plotë të personalitetit të njeriut dhe kuptimit të dinjitetit të tij;

(c) Proklamimit të kuptimit, tolerancës, barazisë gjinore, miqësisë mes gjitha kombeve, popujve vendës dhe grupeve racore, kombëtare, etnike, fetare dhe gjuhësore[8];

Në deklaratën e Dekadës së OKB-së për Arsimim për të Drejtat e Njeriut (1995-2004), të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, thuhet se duhet kërkuar: “edhe kuptimet

---

[6] Neni 25, po aty.

[7] “Pyetje për të drejtat e njeriut: pyetje për të drejtat e njeriut, përfshirë qasjet alternative për përmirësimin e gëzimit efektiv të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, fq. 2, https://undocs.org/pdf?symbol=en/A/51/506/Add.1

[8] Po aty, fq.5.

më të gjera të të gjitha normave, koncepteve dhe vlerave të mbrojtura nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut"[9]. Shtytësi kryesor pas kësaj iniciative ka qenë Shulamith Konig (Shulamith Koenig), themeluesja e Dekadës Popullore për Arsimim për të Drejtat e Njeriut (PDHRE), e cila ka për qëllim hiç më pak sesa vizionin afatgjatë për mundësinë që çdo individ i planetit tonë të ketë qasje në të drejtat e njeriut, "që njerëzit t'i dijnë dhe t'i kërkojnë ato". Prandaj, qëllimi i arsimimit për të drejtat e njeriut është "shkollim i të gjithëve për të drejtat e njeriut". Ose, sipas fjalëve të Nelson Mandelës: të "ndërtohet një kulturë e re politike e bazuar në të drejtat e njeriut".

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, është hartuar si rezultat i shkeljeve më serioze të dinjitetit njerëzor, e veaçanërisht pas përvojës së Holokaustit gjatë Luftës së Dytë Botërore. Përqendrimi kryesor i saj është qenia njerëzore, kurse preambula e saj i referohet "*lirisë nga frika dhe skamja*". Një qasje e ngjashme është e pranishme edhe te koncepti i sigurisë njerëzore.

Gjatë *Takimit Punues Ndërkombëtar për Siguri Njerëzore dhe Arsimim mbi të Drejtat e Njeriut*, në korrik të vitit 2000 në Grac, është theksuar se siguria njerëzore ka për qëllim që përmes parandalimit të konflikteve dhe adresimit të hollësishëm të shkaqeve të pasigurisë dhe nënshtrimit t'i mbrojë të drejtat e njeriut[10]. Strategjia e sigurisë njerëzore ka për qëllim krijimin e kulturës politike globale të bazuar në të drejtat e njeriut. Në këtë kontekst, arsimimi për të drejtat e njeriut paraqet një strategji në drejtim të realizimit të sigurisë njerëzore, pasi që i mëson njerëzit që zgjidhjet e problemeve të tyre t'i kërkojnë para së gjithash në bazat e sistemit të vlerave të përgjithshme globale, të mbështetura në sundimin e ligjit dhe në të drejtën, e jo duke u bazuar në pushtet.

Siguria njerëzore promovohet nëpër shoqëri në formë të decentralizuar, duke filluar nga nevojat themelore të njerëzve, si ato të grave ashtu edhe të burrave, që do të thotë se fillohet nga problemet e sigurisë personale, varfërisë, diskriminimit, drejtësisë sociale dhe demokracisë. Liria nga eksploatimi ose korrupsioni fillon vetëm atëherë kur njerëzit nuk pranojnë, që të drejtat e tyre të shkilen edhe më tutje. Institucionet e shoqërisë civile (sikuse *Transparenca Ndërkombëtare*), përkrahin procesin e tillë të emancipimit, të bazuar në njohuritë mbi të drejtat e njeriut.

[9] Po aty.
[10] http://www.manual.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETC-Hauptseite/publikationen/Occasional_papers/pilotstudy.pdf

Ekzistojnë disa lidhje ndërmjet të drejtave të njeriut dhe sigurisë njerëzore. "*Siguria*" në formë të sigurisë personale (si p.sh. mbrojtja nga arrestimi arbitrar), sigurisë sociale (si p.sh. sigurimi i nevojave themelore sikurse ushqimi) dhe sigurisë ndërkombëtare (sikurse e drejta për të jetuar në një rend ndërkombëtar të sigurt), përputhet me të drejtat ekzistuese të njeriut. "*Politikat e sigursë duhet të integrohen më shumë me strategjitë për promovimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe zhvillimit. Të drejtat e njeriut, e drejta humanitare dhe e drejta e refugjatëve ofrojnë kornizën normative mbi të cilën bazohet qasja e sigurisë njerëzore.*[11]"

Cenimet e të drejtave të njeriut paraqesin kërcënime për sigurinë njerëzore, prandaj përdoren si indikatorë në kuadër të mekanizmave për paralajmërim të hershëm, me qëllim të parandalimit të konflikteve. Sidoqoftë, të drejtat e njeriut gjithashtu luanë rol gjatë periudhës së pasluftës, për menaxhimin dhe transformimin e konflikteve, si dhe për ndërtimin e paqes. Përmes transferit të dijes, ndërtimit të aftësive dhe formësimit të sjelljeve, arsimimi në fushën e të drejtave të njeriut përbën bazën e kulturës së vërtetë të parandalimit.

Përveç që të drejtat e njeriut janë një instrument esencial për parandalimin e konfliktit, ato janë gjithashtu bërthamë e konceptit të ndërtimit të qeverisjes dhe demokracisë. Gjithashtu, ato ofrojnë bazë që përmes pjesëmarrjes aktive, ngritjes së transparencës dhe ngritjes së përgjegjësisë, të bëjnë trajtimin e problemeve shoqërore dhe globale. "*Ndërtimi i qeverisjes*" përbëhet nga dy forma komplementare të ndërtimit të kapacitetve: "*ndërtimit të shtetit*" dhe "*ndërtimit të shoqërisë*". Ndërtimi i shtetit ofron "*siguri demokratike*", që më së miri mund të shihet pas përfundimit të konfliktit në përpjekjet për rehabilitim dhe rindërtim. "*Zhvillimi shoqëror përfshin arsimimin e gjerë për të drejtat e njeriut, me qëllim të aftësimit të njerëzve për kërkimin e të drejtave të tyre dhe respektim të të drejtave të të tjerëve*" (Walther Lichem, Ministria Federale e Austrisë për Marrëdhënie të Jashtme).

Neni 3 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR) dhe Neni 9 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, gjithashtu, mbrojnë të drejtën e lirisë dhe sigurisë perosnale, të cilat në veçanti i referohen lirisë nga frika. Përveç këtyre, neni 22 i UDHR dhe neni 9 i Paktik Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, njohin të drejtën për sigurim social, e cila së bashku me të drejtat e tjera sociale përputhen me lirinë nga skamja. Raporti

[11] "Siguria Njerëzore: Siguria e Njerëzve në Botën e Ndryshueshme, Departamenti i Marrëdhënieve të Jashtme dhe Tregtisë Ndërkombëtare", Kanada 1999 http://www.summit-americas.org/Canada/HumanSecurity-english.htm

mes globalizimit dhe sigurisë njerëzore është shqyrtuar edhe nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Kofi Annan, në Raportin e Mileniumit të 2000-të, i cili gjithashtu, bën dallimin mes **lirisë nga frika** dhe **lirisë nga skamja**, dallim i cili kthehet prapa te katër liritë e proklamuara gjatë Luftës së Dytë Botërore në vitin 1940, nga presidenti i SHBA-ve Ruzvelt (Roosevelt), si vizion i tij për rendin e vendosur pas përfundimit të luftës. Lufta kundër varfërisë dhe ajo për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore është po aq e rëndësishme për siguri, sa edhe lufta për liri politike dhe liri fundamentale. Sidoqoftë, njëra nuk mund të veçohet nga tjetra, ato janë të varura në mënyrë të ndërsjellë dhe janë të pandashme.

Siguria njerëzore paraqet mundësinë për gëzimin e rezultateve të zhvillimit njerëzor. Në bazë të Raportit të Zhvillimin Njerëzor të UNDP-së, të vitit 2000, ashtu si të drejtat e njeriut, edhe zhvillimi njerëzor, kanë vizionet dhe qëllimet e njëjta. *Treguesit për Zhvillim Njerëzor*, i cili përdoret në raportet e UNDP-së për zhvillim njerëzor, përmbajnë disa indikatorë, siç janë, qasja në arsimim, sigurimi i ushqimit, shërbimet shëndetësore, barazia gjinore dhe participimi politik, të cilat përputhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me të drejtat e njeriut. "*Raporti mbi Zhvillimin Njerëzor*", është përqendruar në kërcënimet e sigurisë njerëzore.[12]

Arrihet në përfundimin se, konceptet e sigurisë njerëzore, të të drejtave të njeriut dhe zhvillimit njerëzor janë të ndërlidhura ngushtë dhe përforcohen në mënyrë reciproke.

## 4 - E ARDHMJA DHE SFIDAT E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Kur shqyrtohet e ardhmja e të drejtave të njeriut dhe nëse ato do të konsiderohen më shumë ose më pak të rëndësishme në vitet në vazhdim, vijnë në mendje shumë sfida të mundshme: ndryshimi i klimës, nacionalizmi, pabarazia, autoritarizmi në rritje. Në fund të fundit, shumë nga këto kërcënime të ndryshme janë të lidhura me njëra-tjetrën në mënyra komplekse - për shembull, pabarazia ka nxitur nacionalizëm dhe ndryshimi i klimës mund të rrisë pabarazinë. Por ata gjithashtu varen nga përgjigjja e një pyetjeje më të thelluar: "Sa të rëndësishme janë të drejtat e njeriut në përgjithësi?"

Për arsye se, ka të ngjarë të ngecë në përparimin e të drejtave të njeriut, njerëzit në mbarë botën thjesht nuk i konsiderojnë ato aq të rëndësishme sa avokatët e tyre. Kur bëhet fjalë për një

[12] "Raportit të Zhvillimit Njerëzor", 2000, OKB, http://hdr.undp.org/sites/default/files/reports/261/hdr_2000_en.pdf

shkëmbim midis të drejtave të njeriut dhe gjërave të tjera që njerëzit i konsiderojnë të nevojshme - mirëqenia e tyre materiale, siguria e tyre, mundësitë dhe arritjet e fëmijëve të tyre - ka mjaft shembuj për të sugjeruar që njerëzit nuk kanë dëshirë të bëjnë sakrifica për të realizuar të drejtat.

Si një rrezik global mjedisor, ndryshimi i klimës ndikon në gëzimin e të drejtave të njeriut në tërësi dhe për këtë arsye, ai është në thelb të natyrës së pandashme, të ndërvarur dhe të ndërlidhur me secilën dhe të gjitha të drejtat e njeriut siç theksohet fillimisht nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Në të vërtetë, grupet e margjinalizuara, qoftë në vendet e industrializuara apo ato në zhvillim dhe nëpër të gjitha kulturat dhe kufijtë, janë veçanërisht të prekshëm nga pasojat e rënda të ndryshimit të klimës. Për shembull, fermerët në shkallë të vogël, gratë në zonat rurale, ato që nuk kanë qasje adekuate në ujë të pijshëm të sigurt, kujdes shëndetësor dhe sigurim shoqëror, refugjatë, të zhvendosur brenda vendit dhe të varfër që tashmë jetojnë në kufijtë e mbijetesës do të vuanin në mënyrë disproporcionale pasojat e ngrohjes globale.[13]

Le të marrim tre shembuj të dukshëm. Së pari, pabarazia. Edhe në shoqëritë më të respektuara të të drejtave, shpesh ka ngurrim midis sektorëve kryesorë të popullatës për të rishpërndarë të ardhurat përmes normave më të larta të taksave. Për shumë njerëz më të varfër, asgjë nuk do të bënte më shumë ndryshim sesa qasja e besueshme në arsim me cilësi të lartë dhe kujdes shëndetësor. Ne e dimë se mbështetja vetëm në zgjidhjet e sektorit privat krijon pabarazi të konsiderueshme, por shumë njerëz thjesht nuk janë të gatshëm të paguajnë më shumë për t'i dhënë të gjithëve standardin më të lartë të mundshëm të trajtimit mjekësor dhe shkollimit.

Ose merrni trajtimin e refugjatëve. Siç e kanë njohur shumë studiues, ne nuk jemi kurrë kaq të vetëm dhe kurrë më shumë nevojë për të drejtat tona njerëzore sesa kur nuk kemi mbrojtjen e një qeverie kombëtare. Kur jemi refugjatë, gjithçka që kemi është “njerëzimi” ynë.

Por larg këtij shqetësimi që shkakton thellë në mesin e popullatave të pasura, përkundrazi duket se ka nxitur një lloj paniku moral rreth imigracionit në Evropë dhe ka çuar në ngritjen e politikanëve të krahut të djathtë. Vendimi i guximshëm i kancelarisë gjermane Angela Merkel për të hapur kufijtë gjermanë për një milion refugjatë nga Siria e ka dobësuar atë politikisht, dhe lejoi në politikën gjermane lëvizje të ekstremit të djathtë.

[13] “Climate change and human rights”, Zyra e Komisarit të lartë për të Drejtat e Njeriut, https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/Climate.aspx, shikuar më 20 nëntor 2019

Asgjë nuk do të duket se do të ishte më e rëndësishme për një angazhim për të drejtat e njeriut sesa pretendimi se askush nuk duhet të torturohet. Sidoqoftë, kur shohim sondazhet e opinioneve mbi qëndrimet ndaj torturës, zbulojmë mbështetje të gjerë për torturat, të krijuara për të trajtuar kërcënimet e sigurisë kombëtare. Këtë logjikë ndëshkuese mund ta shohim edhe në rastet e dënimit me vdekje në shumë vende, ku e vetmja arsye për t'i rezistuar dënimit me vdekje që merr ndonjë tërheqje është frika e ekzekutimit të një personi të pafajshëm, sesa e drejta themelore e njeriut për jetën.

Në fakt, ne mund të shohim qëndrime të tilla të përsëritura në një gamë të tërë të çështjeve të lirisë civile, nga liria e informimit deri tek liria e shtypit, nga liria e fjalës deri tek liria nga mbikëqyrja. Kur përballen me kërcënime të mëdha, njerëzit në të vërtetë do të sakrifikojnë një pjesë të mirë të lirisë - lirinë e të tjerëve, por përfundimisht edhe të tyre - për të mbajtur atë që ata kanë të sigurt nga dëmtimi.

Shtetet demokratike duhet të plotësojnë kërkesat e disa koalicioneve të qytetarëve të tyre. Nëse ata humbin mbështetje të mjaftueshme midis grupeve kryesore brenda qytetarisë së tyre, atëherë qeveria do të humbasë fuqinë ose vetë shteti demokratik mund të vihet nën kërcënimin e rrëzimit.

Shumë vende perëndimore kanë anashkaluar prej kohësh nenin 29[14] sepse, në pjesën më të madhe, demokracitë e pasura janë në ngjitje që nga viti 1948. Por tani ata janë nën presion, dhe kontrata themelore sociale - marrëveshja që këto demokraci kanë me qytetarët e tyre - është befas në vëmendje. Kërcënimet e reja, siç janë pabarazia, ndryshimi i klimës dhe zëvendësimi i punës manuale nga makineritë, nënkupton ata që kanë frikë se kontrata e vjetër sociale nuk është më në interesin e tyre, ka bërë që zëri i tyre të dëgjohet.

Shtetet nuk i pëlqejnë shumë të drejtat - ato janë një bezdi ose siklet. Mbijetesa dhe lulëzimi i të drejtave të njeriut u kërkon njerëzve, qytetarisë, popullatës, të thonë se këto të drejta janë të rëndësishme dhe të kërkojnë që qeveritë e tyre t'i respektojnë ato. Dhe me të njëjtën logjikë, njerëzit mund t'i përmbysin ato.

[14] Neni 29 i DUDNJ, "Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tyre, të gjithë do t'i nënshtrohen kufizimeve të përcaktuara me ligj vetëm me qëllim të njohjes së duhur dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe përmbushjes së kërkesave të moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në një shoqëri demokratike."

## KONKLUZION

Të drejtat e njeriut janë në kohë të vështira, megjithatë ato janë të nevojshme tani më shumë se kurrë. Përkundër përparimeve historike në ligjin dhe mobilizimin e të drejtave të njeriut, një numër i paparë i njerëzve vuajnë krime lufte, shpërngulje të detyruar, përndjekje etnike, dhunë gjinore dhe reagime kundër mbrojtësve të të drejtave. Këto kohë të vështira në praktikë përputhen me kritikë të ashpër në teori. Nacionalistët dhe realistët pretendojnë se të drejtat e njeriut kërkojnë shumë nga shtetet sovrane, strukturalistët dhe skeptikët ligjorë thonë se të drejtat e njeriut nuk janë të mjaftueshme për të siguruar drejtësi sociale, ndërsa feministët post-moderne, post-koloniale dhe kritike argumentojnë se të drejtat liberale janë lloji i gabuar i politikës.

Qeveritë mbeten mbrojtësit kryesorë, por edhe shkelësit e të drejtave të njeriut siç përcaktohen në ligjin ndërkombëtar. Si rrjedhim, përpjekjet për të forcuar regjimin e mbrojtjes ndërkombëtare varen nga respektimi dhe zbatimi i detyrimeve të shteteve sipas ligjit ndërkombëtar humanitar, si dhe të drejtave të njeriut dhe ligjit të refugjatëve.

Vitet e fundit, shqetësimet e ngritura për sigurinë e shteteve kanë çuar gjithnjë e më shumë në praktika që injorojnë standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Në këtë proces, regjimi i mbrojtjes ndërkombëtare është minuar. Prandaj, përpjekjet e ardhshme për të përmbushur sfidat e vazhdueshme në sigurimin e mbrojtjes dhe ndihmës së duhur për ata në nevojë, do të jepnin rezultate të kufizuara në një botë ku e drejta ndërkombëtare është gjithnjë e më shumë në kërcënim.

**Bibliografia:**


- Web faqja e Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, "Çfarë janë të drejtat e njeriut?", https://www.ohchr.org/EN/Issues/Pages/WhatareHumanRights.aspx, shikuar më 15 nëntor 2019
- Kathleen Imholz, Elsa Toska (Dobjani), Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut – Manual për administratën publike, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2016, fq.17
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR)

- “Pyetje për të drejtat e njeriut: pyetje për të drejtat e njeriut, përfshirë qasjet alternative për përmirësimin e gëzimit efektiv të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, fq. 2, https://undocs.org/pdf?symbol=en/A/51/506/Add.1
- http://www.manual.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETC-Hauptseite/publikationen/Occasional_papers/pilotstudy.pdf
- “Siguria Njerëzore: Siguria e Njerëzve në Botën e Ndryshueshme, Departamenti i Marrëdhënieve të Jashtme dhe Tregtisë Ndërkombëtare”, Kanada 1999 http://www.summit-americas.org/Canada/HumanSecurity-english.htm
- “Raportit të Zhvillimit Njerëzor”, 2000, OKB, http://hdr.undp.org/sites/default/files/reports/261/hdr_2000_en.pdf
- “Climate change and human rights”, Zyra e Komisarit të lartë për të Drejtat e Njeriut, https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/Climate.aspx, shikuar më 20 nëntor 2019

# ADVENTAGES AND DISADVENTAGES ON USING VIDEOS IN THE CLASSROOM

**Rezarta Merko**
(**rezarta.merko@eust.edu.mk**)

**Reis Kerim**
(**r.kerim@eust.edu.mk**)

**Abstract**

Thanks to the internet and thanks to the global economy the world is becoming smaller. People every day try different methods to learn English language. People more and more use English language as a way to communicate between each other. But learning language today is very much related to technology. Technology is used in all aspects of life; it is included into most college projects and is required for every type of employment. Nowadays students need strong computer skills in order to compete in the global economy, which has pushed many countries towards integrating plans to ensure that graduates are ready to compete in the 21st century.

Surely it can't be argued that today's students need strong computer skills but integrating technology into the classroom is more than teaching essential computer skills. Technology can provide a richer, interactive learning experience and environment. There are many different ways how teachers can use technology in their classrooms, and each method provides several different benefits for students.

Education as a main factor for people's professional and non-professional development is making a progress by changing the methods for teaching and learning, adding new prototypes of teaching, introducing new ideas, using new technologies in its curricula.

In order to make the process of second language learning easier teachers must consider successful second language acquisition as one of their main goals and they must try to use all methods to make it quicker, more effective, easier, and logical.

**Keywords:** *using videos, classroom activities, era of computers, ESL, using technology*

## 1 - INTRODUCTION

According to some facts, the very first entry of the computers into the educational process especially language teaching process was in 1980's when the first software for second language teaching were approached and explained to the teachers in the workshops that they were attending at that time. Step by step and very unconsciously as we enter the 21st century everyday language use is so tied to technology that learning language through technology has become a fact of life with important implications for all applied linguists. Thanks to the internet and thanks to the global economy the world is becoming smaller. People more and more are using English language to communicate between each other, of course nowadays the approach of the internet is better than before so it helps a lot in experiencing and learning new things. It couldn't be easier to get video into the classroom these days, so why not take advantage of the wide variety of interesting contexts and easily-available authentic language?

In our opinion and based on our work with our groups we have thought of bringing some new methods in using videos in classroom, starting from watching trailers, combining sound with the image and just by listening the sound of a video describing a situation.

## 2 - THE BENEFITS OF TEACHERS USING VIDEOS IN THE CLASSROOM

There are quite a lot of benefits that come from using videos during any classroom and learning session. But is it a good idea to do this, what benefits can you obtain here? With that in mind, here you can find the 6 major benefits that you can acquire via using videos in the classroom.

### a. Students easier accept videos

Videos are maybe the best medium that you can use in order to speak with the new generation. Kids use their best time of the day to watch videos online and they are maybe the best medium that children can use for gaining new knowledge. They also improve communication and entice them to learn new stuff. Children at the same time entertain themselves and gain information, stimulate their friends while providing a new learning experience.

### b. Offer role models

Videos offer a role model for learner output which means that learners can create their own version of the original. The engagement factor is great, on the other hand students have the ability to create their own stories in the classroom.

**c. Videos stimulate activities**

Thanks to videos you can stimulate classroom activities. This will help you operate the need that students have for learning new stuff and it will indeed provide you with an extraordinary importance for the entire learning experience.

**d. Videos submit information**

Everybody knows that videos are always filled with information. Not only that, but they do provide information that are easily consumed, they are fun and distract students from their everyday lectures, introduce them with a new and better experience of learning. That alone helps the learning experience quite a bit.

**e. Engage students in class**

Videos are known to engage learners. If you do want to have an engaging learning experience you do need video and you should consider using it in the classroom as fast as possible. You will be able to see the result immediately after watching it.

**f. Easy to understand**

Research has shown that using videos in classroom makes it a lot easier for students to understand various topics and ideas. It's one of the best learning tools that you can use in your educational career as a teacher.

**Trailers** are perfect for short focused activities. They can be used as a source for a wide range of fluency tasks. Get your students to watch and then say whether or not they'd like to see the move, talk about the relationships between the characters, try to predict the ending and order the scenes. In addition, trailers are great for teaching and reviewing narrative tenses (The main character was walking through the park when…) and relative clauses (I saw a woman who cried after…).

**Listen carefully but don't watch** - Video is a combination of sound and image. Cover the image and play the video. Then have students listen and attempt to guess the genre, the context and what is happening. It's great for teaching vocabulary related to the sound effects, as well as verbs of the senses (I can hear a man snoring) and modal verbs of deduction (It must be in a sea because…). In addition it makes a great lead in to generate interest for a further task. You can also turn off the sound and have students watch – writing the dialogue for the scene.

**Turn your back to the screen** - Have students sit in pairs, one facing the screen, one facing away. The student who can see must describe the video to their partner, who listens and remembers as much as possible. It's a great way to practice the present continuous tense (A man is walking into a shop), plus it creates an information gap for a speaking activity immediately after.

Learning English as a second language in Balkan countries is considered as a very important factor for accomplishing personal and national goals of the people that live in. Regarding its importance the governments inducted English learning in the educational curricula and the student are obliged to learn it from the very beginning of their education, starting from first grade in primary school. The method of using technology in the classroom and facilitating the computer use in second language learning outside the classroom is very effective for nowadays learners. Macedonia is a multicultural country and the people that live inside are keen on learning languages. According to this fact, teachers are only supposed to offer the best conditions for learning and also to try to organize the classes in order to motivate learners to learn the particular language. Keeping in mind the fact that small children are more motivated when they are playing games while learning a language, as well as the fact that English language is a mandatory subject to them starting from the first grade primary school, this method or model of teaching a second language will be more than appropriate and effective for students whose native language is not English. Using videos in the classroom is a very good idea. Not only does this provide a teacher with a wide range of extraordinary benefits but it's a fun experiment for kids as well. I think it's something that every teacher should focus on if he/she wants to deliver the best results.

Moreover, videos can easily show 3D images, animations, and single concepts. They will also participate in experiments that are hard to perform in class or which can carry quite a lot of

danger. On top of that, videos have the ability to bring literature, music, history, art and many other interesting things directly in front of the users. It's fun, easy to do and it does provide you with a very good value.

From our own pedagogical experiences, video/film is a powerful learning tool and we recommend using it often. Visual media can supplement and enrich a piece of text like nothing else. We always respect four rules in our classroom.

- The first rule is that we always watch the video first, because even though sometime the teacher is in a hurry and doesn't have time to watch it, or a colleague recommended that video, it may not be the right video for your class, for your students or that day that's why we always watch any video that we show.
- The second rule is that we never show a video without being sure that the students are responsible for doing something with that video, to let them ask questions and to use it someway so they need to pay attention, there has to be a reason and a purpose of watching that video.
- The third rule is to keep it short, we let them watch clips from the movies that are carefully chosen but not the entire movie;
- The fourth rule is that we never show boring videos because it is the same as when you teach your students when they write they have to hook the audience, the video as well has to hook the audience in some way whatever the grade level it is.

On the other hand, while students are watching film/video, don't ask them to write. This is an age-old classroom practice that is a poor practice in my opinion.

Before you read and after you read, why not show an excerpt from a biography movie of a famous person. And by excerpt or clip, I mean simply a handful of minutes, five to seven will do. That's all you really need and it can have quite an impact on your learners. It can help them visualize people and places better and also set the context—historically, politically, socially, emotionally. I'm not a fan of watching an entire film or documentary. Students can do that on their own at home, especially with the access they have now. The value is in the power of the visuals and audio they just experienced and how that enhances their understanding of what they are about to read or just read. The value is in the discussion and writing that follows.

The best practices to follow when using videos are:

1. **To introduce the Video to Your Students**
   Video might be a great communication tool, but you can't rely on video alone to teach your students. Before you screen your video production introduce the issues surrounding the subject of your video and contextualize the content for your class. By giving this short intro you can ensure your class is prepared for the topic at hand and you can make sure the video content is as accessible as possible for all of your students.

2. **To watch the Video**

   Having introduced the video content and the topic it is addressing to your students you should be able to screen the entire production without interruption. If any student needs to ask a question about the subject matter on screen be sure to stop the video and explain the content thoroughly, but always try to refrain from having too many breaks from the production. Having constant interruptions will break the class's concentration and the engagement with the video content will be lost. A good way to maintain focus from your students is to give them mentally stimulating tasks to carry out during the videos duration. If you can encourage class debate and reflection on the topics expressed in the video you can ensure the class is solidifying the knowledge they have just taken in. many people use TV as just a time-filler, something to switch on simply because they have one or because they can't think of anything else to do.

3. **Reflect and Discuss the Content of the Video**

   Try and plan the screening of your video to allow enough time for a thought provoking discussion after it has finished. If you are screening a video towards the end of the day (a typically difficult time to teach) give your students a short simple task to carry out at home to be returned for the next session to make sure the messages of the video have been understood thoroughly.

## CONCLUSION

21st century is the so called ‘’era of computers”. Everyone today can freely affirm that computers have played a very significant and remarkable role in our lives. They become inevitable and mandatory part of our career, personal life, or better said of our personal development.

One way of simplifying language learning is using technology in second language teaching. The strategies that the teacher might use by using technology in the classroom and outside it are very significant and helpful for successful language learning.

These are just some simple ways that video production and consumption can be included in a language class curriculum. There are an unlimited number of ways that we can use this technology to enhance the learning experience and students take to these tasks so enthusiastically that it sometimes surprises me. Any methodology that creates an atmosphere of enthusiasm for language learning is one that should be explored further and I intend to continue to explore the range of possibilities for using this technology in the language classroom.

If you truly want to obtain a better, more immersive and meaningful learning experience for your students, then you should definitely consider using videos in the classroom. It's very easy to do that and you can rest assured that results will pay off enormously in the long run.

**Bibliography:**


- The Classroom Teacher’s Technology Survival Guide 1st Edition – Doug Johnson, 2012
- Language Learning with Technology: Ideas for integrating technology in the classroom- Graham Stanley, Cambridge University Press, 2013
- Empowering Students with Technology- Allan November, Corwin Press, 2009
- Integrating Technology in Classroom – Boni Hamilton, 2015
- Getting smart: How Digital Learning is Changing the World, Tom Vander Ark

# POLITIKA E ZGJËRIMIT TË BE-SË, SFIDAT E EVROPIANIZIMIT TË R. TË MAQEDONISË (SË VERIUT) PAS MARRËVESHJES TË PRESPËS

**PhD Cand.. Senada Laçka**
**(s.lacka@eust.edu.mk)**
**PhD. Shemsije Demiri**
**(sh.demiri@eust.edu.mk)**
**PhD. Guximtar Rushani**
**(g.rushani@eust.edu.mk)**

**Abstract**

Qëllimi i këtij studimi është trajtimi i procesit të zgjërimit evropian dhe impaktin e tij në Ballkanin Perëndimor, duke ofruar nje prezantim sistematik të literaturës për sa i përket kuadrit konceptual dhe teorik mbi Zgjërimin Evropain dhe Evropianizimin në vendet kandidate si dhe të rasteve studimore nga vendet e Ballkanit Perëndimor.Nga njëra anë, trajtohet debati mbi zgjërimin dhe evropianizimin e vendeve kandidate kurse nga ana tjetër, pasqyron transformimet aktuale që po kalon rajon si rezultat i procesit të integrimit evropian.

Europa nuk ka qenë kurrë më e lirë dhe më e sigurtë se sa që është tani. Luftrat dhe dhuna e shkaktuar në shekullin e XX, Evropës i ka hapur një rrugë drejt paqes, stabilitetit dhe prosperitetit të gjithëmbarshëm. Krijimi i Bashkimit Evropian ka qenë themelor në këtë zhvillim, ai i ka transformuar mardhëniet ndërmjet shteteve dhe jetën e qytetarëve Evropianë.Vendet Evropiane kanë premtuar të përballen paqësisht me veshtirësitë dhe të bashkvëprojnë nepërmjet institucioneve të caktuara. Zgjërimi i suksesshëm i BE-së do ishte një vizion që Kontinenti Evropian të jetë i bashkuar,  paqësor dhe me një zhvillim ma të mire ekonomik.

Para një viti e gjysmë, veçanërisht pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës, takimet e Samitit Evropian në vendin tonë perceptohen si një ngjarje që do të përcaktojë nëse do të jemi apo jo pjesë e BE-së. Samiti i fundit në mes të tetorit 2019 nuk bën përjashtim nga ky rregull. Në ditët e ardhshme, vendet anëtare të BE-së do të ulen përsëri në tryezë për të provuar të arrijnë një konsensus nëse do të mbështesin rekomandimin e Komisionit Evropian që vendi ynë të fillojë negociatat e pranimit.

**Fjalë Kyçe**: *BE, Ballkani Perëndimor, Evropianizim, Zgjërim.*

## 1 - HYRJE

Bashkimi evropian duhej të përballonte valën më të madhe të zgjerimit që nga krijimi I tij ,kur numri I shteteve anëtare pritej të dyfishohej.Dyfishimi I numrit të vendeve anëtare kërkonte një parapërgatitje dhe reforma institucionale që do ti bënin ballë sfidës së zgjerimit,por edhe mirëfunksionimit të BE-së në kushtet e reja.

Në periudhën e gjatë gjysmë shekulli, Bashkimi Evropian ka ushtruar integrimin më të thellë se ndonjëherë më parë, me pranimin e anëtarëve të rinj. Pothuajse tërë kohën, dy proceset u zhvilluan paralelisht. Si rrjedhojë e kësaj, Bashkimi i sotëm Evropian me 28 shtete anëtare dhe popullatë prej rreth 500 milionë njerëz, është më i sigurtë, më i begatë, më i fuqishëm dhe me ndikim më të madh se Bashkësia e hershme Ekonomike Europiane i para 50 viteve, me 6 anëtarë dhe popullatë prej më pak se 200 milionë. Anëtarësimi që shtohet dita ditës, ka qënë pjesë e zhvillimit të integrimit europian, që nga fillimi. Debati mbi zgjerimin është po aq i vjetër sa edhe vet BE-ja. Gjatë çdo pranimi të anëtarëve të rinj, BE-ja ka ndryshuar. Duke menduar se çka do të ndodhë me ne, na detyron të mendojmë se çka jemi tani dhe çka do të mbetemi në të ardhmen. Zgjerimet e vitit 2004 dhe 2007, me vendet nga Evropa Qëndrore, Lindore dhe Mesdheu kanë treguar arritje të madhe të BE-së. Megjithatë, ato janë konsideruar si fajtore për të gjitha problemet e mundshme sociale dhe ekonomike në Evropë. Në të vërtetë, cikli i fundit i zgjerimit ka zhvilluar sferën e paqes, stabilitetit dhe demokracisë në kontinentin tonë, dhe ka përforcuar ekonominë e BE-së me zgjerimin e tregjeve, krijimin e mundësive të reja afariste dhe inkuadrimin e ekonomive të zhvilluara në tregun unik. Tani, BE-ja është zona më e madhe ekonomike në botë. Tregu më i gjerë ndërkombëtar dhe mundësitë e reja ekonomike, kanë forcuar mirëqenien dhe konkurrencën e evropianëve.[1]

Zgjërimi shërben për interesat e Shteteve Anëtare si dhe vendeve aderuese. Ai e bën Evropën më të sigurtë dhe vend më të begatë, sidomos përmes promovimit të demokracisë dhe lirive fundamentale, ushtrimit të ligjit dhe tregut të vetëm. Dobitë nga tregu i vetëm janë mjaft të mëdha: zhvillimi ekonomik sjell si rrjedhojë standardet më të larta të jetës, mallërat më të sigurta të konsumatorëve, çmme më të ulëta dhe zgjedhje më të madhe në sektorët siё janë telekomunikimi, bankat dhe transporti ajror, për të përmendur vetëm disa. Këto dobi janë ndarë

[1] Abaz Lleshi, Gjeopoltika e Ballkanit dhe Perspektivat e sigurisë në rajon, GEER, 2009, fq.113

mes numrit gjithnjë e më të madh të njerëzve me rritjen e BE-së. BE-ja mbi të gjitha është një komunitet vlerash. BE është një familje e vendeve demokratike evropiane e agazhuar për të punuar bashkë për paqe dhe liri, prosperitet dhe drejtësi sociale.

Shtetet anëtare të BE-së kanë diskutuar problematikën e zgjëtimit në përputhje me rregullat e tyre kombëtare. Një pikë kyçe përpara Samitit në Bruksel ishte mbështetja e fortë e dhënë nga Bundestagu gjerman më 26 shtator të viti 2019, për fillimin e negociatave me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në këtë vendim jepet orientim i qeverisë gjermane që të sigurojë një monitorim më të rreptë të negociatave, veçanërisht për sundimin e ligjit. Vendimi i Bundestag-ut që detyron qeverinë gjermane të ndjekë këto udhëzime shihet si dritë në qëllimin e faktorëve në Gjermani për të inkurajuar shtetet e tjera anëtare të marrin një vendim pozitiv, duke mbajtur në mend skepticizmin ende të pranishëm në disa prej tyre[2].

Megjithëse qëndrimet e të gjitha vendeve nuk janë përcaktuar plotësisht, dihet që ka paqartësi në lidhje me pozicionin e presidentit Makron, por ka edhe raste të tilla si Hollanda ku ka mbështetje vetëm për vendin tonë, por jo edhe për Shqipërinë. Nga ana tjetër, ka vende anëtare të BE-së, pozicioni i të cilave përcaktohet kryesisht nga nevoja për të siguruar stabilitetin rajonal duke mbështetur përparimin e të dy vendeve kandidate. Këto ndryshime do të zgjidhen në minutën e fundit gjatë mbledhjes së ardhshme të Këshillit të Ministrave dhe ndoshta edhe të Këshillit Evropian.

## 2 - SI FUNKSIONON PROCESI I ZGJERIMIT-DOBITË DHE SFIDAT

Përveç prosperitetit të shtuar, procesi i zgjerimit gjithashtu promovoi stabilitet, siguri dhe ushtrim të ligjit për vendet që u anëtarësuan në BE Politika e zgjerimit luante një rol shumë të rëndësishëm në transformimin e vendeve të mëparshme komuniste që janë anëtarësuar në BE që në vitin 2004, në shtete me ekonomi funksionale të tregut dhe institucione demokratike politike. Ky proces ishte plotësimi i premtimit të dhënë nga BE-ja në fund të luftës së ftohtë, për vendet e mëparshme komuniste të Evropës qendrore dhe lindore. Udhëzimi i ofruar nga Komisioni Evropian dhe institucionet e tjera, si dhe njohuritë institucionale dhe ligjore të ofruara nga Shtetet

[2] **kfgo.com**

ekzistuese Anëtare, u ndihmuan këtyre vendeve të kalojnë një ndër proceset më të shpejta të modernizimit në histori. Lëvizja e lire e mallërave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve është parimi themelor i BE-së. Kjo nënkupton se të gjithë qytetarët e BE-së kanë të drejtë të punojnë në vende të tjera të BE-së. Ata mund të jetojnë në vende të tjera të BE-së nëse kanë punë ose shumë të mjaftueshme të parave për t'u kujdesur për vetveten.[3]

Ndihma financiare e BE-së ndihmon vendet e rajonit të ndërtojnë kapacitetin e tyre për të miratuar dhe implementuar standardet evropiane. Duke filluar nga viti 1991 deri në vitin 2011, BE-ja ofroi më se 16 miliardë euro ndihma për Ballkanin Perëndimor, disa nga ndihmat më të larta botërore për frymë njeriu. Nga viti 2007, vendet kandidate dhe potenciale kandidate kanë pranuar fonde dhe mbështetje të BE-së, përmes Instrumentit për Ndihmë Para-anëtarësuese, ose IPA. BE-ja dhe autoritetet nacionale të vendeve përkatëse vendosin se cilat do të jenë fushat ku do të investohen këto fonde. Projektet e përkrahura nga IPA kanë për qëllim të forcojnë institucionet demokratike dhe ushtrimin e ligjit, të reformojnë administratën publike, të mbështesin reformat ekonomike, të promovojnë respektimin e të drejtave të njeriut si dhe të drejtat e pakicave dhe barazinë gjinore, të përkrahin zhvillimin e shoqërisë civile dhe të avancojnë bashkëpunimin rajonal, dhe të kontribuojnë në zhvillimin e vazhdueshëm dhe zvogëlimin e varfërisë. Pra, fondet IPA mbështesin miratimin dhe implementimin e kërkesave për anëtarësim. Fondet e përgjithshme para-anëtarësuese për periudhën 2014–20 pritet që të jenë rreth 11.7 miliardë, me shpërndarje precize që do të vendoset vit pas viti.

### *2.1 Kush mund të anëtarësohet?*

Kërkesat e anëtarësimit në BE janë përcaktuar me përpikëri të theksuar gjatë tërë evolucionit të BE-së, në mënyrë që të ofrojnë qartësi për qytetarët e vet dhe drejtime për vendet që duan të anëtarësohen. Neni 49 i Traktatit mbi Bashkimin Europian thekson se të gjitha vendet e Europës mund të bëjnë kërkesë për anëtarësim, nëse i respektojnë parimet e lirisë, demokracisë, të drejtat e njeriut, liritë fundamentale dhe sundimin e ligjit. Një vend mund të anëtarësohet vetëm nëse plotëson kriteret e anëtarësimit, të definuara nga Këshilli Europian në Kopenhagë në vitin 1993, dhe të zbatuara në vitin 1995. Këto kritere janë:

[3] Blerim Reka, Otmar Holl, Ylber Sela, Institucionet dhe Politikat e Unionit Evropian, 2010, fq 183

- Kriteri politik: institucione stabile që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave.
- Kriteri ekonomik: ekonomi funksionale e tregut dhe kapaciteti për të përballuar konkurrencën dhe fuqitë e tregut në UE.
- Kapaciteti i pranimit të obligimeve të anëtarësimit, përfshirë këtu edhe mbështetjen e synimeve të unionit politik, ekonomik dhe monetar.
- Miratimi i një organizmi të tërë legjislativ europian dhe implementimi i efektshëm i këtij legjislacioni me anë të strukturave të duhura administrative dhe juridike.[4]

Veç kësaj, BE-ja duhet të jetë kompetente të integrojë anëtarë të rinj, prandaj mban të drejtën e vendosjes së periudhës së pranimit të tyre. Për Ballkanin Perëndimor vlejnë kushte shtesë, kandidatet pë anëtarësim duhet të angazhohen për bashkëpunim rajonal dhe marrëdhënie të mira me shtetet fqinje (i ashtuquajturi ‘Kushtëzimi i procesit të stabilizimit dhe asocimit’). Për të ndihmuar vendet që përgatiten për anëtarësim në të ardhmen, është hartuar një strategji para-anë-tarësuese. Elementet kyç të kësaj strategjie përfshijnë marrëveshjet që përcaktojnë të drejtat dhe obligimet (siç janë Marrëveshjet e Stabilizimit dhe Asocimit në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor), si dhe mekanizmat e veçantë të bashkëpunimit si Partneritetet Anëtarësuese ose Europiane, të cilat përcaktojnë objektiva konkrete për reformat që duhet të realizohen nga vendet kandidate dhe nga kandidatet potenciale. Ndihma financiare e UE-së është edhe një aspekt tjetër i rëndësishëm i strategjive para-anëtarësuese.

### *2.2 Kush vendos?*

Anëtarët e rinjë pranohen me pëlqimin unanim të Shteteve Anëtare të BE-së. Kur një vend aplikon për anëtarësim në BE, qeveritë e Shteteve Anëtare, të përfaqësuara në Këshill, së pari vendosin nëse do të pranojnë apo jo aplikimin. Shtetet Anëtare pastaj vendosin, në bazë të opinionit nga Komisioni Evropian, nëse shtetit që aplikon do t’i japin apo jo statusin e kandidatit si dhe vendosin për t’i filluar bisedimet e anëtarësimit. Ngjashëm, Shtetet Anëtare vendosin kur dhe me çfarë kushtesh të hapin dhe të mbyllin negoicatat me kandidatin, në të gjitha fushat e politikës, duke marrë parasysh rekomandimet e Komisionit. Pas përfundimit të kënaqshëm të negociatave të anëtarësimit, hartohet traktati i anëtarësimit dhe nënshkruhet nga Shtetet Anëtare dhe nga vendi

[4] Dorian Jano, Politika e zgjërimit dhe ndikimi i saj në Ballkanin Perëndimor, 2017, fq.25

përkatës kandidat. Parlamenti Evropian, deputetët e të cilit zgjidhen drejtpërdrejtë nga qytetarët e BE-së, gjithashtu duhet të japë pëlqimin e vet. Pastaj, traktati duhet të ratifikohet nga të gjitha Shtetet Anëtare dhe vendi aderues, në pajtim me procedurat e tyre të themeluara kushtetuese.

### *2.3 Negociatat e anëtarësimit*

Negociatat e anëtarësimit kanë të bëjnë me aftësinë e vendit kandidat për t'i marrë përsipër obligimet e anëtarësimit. Ato përqëndrohen në kushtet dhe kohën kur kandidati miraton, implementon dhe zbaton ligjet dhe rregullat ekzistuese të BE-së — rreth 100 000 faqe. Rregullat si të tilla (gjithashtu të njohura edhe si acquis, nga gjuha franceze 'ajo që është miratuar') nuk janë të negociueshme. Negociatat janë para së gjithash çështje e pajtimit për atë se si dhe kur kandidati do të miratojë dhe implementojë rregullat dhe procedurat e BE-së në mënyrë efektive. Negociatat zhvillohen mes Shteteve Anëtare të BE-së dhe vendit kandidat; ritmi i tyre kryesisht varet nga progresi i kandidatit në plotësimin e kërkesave. Rjedhimisht, kandidatet motivohen të implementojnë reformat e nevojshme në mënyrë të shpejtë dhe efektive. Disa nga këto reforma kanë nevojë për transformime të dukshme dhe ndonjëherë të vështira të strukturave politike dhe ekonomike të vendit. Prandaj, është me rëndësi që qeveritë t'ua komunikojnë qytetarëve arsyet e këtyre reformave në mënyrë të qartë dhe të bindshme. Në këtë proces është me rëndësi thelbësore mbështetja e shoqërisë civile. Hapja e negociatave të anëtarësimit vendoset nga Këshilli Evropian, në bazë të një rekomandimi të Komisionit, pasi që vendi kandidat të ketë plotësuar në mënyrë të kënaqshme kriteret politike të Kopenhagës dhe kushte të tjera të mundshme. Negociatat e anëtarësimit përqëndrohen në kushtet dhe fazën e miratimit, implementimit dhe zbatimit të rregullave të UE-së nga vendet kandidate. Dhe këto rregulla nuk janë të negociueshme. Për kandidatët është çështje e dakordimit të mënyrës dhe kohës së miratimit dhe implementimit të rregullave dhe procedurave të UE-së. Për Unionin, është me rëndësi të marrë premtimin lidhur me datën dhe efektshmërinë e implementimit të rregullave nga çdo vend kandidat në veçanti. Negociatat administrohen individualisht me shtetet kandidate, kurse ritmi i bisedimeve varet nga progresi i vendeve në plotësimin e kërkesave. Në këtë mënyrë, vendet kandidate janë të stimuluara të implementojnë reformat e domosdoshme me shpejtësi dhe në mënyrë të efektshme. Disa nga këto reforma kërkojnë transformime mjaft të mëdha e nganjëherë edhe të vështira të strukturave politike dhe ekonomike të vendit. Prandaj, është me rëndësi që qeveritë të kumtojnë arsyet e këtyre reformave, në mënyrë të shkoqur dhe bindëse për qytetarët e vendit të tyre. Negociatat e

anëtarësimit realizohen mes Shteteve Anëtare dhe vendeve kandidate. Seancat negociuese mbahen në nivel të ministrave dhe zëvendësve, d.m.th. Përfaqësuesit Permanentë të Shteteve Anëtare dhe Ambasadorët ose Negociatorët Prijës të vendeve kandidate.[5]

### *2.4 Ekzaminimi*

Për të lehtësuar negociatat, organi i ligjit të BE-së ndahet në kapituj, ku secili prej tyre korrespondon me një fushë të politikës. Hapi i parë i negociatave quhet screening (ekzaminim); qëllimi i tij është t'ia sqarojë acquis-në kandidatit dhe të identifikojë fushat që kanë nevojë për harmonizim të legjislativës, institucioneve ose praktikës së tyre. Si bazë për të filluar procesin e negociatave, Komisioni përpilon një raport ekzaminimi për çdo kapitull. Këto raporte i dorëzohen Këshillit. Komisioni jep rekomandim nëse duhet të hapen negociatat për një kapitull, ose të kërkojë së pari plotësimin e kushteve (ose etapave) të caktuara.

### *2.5 Raportimi dhe mbikqyrja*

Komisioni informon Parlamentin Evropian dhe Këshillin lidhur me progresin e vendeve aspiruese, përmes dokumenteve të strategjisë vjetore dhe raporteve mbi progresin individual të vendeve. Ai gjithashtu mbikqyr se sa i respekton vendi kandidat angazhimet që i ka marrë përsipër gjatë negociatave. Mbikqyrja vazhdon deri në anëtarësim. Kjo bën të mundur dhënien e udhëzimeve shtesë gjatë periudhës kur vendet marrin përgjegjësitë e anëtarësimit, dhe gjithashtu u garanton Shteteve Anëtare se anëtarët e rinj i plotësojnë kushtet e anëtarësimit. Pasi Shtetet Anëtare të vendosin, në bazë të vlerësimit të Komisionit, se janë plotësuar etapat e hapjes, vendi kandidat dorëzon qëndrimin negociues. Atëherë, Këshilli miraton një qëndrim të përbashkët të BE-së, përsëri të bazuar në propozimin e Komisionit, i cili lejon hapjen e negociatave për atë kapitull. Qëndrimi i përbashkët i BE-së gjithashtu përfshin kushtet (etapat) për mbylljen e kapitullit. Pasi të plotësohen kushtet e mbylljes, Shtetet Anëtare miratojnë një qëndrim të ri të përbashkët (gjithnjë në bazë të propozimeve të Komisionit) i cili konkludon se kapitulli mund të mbyllet — por vetëm përkohësisht. Negociatat e anëtarësimit në BE operojnë në parimin se 'asgjë nuk është dakorduar derisa të pajtohemi për gjithçka, kështu që përmbyllja definitive e kapitujve ndodh vetëm në fund të gjithë procesit negociues.

[5] http://www.europa.eu//delegations/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/documents/sq.pdf

## 3 - VAZHDIMI I RRRUGËTIMIT DREJT EVROPËS PËR MAQEDONINË (E VERIUT) PAS MARRËVESHJES SË PRESPËS

**Në Bruksel, në 17 Tetor të vitit 2019 u mbajt Samiti i liderëve të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (BE), ku duhet të vendoset se, nëse Republika e Maqedonisë së Veriut (RMV) dhe Shqipëria do t'i fillojnë negocitatat anëtarësuese, apo ajo mbetet, për gjysmën e parë të vitit 2020.**

Samiti dyditor, vjen pas Mbledhjes ministrore që u mbajt në Luksemburg, ku nuk u arrit kompromis se, a duhet a po jo t'i fillojnë negociatat RMV-ja dhe Shqipërinë, për çfarë, vendimin ia kaluan liderëve. Epilogun e mbledhjes ministrore, jo në favor të të dy shteteve pretendente dhe për politikën e BE-së, e kanë ndikuar:

- ***Franca*** *– e cila ka qenë kundër dhënies së datës për të dy shtetet, për shkak të mospërmbushjes së reformave,*
- ***Holanda*** *– e cila ka kërkuar që të dy shtetet të trajtohen ndarazi, e jo si pako, për shkak, se ajo është e bindur për RMV-në, e kurse jo për Shqipërinë, dhe në fund*
- ***Finlanda*** *– e cila si kryesuese me BE-në, ka kërkuar që paralelisht me procesin e dhënies së datës, të zhvillohen reforma në BE – futja e metodologjisë së re të procesit të zgjerimit, ndërkohë që mbledhja ndërqeveritare të mbahet në gjysmën e parë të vitit 2020-s.*

Paraprakisht, hapjen e negociatave e ka rekomanduar ***Komisioni Evropian.***

RMV-ja ka "lobuar deri në minutat e fundit", për marrjen e një vendimi pozitiv nga Samiti i BE-së. Kryeministri **Zoran Zaev**, i shoqëruar nga zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane, **Bujar Osmani** dhe ministri i Punëve të Jashtme, **Nikolla Dimitrov,** kanë realizuar një sërë takimesh, nga ku kanë marrë premtimin se," *thuajse ka konsesus për marrjen e datës".*

Në takimin me **Donald Tusk**, njëzëri është përfunduar se, RMV-ja i ka përmbushur të gjitha kushtet për nisjen e negociatave me BE-në.

Që të tre pjesëtarët e Qeverisë së RMV-së, takim kanë realizuar edhe me presidentin e Parlamentit Evropian, David Maria Sasoli**,** nga i cili kanë marrë premtimin, se nesër në Samitin e BE-së do të kërkojë nisjen e negociatave për RMV-në.

Nga ana tjetër, kancelarja gjermane, **Angela Merkel nuk ka arritur ta bindë** presidentin e Francës, **Emanuel Macron** për datën e nisjes së negociatave të BE-së me RMV-në dhe

Shqipërinë, takim ky që u realizua pasi në Mbledhjen ministrore të BE-së, ishte Franca që i dha veto marrjes së datës së të dyja shteteve.

Pasiguria deri më 17 tetor ka ekzistuar për shkak të disa faktorëve që shpesh trajtohen bashkarisht, por që në një masë të madhe ndikojnë në qëndrimin e shteteve anëtare për fillimin e negociatave. Skepticizmi i shteteve anëtare për zgjerimin është për shkak të një numri faktorësh, disa prej të cilëve janë thelbësorë.

**Së pari,** pikëpamjet e integruara të BE-së mbi përvojën e zgjerimit të mëparshëm. Megjithëse përvojat e vendeve pranuese janë larg nga përvojat uniforme, në BE, dhe në veçanti në disa nga vendet më të vjetra dhe më të mëdha anëtare, ka pakënaqësi lidhur me sundimin e ligjit në disa nga vendet e pranuara gjatë zgjerimit të fundit të Unionit, ndërmjet 2004 dhe 2013. Këto diskutime janë të lidhura ngushtë me faktin se BE-ja nuk ka të krijuar një mekanizëm të qartë për identifikimin dhe sanksionimin e mospërputhjeve të tilla në sundimin e së drejtës. Në disa prej viteve të fundit gradualisht hapet debati për krijimin e një instrumenti potencial për këtë qëllim, por duke pasur prasysh procesin e harmonizimit midis 28 vendeve anëtare, kjo padyshim shkon ngadalë.

**Arsyeja e dytë** që lidhet ngushtë me këtë diskutim është pakënaqësia me rezultatin e negociatave deri më tani me vendet që negociojnë aktualisht. Mali i Zi dhe Serbia kanë negociuar për 7 ose 5 vjet nën metodologjinë e re të BE-së, nga e cila pritej të sigurohej një mbikëqyrje e shtuar dhe kontroll mbi pikërisht çështjet e sundimit të ligjit. Kjo lloj ngecje, padyshim ka shtyrë që vendet anëtare të mendojnë se si të përmirësojnë metodologjinë e zgjerimit për të siguruar një përparim të qartë.

**Së treti**, procesi i zgjërimit të BE-së ka qenë gjithmonë i ngarkuar me debatin e zgjerimit dhe thellimit që po aktualizohet edhe në fillimin e një cikli të ri institucional në BE që nuk ka ardhur ende. Deri në fund të muajti duhet të ndodhë votimi për përbërjen e Komsionit Evropian për periudhën e ardshme shtatëvjeçare. Ai përballet me shumë sfida, përfshirë trajtimin e daljes nga Mbretëria e Bashkuar, që përkundër trazirave institucionale rezulton edhe me një *hendek në buxhetin aktual të BE-së prej mesatarisht 12 për qind* . Për më tepër, institucionet e reja do të duhet

të merren me një mori sfidash me të cilat përballet Unioni, të cilat do të përcaktojnë trajektoren afatgjatë që duhet të ndjekë.

**Argumentet e R. Maqedonisë së Veriut** kësaj rradhe, edhe përkundër situatës komplekse, janë me të vërtetë të fuqishme dhe janë paraqitur vazhdimisht para anëtareve të BE-së. Ato përfshijnë :

1.Marrëveshja e Prespës,

2.Marrëveshjen e Fqinjësisë së Mirë me Bullgarinë,

3. Vlerësimi i Komisionit Evropian nga raporti i majit të vitit 2019,

Sidoqoftë, përveç anës sonë të tregimit, faktorët e mësipërm krijojnë situatën në të cilën ne presim vendimin për të mbështetur negociatat, por edhe situatën e përgjithshme politike në të cilën do të zhvillohen negociatat. Nga të tre faktorët, ka mësime kryesore për tu mësuar dhe zbatuar.

Në lidhje me pikën e parë, është e nevojshme të ndërtohet një imazh i një vendi ku sundon ligji dhe ku nuk ka të ngjarë të përsëristen sjelljet e disa prej vendeve anëtare që aktualisht po diskutojnë ngritjen e një mekanizmi të shkeljes së sundimit të ligjit. Kjo nuk do të jetë e lehtë duke marrë parasysh dosien tonë, por është thelbësore të ndërtojmë një imazh të vetvetes si një shoqëri që rritet dhe mëson nga gabimet e së kaluarës.

Së dyti, procesi ynë negociues ka shumë të ngjarë t'i nënshtrohet kritereve edhe më të rrepta dhe monitorimit duke pasur parasysh përvojat e vendeve që negociojnë aktualisht. Këto mekanizma përshkruhen në vendimin e sipërpërmendur të Bundestag-ut dhe me siguri do t'i shohim ato në kornizën tonë të negociatave e cila do të përcaktojë kushtet në të cilat do të zhvillojmë negociatat tona. Ne duhet të jemi të gatshëm për këto mekanizma të rinj, por në të njëjtën kohë edhe racionalë, në mënyrë që të përdorim burimet e kufizuara në dispozicionin tonë. Këtu, para së gjithash, nevojiten burimet njerëzore dhe duhet të identifikohen qartë përparësitë kombëtare të zhvillimit në të gjitha fushat në përputhje me parimet kryesore dhe ligjet e BE-së.

Së treti, në lidhje me të ardhmen e BE-së dhe reformat e saj të brendshme, është e nevojshme që në planin afatgjatë ta shohim dhe pozicionojmë veten si një shtet anëtar i ulur në

tryezën e vendimmarrjes sesa vetëm marrës i atyre vendimeve. Kjo nënkupton që përveç qëllimit tonë kryesor të anëtarësimit, duhet të mendojmë gjithashtu se si do të kontribuojmë në ndërtimin e një shtëpie të përbashkët në BE. Kjo ne na duket e largët, por si një shtet anëtar do të duhet të kujdesemi dhe të kontribuojmë në ndërtimin e një vizioni të përbashkët për Bashkimin Evropian që shpesh ka qenë subjekt i polemikave dhe konflikteve sidomos në të kaluarën.

## *4* - PRO DHE KUNDËR BALLKANIT-QËNDRIMET E SHTETEVE ANËTARE TË BE-së NË RAPORT ME ZGJËRIMIN

Përballë një mozaiku fetar, gjuhësor, kombëtar, është e vështirë të afirmosh një identitet evropian dhe të supozosh që ai ekziston. Vendet e Evropës Perëndimore mund ti japin përshtypjen e një homogjeniteti, por ky I fundit është më pak I lidhur me rrënjët historike sesa me aftësitë e tyre për të krijuar një shoqëri demokratike dhe për të vendosur nëpërmjet një sistemi shumë të zhvilluar të mbrojtjes sociale dhe shërbimeve të interest të përgjithshëm, një nivel më të lartë se kudo të barazisë dhe drejtësisë sociale. Është ky model I shoqërisë që Bashkimi Evropian ka për mission të ruajë dhe përmirësojë nëpërmjet politikave të ndryshme[6].

Presidenti Francez Macron mbajti një qendrim edhe më të ashpër gjatë Samitit të Ballkanit Perëndimor, duke zbuluar edhe përplasjet e brendshme mes tij dhe Kancelares Merkel.

*"Ajo që kemi parë gjatë 15 viteve të fundit është një rrugë që ka dobësuar Europën sa herë që kemi menduar ta zgjerojmë. Unë nuk mendoj se u bëjme nder vendeve kandidate apo unionit, duke pasur një mekanizëm që në njëfarë mënyre nuk ka më rregulla dhe vazhdon të lëvizë papushim drejt zgjerimit më të madh. Unë jam në favor të ankorimit të Ballkanit në Evropë dhe të ecjes drejt Evropës. Por mendoj se ne duhet të shohim çdo zgjerim të ri me shumë kujdes dhe ashpërsi. Duhet të kemi një dialog të përforcuar dhe strategjik me vendet e Ballkanit, të ndjekim reformat që janë ndërmarrë dhe t'i inkurajojmë pa u treguar hipokrit."*-**Emmanuel Macron**

Vendet e para që do të mund të anëtarësohen sipas vlerësimit të komisionit janë Serbia dhe Mali i Zi, ndërsa Shqipëria, Bosnja, Kosova dhe Maqedonia mund të bashkohen më vonë.

[6] Francois dArcy, Politikat e Bashkimit Evropian, 2003, fq.27

Megjithatë, ministri i jashtëm i Hungarisë, Peter Szijarto, tha se ishte “shumë i zhgënjyer” nga objektivi i vitit 2025, të cilin e quajti “shumë të largët”, duke argumentuar se Serbia dhe Mali i Zi duhet të pranohen deri në vitin 2022.

“Është e qartë se SHBA, Rusia dhe Turqia kanë një strategji për Ballkanin Perëndimor, vetëm Bashkimi Evropian është jashtëzakonisht i ngadalshëm”, tha Szijjarto.Sipas tij, nëse BE dëshiron të jetë një fitimtar në Ballkanin Perëndimor, do të duhet të jetë “shumë më e shpejtë”.

Polonia, Italia dhe Austria janë midis vendeve të tjera të BE-së në favor të rritjes së përpjekjeve për të anëtarësuar Ballkanin në Bashkimin Evropian. Por Gjermania dhe Franca, dy peshoret më të rënda në BE, duket se janë në një diskurss përplasjeje më njëra-tjetrën.

Ndryshe nga Macron, Presidenti i Komisionit Europian Jean-Claude Juncker insiston se dera e Evropës duhet të mbetet e hapur për rajonin e Ballkanit. Kur u vendos në krye të Komisionit Evropian katër vjet më parë, Juncker u zotua se gjatë mandatit të tij nuk do të ketë zgjerim të BE-së, por duket se rrjedha e ngjarjeve brenda dhe jashtë bllokut evropian e ka bërë të ndryshojë mendim. Duke njoftuar propozimin e Komisionit Europian për Shqipërinë dhe Maqedoninë për të filluar bisedimet e anëtarësimit, shefja e politikës së jashtme të BE-së, Federica Mogherini tha se ky vendim është një nxitje që këto vende që të vazhdojnë rrugën e reformave.

Edhe pse është shprehur skeptik ndaj partneritetit franko-gjerman, Juncker nuk ka nguruar të vlerësojë përkushtimin e presidentit francez në BE.“*Unë dua të shpreh emocionin, kur dëgjoj presidentin francez që shpreh vizionin e tij e Bashkimin Evropian. Franca e vërtetë është kthyer”,* u shpreh ai në një fjalim në Parlamentit Evropian.

Franca i jep kohë Komisionit Europian deri në maj të vitit të ardhshëm për të propozuar ndryshimet e nevojshme dhe njëkohësisht Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë që të plotësojnë kushtëzimin për të marrê dritën jeshile.

Në bllokadën e vendimit për nisjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë nuk duhet parë as sentimente antishqiptare e as nuk duhet kërkuar arsye objektive. Franca dhe Holanda ka shumë vjet që janë bërë kundërshtare të ashpra të procesit të zgjerimit. Holanda e bën këtë në mënyrë më profesionale, ndërsa Franca as që e di se çfarë kërkon.

Presidenti i Komisionit Evropian, Jean Claude Juncker, pa dyshim një prej politikanëve më me përvojë që ka Evropa, i cili e di shumë mirë se procesi i zgjerimit të BE-së ka qenë një projekt paqeje e jo vetëm një proces ekonomik dhe teknik, e quajti këtë si një "*gabim të rëndë historik"*. Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, shkoi edhe më larg duke thënë se *"Shqipëria dhe Maqedonia e kaluan testin - vendet anëtare të BE-së për fat të keq jo*". Që të dyja thanë se BE-ja nuk e mbajti fjalën, e nëse do të merret seriozisht në botë duhet ta mbajë fjalën e dhënë. Por atyre që kundërshtuan këtë vendim nuk u intereson shumë mbajtja e fjalës, apo ndjenja për paqen dhe stabilitetin jashtë BE-së. Për ta, BE-ja edhe sot është tepër e madhe. Po të mund ta zvogëlonin, do ta bënin këtë, por jo duke larguar vendet e pasura si Britania e Madhe, që janë neto kontribuese në buxhetin e BE-së.

Sado e rëndë dhe frustruese që ishte për Shqipërinë dhe Maqedoninë mungesa e vendimit nga ky samit, duhet kujtuar se nuk është hera e parë që BE-ja nuk e mban fjalën e vet. Të mos harrojmë se për Maqedoninë deri tash më shumë se dhjetë herë Komisioni Evropian kishte konfirmuar se i ka përmbushur kriteret dhe kishte rekomanduar hapjen e negociatave. Jo vetëm se nuk kishte ndodhur vendimi, por, për shkak të bllokadës nga Greqia, as që ishte vënë në rendë dite. Dhe sapo ajo u mor vesh me Greqinë, ndërroi emrin, dhe Athina hoqi dorë nga vetoja, doli Franca të jetë kundër, pa përmendur ndonjë arsye që lidhet me kushtet që duhet përmbushur vendi kandidat. Duket sikur për dhjetë vjet Franca dhe Holanda në rastin e Maqedoninë ishin fshehur prapa Greqisë. Sikur ishin fshehur prapa Sllovenisë, kur ajo e bllokonte përparimin e Kroacisë në procesin negociator.

Për holandezët, gjithçka është rreth parave. Sa do të kushtojë zgjerimi i BE-së, kush do të paguajë për vendet e pazhvilluara që mund të hyjnë. Dhe këtu ata i kanë llogaritë e tyre, sepse për kokë banori holandezët janë ata që paguajnë më së shumti në buxhetin e Bashkimit Evropian.

Holanda ka qenë vendi që më së shumti i ka bërë pengesa Kroacisë,nëse nuk llogaritet bllokada sllovene. Në secilin rast kur flitet për zgjerimin, Holanda në parim është kundër. Por është pak më korrekte sesa Franca, sepse ajo së paku zhvillon debat në Parlament, përmend arsyet e veta, ndërsa Franca mjaftohet me deklaratat politike se "së pari duhet reformuar BE-në e pastaj!". Edhe pse BE-ja reformohet qëkur është krijuar dhe kjo asnjëherë nuk e ka penguar atë të zgjerohet.

ISSN 1857-7482, Nr. 22, 2019 www.eust.edu.mk/Heritage/

Franca tash, sidomos tash kur Britania e Madhe del nga BE-ja, dëshiron ta rrisë ndikimin e vet. Do të jetë e vetmja fuqi bërthamore në BE. E vetmja anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit. Dhe do që ajo të vendosë për BE-në, ndërsa të tjerët ta ndjekin. Këtë duket se e ka në kokë edhe presidenti Emanuel Macron, i cili, duke pasur parasysh madhësinë e Francës, vështirë që ndihet në siklet pse të tjerët mendojnë se ka gabuar duke bllokuar Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Edhe kryeministri i Holandës, Mark Rutte, vështirë se ndien nevojë t'i arsyetohet dikujt. Ai e ka përfillur qëndrimin e Parlamentit të tij, i cili nuk do që Shqipëria të hapë negociatat, ndërsa për Maqedoninë ishte i gatshëm të pranojë.

Atë që kërkon presidenti Macron tashmë ekziston. Zgjerimi nuk është proces i lehtë, por shumë i vështirë dhe i gjatë. Siç ua sqaroj kryeministri kroat, Andrej Plenkoviq, vetë i përfshirë në procesin negociator të vendit të tij, ky proces Kroacisë i ka zgjatur më shumë se vendeve të tjera që hynë para saj. Por, Kroacia kishte përmbyllur tërë procesin, nga nisja deri te mbyllja e negociatave, për 2096 ditë. Po aq ditë janë bërë qëkur negociatat i ka nisur Serbia dhe ajo ka hapur vetëm 17 e ka mbyllur vetëm 2 apo 3 kapituj. Pra, për kohën sa iu desh Kroacisë të përmbyllë procesin, Serbia nuk ka arritur as në gjysmën e rrugës. E ata që do të vijnë pas Serbisë do ta kenë edhe më të vështirë, ndërsa Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova që do të vijnë pas Shqipërisë dhe Maqedonisë - shumë, shumë më të vështirë. Pra, nuk ka nevojë për ndonjë metodologji të re për të pritur vendimin për nisjen e negociatave.

Mbështetësit më të mëdhenj të Shqipërisë ishin pikërisht partitë e qendrës së djathtë, ato të grupit EPP, ku është edhe PD-ja e Lulzim Bashës. Në favor ishin kancelarja Merkel, kryeministrat e Kroacisë, Bullgarisë, Letonisë, Austrisë, Irlandës, Greqisë, Hungarisë dhe të tjerat që janë nga ky grupim. Kundër ishin dy shtete ku në pushtet janë partitë liberale (Franca dhe Holanda), ndërsa në rastin e Shqipërisë kundër ishte edhe Danimarka, ku në pushtet janë socialistët.

Është e qartë se kundër zgjerimit nuk janë partitë populiste, por më shumë ato të majta dhe liberale. Populizmin dhe ekstremizmin vetëm po e marrin si justifikim. Gjithsesi ajo që ndodhi apo nuk ndodhi në Samitin e BE-së është edhe një mësim se integrimi në BE për vendet e Ballkanit duhet të mbetet synim, por nuk bën të jetë opsesion. Sepse nuk dihet se kur do të ndodhë dhe nuk mund të ketë garanci se do të ndodhë ndonjë ditë fare. Dhe nuk do të jetë fundi i botës as për BE-

në e as për vendet që synojnë të bëhen anëtare. Ato duhet të shohin interesin e vet, ndërsa BE-ja të përballet edhe me realitetin se si e tillë as që mund të jetë ndonjë faktor i rëndësishëm më në rajon. Dhe ishte i rëndësishëm pikërisht për shkak se e mbante gjallë shpresën tek vendet e rajonit se mund të ecin drejt integrimit. Tash BE-ja duhet të përballet edhe vetë me pasojat e mosveprimit të saj.

## KONKLUZION

Natyrisht, anëtarësimi në BE nuk është proces automatik: procesi është i bazuar në kushtëzim të rreptë, dhe çdo hap përpara është bazuar në progresin real të arritur në terren dhe të miratuar nga të gjithë aktorët. Kjo bëhet për të siguruar se një vend kandidat është plotësht i gatshëm për anëtarësim para se të mund të bashkohetReformat që kanë të bëjnë me BE-në janë të kufizuara në harmonizimin e ligjeve nacionale me standardet e BE-së. Respektimi i ushtrimit të ligjit, parimeve demokratike dhe të drejtave të njeriut, mbeten pika qëndrore e procesit të zgjerimit.

Zgjerimi i Bashkimit Evropian është parë gjithnjë nga perspektiva institucionale, pa u kushtuar vëmendje rolit dhe mendimit të shteteve anëtare, duke i bërë disa vende si Franca dhe Holanda gjithnjë e më shumë skeptike ndaj mirëseardhjes së kombeve të tjera.

Për t'i dhënë fund këtij diskursi, Presidenti francez, Emmanuel Macron, ka përjashtuar në mënyrë kategorike çdo zgjerim të Bashkimit Europian derisa blloku të reformohet, duke u prerë hovin shteteve ballkanike që presin prej kohësh prapa derës së unionin evropian. Edhe pse një sërë zyrtarësh europianë kanë paralajmëruar se BE-ja mund të përballet me kthimin e luftës dhe konflikteve nëse vendeve të rajonit u hiqet shpresa e anëtarësimit, qeveria franceze duket e vendosur për të kundërshtuar zgjerimin e unionit.

Qëndrimi hezitues i Francës për zgjerimin e BE-së drejt Ballkanit është ilustrim i kontrastit mes elitave franceze dhe qytetarëve ndaj projektit europian. Pavarësisht nga mbështetja parësore për anëtarësimin e Ballkanit në BE, arritja e këtij hapi nuk është një përparësi strategjike për Francën. Macron thekson kushtet e rrepta dhe një monitorim rigoroz të progresit të reformave në vendet aspirante. Fakti që opinioni publik është armiqësor ndaj Ballkanit forcon edhe më tej hezitimin e Francës për të mos pranuar kandidatë të rinj, pothuajse të papërgatitur në Bashkim Evropian. Duke analizuar evolucionin historik të qëndrimit francez mbi zgjerimin e BE-së, si dhe

shprehjet e tanishme politike, institucionale dhe shoqërore, qendrimi i Francës ndaj anëtarësimit të Ballkanit duket se është më kritik se kurrë.

Njëzetë e tetë vendet anëtare të BE-së duhet të bien dakord unanimisht për çdo vend që aplikon të bëhet anëtar i unionit evropian. Pranimi në BE ka qenë një nxitës i fuqishëm për realizimin e reformave politike dhe demokratike në vende si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi, e cila u anëtarësua së fundmi në NATO.

Macron kundërshtoi fillimisht për zgjërimin e unionit pasi Komisioni Evropian, rekomandoi që blloku më i madh tregtar i botës të fillojë bisedimet e anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Macron u tha ligjvënësve të BE-së në Strasburg, se Franca do të mbështesë zgjerimin e unionit vetëm kur Brukseli të nxisë reformën propozuar nga Parisi zyrtar.

"*Nuk dua që Ballkani të afrohet me Turqinë apo Rusisë, por nuk dua as një Evropë, që funksionon me me vështirësi me 28 vende anëtarë dhe do të ketë edhë më shumë vështirësi të nesërmen, kur të jemi 30 ose 32, kombe",* tha ai.

Macron është shprehur i shqetësuar edhe për dyshimet që kanë lindur në disa vende evropiane pas referendumit të "Brexit". Presidenti duket se ka një listë të gjatë me dëshira për BE-së, duke përfshirë një taksë të re mbi ekonominë digjitale për të ndihmuar në financimin e buxhetit të Bashkimit Evropian. Ai ka deklaruar gjithashtu se Franca është e gatshme të rrisë kontributin e saj në buxhetin e BE dhe këmbënguli që vendet evropiane duhet të punojnë në harmonizimin e sistemeve fiskale dhe niveleve të taksave, por zgjerimi i unionit duket se nuk është pjesë e listës së tij.

Është shumë e vështirë të dihet se çfarë bën Bashkimi Evropian: politikat publike të Bashkimit mbeten të vështira për tu analizuar. Kompleksiteti i secilës prej këtyre politikave, lidhjet e tyre me politikat kombëtare përkatëse dhe vetë dinamika e integrimit evropian është e ndërtuar rreth projekteve dhe politikave për të cilat shtetet pranonin të bashkonin kompetencat e tyre dhe të transferonin një pjesë të sovranitetit të tyre.[17]

[17] Francois dArcy, Politikat e Bashkimit Evropian, 2003, fq.9

**Bibliografia:**


- Abaz Lleshi, Gjeopoltika e Ballkanit dhe Perspektivat e sigurisë në rajon, GEER, 2009.
- Francois dArcy, Politikat e Bashkimit Evropian, 2003.
- Blerim Reka, Otmar Holl, Ylber Sela, Institucionet dhe Politikat e Unionit Evropian,
    - 2010
- Dorian Jano, Politika e zgjërimit dhe ndikimi i saj në Ballkanin Perëndimor, 2017
- http://www.euic.mk/content/Brochures-pdf-NEW/ALB/11.Enlargement_AL.pdf
- http://eeas.europa.eu/archives/delegations/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/documents/more_info/undestranding_enlargement_sq.pdf
- http://eeas.europa.eu/archives/delegations/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/documents/more_info/publications/eu_europe_2020_sq.pdf

# ZHVILLIMI I MARRËDHËNIEVE EKONOMIKE DHE TREGTARE TË VENDEVE TË RAJONIT TË BALLKANIT

**Msc. Semra Bujari**

**(s.bujari@eust.edu.mk)**

**Rezarta Mamudi**

**(r.mamudi@eust.edu.mk)**

**Abstrakt**

Gadishulli i Ballkanit - Gadishulli Ilirik, është një rajon gjeopolitik dhe kulturor i Evropës juglindore. Emri "Ballkan" vjen nga fjala turke qe do të thotë "një zinxhir i maleve te pyllëzuara".Gadishulli Ballkanik shtrihet në Evropën Jugore dhe ka formën e një trekendeshi, që futet thellë në Detin Mesdhe, midis Detit Adriatik, Detit Jon në perëndim, dhe Detit Marmara e Detit Egje në lindje. Pozita e se ciles eshte shume e veçantë me klimë te volitshme.

Ballkani, që nga vitet 1990 e deri më sot, nuk bën pjesë në rajonet me rritje ekonomike në botë. Përkundrazi, sipas llogaritjeve të bëra, tregohet se pjesa e vendeve të Ballkanit brenda Prodhimit të Brendshëm Bruto sa vjen edhe tkurret. Ajo që është më dramatike është se në dy shekujt e fundit distanca e mirëqenies mes Evropës Perëndimore dhe Ballkanit sa vjen e rritet edhe më shumë.

Deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, vendet e Ballkanit në përgjithësi, vazhduan ekonominë bujqësore dhe në drejtimin e tregtisë mbetën të varura nga vendet Perëndimore. Ndërsa pas Luftës së II Botërore, Bashkimi Sovjetik, përveç Greqisë, arriti të eksportojë në Ballkan sistemin ekonomik që njihet si planifikim qendror.

Luftërat e Ballkanit të përjetuara gjatë viteve 1912-1913 dhe luftërat botërore të përjetuara më pas gjatë viteve 1914-1918 dhe 1939-1945, përkeqësuan edhe më shumë gjendjen social-ekonomike në Ballkan. Shtetet e Ballkanit kishin marrë borxhe, ishin dëmtuar ekonomikisht dhe kishin përjetuar humbje të mëdha në popullsi.

**Fjale kyce:** *vendet e ballkanit, zhvillimi ekonomik, integrimi, tregtia, investimet.*

## 1 - HYRJE

Edhe pse Ballkani është i pasur me minerale dhe të mira të tjera, mbetet regjioni më pak i zhvilluar në kontinentin e Evropës. Kanë ndikuar konfliktet dhe luftërat e brendshme dhe të jashtme, në mardhënjet feudale e socialiste. Kjo gjendje ndikoi të rriten dallimet në shkallën e zhvillimit ekonomik në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor e Bullgarisë, në njërën anë, dhe Greqisë e vendeve të BE-së, në anën tjetër.

Duke iu faleminderuar kushteve klimatike dhe pedologjike mundësitë për zhvillimin e bujqësisë janë shumë të volitshme. Vendet e Ballkanit kanë mungesa të thëngjillit gurit dhe naftës, mirëpo në anën tjetër, disa prej tyre kanë linjit dhe hidroenergji. Shumca e vendeve janë të pasura me boksit, plumb, zing, bakër, pak hekur, pastaj jometale si magnezite, kaolin, azbest, mermer etj.

Turizmi eshte një ndër degët më të rëndësishme që ndikojnë në ekonominë e një vendi.Në shtetet ballkanike turizmi ka përjetuar një zhvillim të hovshëm sidomos turizmi detar.

Rajonin e Ballkanit ishte zona e parë e Evropës për të përvojës ardhjen e kulturave bujqësore në epokën neolitike. Praktikat e rritjes së grurit dhe rritjen e bagëtisë ardhur në Ballkan nga Gjysmëhëna pjellore nga mënyra e Anadollit, dhe në perëndim dhe në veri përhapur në Pannonia dhe Evropën Qendrore.

Identiteti i Ballkanit është e dominuar nga pozicionin e saj gjeografik, historikisht zona ishte i njohur si një udhëkryq i kulturave të ndryshme. Kjo ka qenë një nyje midis organeve latine dhe grek e Perandorisë Romake, destinacionin e një fluksi masiv të sllavëve paganë, një zonë ku ortodokse dhe katolike Krishterimi u takua, si edhe si pika e takimit mes Islamit dhe Krishterimit.

Në para-klasike dhe antikitetit klasik, ky rajon ishte në shtëpi për të grekëve, ilirëve, Paeonians, Thracians, Dakët dhe grupe të tjera të lashta. Më vonë Perandoria romake pushtuan shumicën e rajonit dhe përhapjen e kulturës romake dhe gjuha latine, por ende mbetet pjesë e rëndësishme nën ndikimin klasike greke. Gjatë Mesjetës, Ballkan u bë terrenin për një seri luftrash midis perandorive bizantine, bullgare dhe serbe.

Ndoshta ngjarje historike që la shenjë më të madh në kujtimet kolektive të popujve të Ballkanit ishte zgjerimi dhe më pas rënia e Perandorisë Otomane. Nga fundi i shekullit 16, ai ishte bërë forcë kontrolluese në rajon, edhe pse ajo ishte përqendruara rreth Anadoll. Shumë njerëz në

ISSN 1857-7482, Nr. 22, 2019___________________________________www.eust.edu.mk/Heritage/__

Ballkan dhe Karpatet vendin e heronjve më të madhe të tyre popullore në epokën e as sulm ose tërheqje të Perandorisë Osmane. Si shembuj, për kroatët, Nikola Šubić Zrinski dhe Petar Kružić, për serbët, Milush Kopiliqi dhe car Llazarit, sepse shqiptarëve, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, sepse maqedonasit etnik, Nikolla Karev, për boshnjakët, Husein Gradaščević dhe për bullgarët, Vasil Levski, Georgi Sava Rakovski dhe Hristo Botev. Në shekujt e kaluar disa, për shkak të luftrave të shpeshta osman në Evropë dhe rreth luftuan në Ballkan, dhe krahasuese izolimin Osmane nga përgjithshme e parë ekonomike (duke reflektuar zhvendosje të qendrës tregtare dhe politike të Evropës e gravitetit ndaj Atlantik), Ballkani ka qenë më pak të zhvilluara pjesë e Evropës.

Vendet e Ballkanit filluan të rifituar pavarësinë e tyre në shekullin e 19 (Greqia, Serbia, Bullgaria, Mali i Zi), dhe në një Ballkan League 1912-1913 reduktuar e Turqisë në territorin e vet i pranishëm në masë të Luftës së Parë ballkanike. Lufta e Parë Botërore u nxit në vitin 1914 me vrasjen në Sarajevë (kryeqyteti i Bosnje dhe Hercegovinë) e Franc Ferdinandit Archduke të Austrisë. Perandori osmane ishte një nga tri partitë më të rëndësishme të pushtetit qendror. Një kontribut të rëndësishëm drejt fitores mirëkuptim u zhvillua në rajon, pasi Greqia u bashkua luftës në vitin 1917, me kapitullimin e Bullgarisë dhe perandorinë osmane, gjë që çoi në kapitullimin e shpejtë të Austro-Hungarisë.

Suksesi greke kundër forcave të Boshtit gjatë Luftës së Dytë Botërore, dhe shqiptarë të mëvonshëm, greke dhe serbe të rezistencës, e ndryshuan kursin e luftës dhe iu dha aleatëve një hap vendimtar drejt fitores. Pas Luftës së Dytë Botërore, Bashkimi Sovjetik dhe komunizmi ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në Ballkan. Gjatë Luftës së Ftohtë, shumica e vendeve në Ballkan ishin të sunduara nga sovjetiket i mbështetur nga qeveritë komuniste. Greqia mbeti jo vetëm vend Sovjetik, por ishte edhe i vetmi vend në Evropë në të cilën luftë e ftohtë u "nxehta" për shkak të luftës civile greke.

Megjithatë, pavarësisht se nën qeveritë komuniste, Jugosllavisë (1948) dhe Shqipëri (1961) ra me Bashkimin Sovjetik. Jugosllavia, të udhëhequr nga Marshalli Josip Broz Tito (1892-1980), propped parë deri atëherë hodhi poshtë idenë e bashkimin me Bullgarinë, dhe në vend kërkuar marrëdhënie më të ngushta me Perëndimin, më vonë edhe bashkimin me shumë vende të treta në botë jo-Inkuadruarve. Shqipërinë në anën tjetër gravitated drejt Kinës komuniste, pas miratimit të një pozitë të izoluar.

Jo vetëm vendet komuniste ishin Greqia dhe Turqia, të cilat ishin (dhe akoma janë) pjesë e NATO-s.

Në vitet 1990, rajon ishte tejet i prekur nga konflikti i armatosur në ish-republikat jugosllave, duke rezultuar në ndërhyrje nga forcat e NATO-s në Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi dhe Maqedoni. Statusi i Kosovës dhe shqiptarëve etnikë në përgjithësi është ende kryesisht të pazgjidhura.

Vendet e Ballkanit kontroll rrugët e drejtpërdrejtë tokës midis Evropës Perëndimore dhe South Ëest Asia (Azi e Vogël dhe Lindja e Mesme). Që nga viti 2000, të gjitha vendet e Ballkanit janë miqësore ndaj BE-së dhe SHBA.

Greqia ka qenë një anëtar i Bashkimit Evropian që nga viti 1981, Sllovenia dhe Qiproja që nga viti 2004. Bullgaria dhe Rumania u bashkua në vitin 2007. Në vitin 2005, Bashkimi Europian vendosi të fillojë negociatat e pranimit me vendet kandidate, Kroacia, Turqia dhe Maqedonia ishin pranuar si kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Që nga prilli 2009, Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Rumania dhe Sllovenia janë edhe anëtarë të NATO-s. Bosnje dhe Hercegovinë dhe se si ishte atëherë Serbia dhe Mali i Zi filloi negociatat me BE për Stabilizim dhe marrëveshjet e pranimit, edhe pse pak pas ata filluan, bisedimet me Serbinë dhe Malin e Zi ishin pezulluar për shkak të mungesës së bashkëpunimit me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë.

Të gjitha vendet e tjera kanë shprehur dëshirën për t'u bashkuar me BE, por në një datë në të ardhmen.

Ballkani sot është një shumë të ndryshme etno-gjuhësore rajon, duke qenë në shtëpi të sllav të shumta, Romance, dhe në gjuhën turke, si edhe grek, shqiptar dhe të tjerët. Përmes historisë së saj shumë grupe të tjera etnike me gjuhën e tyre jetonin në zonë, në mesin e tyre Thracians, ilirët, romakët, Pechenegs, Cumans, Avaret, Celts dhe fiseve të ndryshme gjermanike-popull.

## 2 - RËNIA E EKONOMISË SË BALLKANIT SHKAK I MIGRIMEVE

Për shkak të migrimeve të lidhura me problemet ekonomike, në popullsinë e vendeve të rajonit deri në vitin 2050 pritet një rënie shumë e madhe. Kushtet ekonomike dhe standardet më të mira të jetesës të cilat i ofrojnë shtetet e Evropës , shkakton që popullsia e kualifikuar në vendet e

Ballkanit të migrojë në këto vende, ndërsa ekziston shqetësimi se këto migrime masive në një të ardhme të afërt do të shkaktojë problem serioz të fuqisë punëtore.

Në Maqedoni ka pasur megrim intensive. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave të Maqedonisë, në periudhën prej vitit 1994 deri më 2013, nga vendi kanë migruar 11.380 persona.

## 3 - HAPAT PER INTERGIMIN EKONOMIK TE BALLKANIT

Integrimi i tregtisë, investime rajonale, lehtësimi i lëvizjes rajonale dhe ndërlidhja digjitale janë katër shtyllat kryesore që pritet të shërbejnë si një urë për integrimin ekonomik të Ballkanit.

Eshtë zhvilluar nje kërkesë qe të gjashtë kryeministrat e Ballkanit Perëndimor të përgatisin një “propozim të përbashkët për të çuar përpara ekonomin në Ballkanin Perëndimor” (në Sarajevë, më 16 mars 2017). U pergatit një axhendë e strukturuar për integrimin ekonomik rajonal, sipas propozimeve te bera nga Takimi i Liderëve, përkatësisht: nxitjen e integrimit të mëtejshëm të tregtisë, futjen e një hapësire rajonale dinamike për investime, lehtësimin e mobilitetit (lëvizjes) rajonale dhe krijimin e një axhende integruese dixhitale. Keto ndryshime do te bazohen në rregullat dhe parimet e CEFTA-s (Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore) dhe BE-së (Bahkimi Evropian).

Parashikoet zbatimi I veprimeve në të gjitha nivelet në periudhën ndërmjet 2017 dhe 2020 (me disa veprime që zgjasin deri në vitin 2023). Keto veprime do të mundësojnë rrjedhjen e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe punësimit me kualifikim të lartë, duke e bërë rajonin më tërheqës për investime dhe tregti.

## 4 - INVESTIMET

Investimet më të medha bëhen në 6 vendet e Ballkanit perëndimor siç janë: Sërbia, Maqedonia e Veriut, Bosnje-Herzogovina, Shqipëria, Kosova, Mali i Zi per shkak se ato janë shtetet më të pazhvilluarat të gjithë Ballkanit.

Disa nga shkaqet për të investuar në këto vendet ballkanike janë:

-Të gjitha vendet kanë aplikuar për anëtarësim në BE. Edhe pse procesi është në etapa të ndryshme vitin e fundit shihet nje perparim shumë i madh sesa vitet më parë.

-Të gjitha vendet gëzojne shkallë shumë të ulët të inflacionit dhe sistemit tatimor në krahasim me vendet e tjera të BE-së.

-Rajoni shërben si urë lidhëse midis shumë vendeve të ndryshme të Evropës.

-Nivelet e arsimit bazë dhe shkrim-leximit janë shumë të lartë në krahasim me standardet ndërkombëtare.

## 5 - INVESTIMET DIGJITALE

Transformimi digjital po ndryshon mënyrën se si ne komunikojmë, punojmë, mësojmë dhe jetojmë. Ai ndryshon mënyrën se si ne bëjmë biznes dhe bashkëveprojme. Përdorimi i teknologjive digjitale mund të sjellë përfitime të rëndësishme në aspektin e shpejtësisë, efikasitetit dhe transparencës përtej kufijve në shumë sektorë të ndryshëm.

Shfrytëzimi i potencialeve të pashfrytëzuara të integrimit digjital siguron furnizimin e shërbimeve novatore dhe konkurruese për konsumatorët dhe bizneset dhe vepron si një levë e rëndësishme për zhvillimin socio-ekonomik, krijimin e vendeve të punës me vlerë të lartë.

Digjitalizmi është mënyra se si sot ndërmarrjet dalin në treg, bashkëveprojnë me klientët dhe kryejnë operacionet e tyre.

Zhvillimi i digjitalizmit duhet të kryhet në 6 pikat strategjike: klientët, punëtorët, operacionet, siguria dhe qëndrueshmeria, infrastruktura dhe prishja ose shembja (kryesisht e ndërtesave).

## KONKLUZION

Ekonomia e vendeve Ballkanike është ende në zhvillim. Ka shumë aspekte në të cilat duhet të zhvillohet. Ky zhvillim është shumë i ngadaltë për shkak të ekonomisë dhe tregtisë së ulët por në vitet e fundit siç tham është përshpejtuar.

Njerëzit kanë filluar të hapin më tepër biznese private gjë që ndikon pozitivisht në ekonominë e vendeve të Ballkanit. Shteti me politikat e tij dhe me dhënien e subvencioneve të ndyshme përkrah bizneset e vogla dhe të mesme dhe ndikon në rritjen e bruto prodhimit të brendshmëm të vendit.

Ne që jetojmë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, shtet i cili bën pjesë në vendet më të pazhvilluara të Ballkanit shpresojme se do të rriten investimet, tregtia dhe turizmi, do të ulen migrimet dhe së shpejti do të bëjme hapa të reja dhe inovative drejt rritjes së nivelit ekonomik të vendit.

Besojmë që vendi jone vërtet ka potencial shumë të madh në aspektin e pasurive, pozitës gjeografike, bukurise natyrore për të qenë më shumë se që është tani.

**Bibliografia:**


- Prof.Dr Ilija Kristo :"Biznesi ndërkombëtar", Tiranë 2004
- Prof.Dr Selman Selmanaj :"Sisteme ekonomike bashkekohore", Prishtin 1996
- Prof.Dr Zeqirija Idrizi Integrimet evropiane , Shkup, 2009
- Prof.Dr Blerim Reka Studime evropiane, Tetovë, 2003
- Prof. Jeff Madura :"Drejtim financiar nderkombetar", Investimet e huaja direkte, 2000
- Dr.Alan Bevan, Dr.Saul Estrin,Dr.Heather Grabbe:"Foreign direct investment and Europian Union, 2004
- https://shtetiëeb.org/2017/10/01/ballkani-si-nje-ekonomi-e-vetme/
- http://pubdocs.ëorldbank.org/en/425051491490470862/ËBRER-11-ALB.pdf
- https://lajmi.net/ëiië-ekonomia-e-vendeve-te-ballkanit-perendimor-eshte-ne-rritje/
- https://ëëë.strategyand.pëc.com/ca/en/media/ëhats-your-digital-roi.pdf

# DIRECT LEARNING STRATEGIES

**Msc. Xhiljola Abdihoxha**
**(xhiljola_a@yahoo.com)**
**Marin Barleti University**

**Abstract**

The focus of this research paper is the use of direct strategies, such as Cognitive Strategies, Memory Strategies and Compensation Strategies in order to enhance the performance in the four language skills (writing, reading, speaking and listening). The paper will be mainly focused on the specific ways how the subsets of the above-mentioned strategies work together to facilitate the process of learning a foreign language (such as creating mental linkages, applying images and sounds, semantic mapping, associating/elaborating etc.).

In this research paper it is clearly shown how some direct strategies, (such as taking notes), work across all four skills, whereas some others, (like getting the idea quickly), are efficient for only a subset of skills. But, in order to have good results from the use of direct strategies, a good collaboration with indirect strategies, is vitally needed.

The purpose of this paper is also to show in a very practical and effective way the cooperation of these elements for a better understanding and memorization of a new language.

**Keywords** – *direct learning strategies, mental linkages, grouping, semantic mapping , mechanical techniques, acquisition of a new language, retrieve target language information, practice, analyze, recombine, deductive reasoning, translate, guess, coin words*

## 1 - INTRODUCTION

The comprehension and learning of a language involves a mixture and collaboration of different strategies. These strategies might be direct and indirect ones. The two key functions of memory strategies are storing and retrieving new information. These will help learners to store the important things that they hear or read in the new language in memory, thereby broadening their knowledge base. These strategies also allow learners to retrieve memory information when they need to use it for understanding or reproducing. Memory strategies descriptions below focus primarily on the storage function as this is the initial learning key. There are three groups of straightforward strategies— memory, cognitive, and compensation strategies used to develop each of the four language skills: listening, reading, speaking, and writing. If supported by indirect strategies, these direct strategies work best. The discussion is based on two hypotheses. First of all, all four language skills are important and deserve particular attention and action, and second, learning strategies help students to improve each of the skills. But, what do memory, cognitive and comprehension strategies really include? In this paper, you will find a deep evaluation and analysis of that.

## 2 - MEMORY STRATEGIES

Talking about memory strategies, we should mention four main subdivisions which are:

- Creating mental linkages
- Applying images and sounds
- Reviewing well
- Employing action

Three types of strategies are useful for creating **mental linkages**: grouping, associating/elaborating, and placing new words into a context.

**a)** **Grouping** includes the classification or reclassification of what is heard or read into meaningful groups, thereby reducing the number of unrelated elements. It also involves the labeling of the groups at times. So, Alan, who is learning English, writes down in his notebook new words when he hears them, and he categorizes them grammatically: for example, *you, he, she, someone; completely, hard, easy, kind, soft; quickly, heatedly, markedly, they*. Then, he labels

these categories: pronouns, adjectives, and adverbs. Janet, a student of French, is listening to a talk about computers. She writes down the important words, such as *unite centrale* (central processing unit), *l'informatique* (computer science), *l'ordinateur* (computer), *l'ecran* (screen), *le clavier* (keyboard) etc. Then she groups these words according to whether they are masculine or feminine.

**b) Associating/Elaborating** involves associating new language information already in memory with familiar concepts. Of course, these associations are likely to reinforce understanding and make it easier to remember the material. Any association must have meaning for the learner, although it may not make anybody else a great deal of meaning. Here are some examples in the listening area. Tom wants to remember the name of *Solange*, the university secretary, who has just been introduced in French. He associates the name Solange with something else about her by saying "So long. Here is another example of associating/elaborating in reading. Heloise reads a German story that contains the word *Wissenschaft* (knowledge). She associates this word with the English words *wise* and *shaf*t and remembers the German word by thinking of knowledge as a shaft of wisdom.

**c) Placing New Words into a Context** includes placing new words or expressions that have been heard or read into a meaningful context, such as a spoken or written sentence, as a means of remembering it. As an example in listening, Michel has heard the names of the *Great Lakes* in the United States and wants to remember them. To do so, he uses the acronym HOMES (standing for Huron, Ontario, Michigan, Erie, and Superior) and puts it in the context of the spoken sentence, "My HOME'S on the Great Lakes."

When it comes to **applying images and sounds**, we can mention these strategies: using imagery, semantic mapping, using keywords, and representing sounds in memory.

a) **Using Imagery** is a very efficient way to remember what was heard or read in the new language. Joe remembers a whole set of household chores-related verbs (e.g., *cooking, cleaning, washing, cutting, buying*) by making a mental picture of the situation in which he first heard these words during a refugee camp English class.

b) **Semantic Mapping** incudes organizing ideas and relationships on paper to create a semantic map, a diagram in which key concepts (in words) are highlighted and linked by arrows or lines to related concepts. This strategy is useful to improve the memory as well as the

understanding of new expressions. It can be used for pre-listening or pre-reading activities to help learners understand and remember vocabulary that will be heard or read...

c) **Using Keywords** combines images and sounds to make it easier for learners to remember what they are hearing or reading in the new language. There are two phases in the strategy. Initially, identify a familiar word that sounds like the new word in one's own language or another language. Then, create a visual image of the new word that interacts in some way with the familiar one. Levy, for example, connects the new French word *froid* with a familiar word, Freud, and then imagines Freud standing in the cold outside.

d) **Representing Sounds in Memory** helps learners bear in mind what they are hearing by making sounds audible rather than visually represented. This encompasses linking the new word to familiar words or sounds from any language, the new language, one's own language or any other language. Rhymes are famous examples of memory sound representation. For instance, Mary uses rhyme to learn English words like coat, goat,, boat, dote, float, moat, etc.

**Reviewing Well** (listed above as the third strategy of Memory Strategy), the only strategy in this set, is structured reviewing, which is particularly effective in the target language to remember new material. It involves reviewing at different intervals, first dose together, and then becoming increasingly distant. Malan, for example, is learning a set of English vocabulary words. He is immediately practicing them, waiting 15 minutes before practicing them again, and practicing them one hour later, three hours later, and the next day, and so on until the material becomes more or less automatic. He keeps spiraling back to these particular words of vocabulary in this way, although he may find some other new material in class. Of course, the amount of time required to automatically make new material depends on the type of material concerned.

**Employing Action**, the last but not the least, also plays an important role in memorizing new words.

a) **Using Physical Response or Sensation** could well involve physically acting out. This strategy is based on the teaching method known as Total Physical Response; students listen to a command and then act it out physically (and later they will also give other people orders). For instance, the teacher tells Tessy, "Take the pencil, go to the pencil sharpener, sharpen the pencil,

and then give it to Maria." While Tessy carries out these instructions, she realizes that physical movement helps to memorize the new information

b) **Mechanical techniques** are sometimes helpful to remember what we heard or read. For example, flashcards are both familiar and helpful, with the new word written on one side and the definition written on the other. Students can write the new expression on a flashcard in a complete sentence to contextualize a new expression and get writing practice

Learners can use memory techniques to quickly retrieve target language information, so that this information can be used for any of the four language skills involved in communication. The same mechanism that was originally used to store the information (for example, a mental association) can later be used to recall the information. Mathilde wants to remember the word for drawer in Italian (*cassetto*). In this way she can write a note to her Italian coworker explaining that the important papers are in the drawer. Mathilde originally memorized the word by using the keyword strategy, which means creating a mental picture of herself holding cassettes in a drawer. Mathilde recalls this picture in writing the note, remembering the word needed, *cassetto*.

1. **COGNITIVE STRATEGIES**

- Practicing
- Receiving and sending
- Analyzing and reasoning
- Creating structure for input and output

Practicing, in itself, contains five strategies: repeating, formally practicing with sounds and writing systems, recognizing and using formulas and patterns, recombining, and practicing naturalistically.

**a) Repeating** that can be used in highly innovative ways is, in fact, indispensable for all four language skills and almost always comprises some degree of meaningful understanding. A good method is listening to new language native speakers on a tape or record, with or without silent rehearsal. For example, every day, Bonnet listens to the French weather report while eating breakfast. He is now well acquainted with weather-related terms such as le *soled* (sun), *chard* (hot) etc. Repeating strategy may mean reading a passage more than once in order to understand it thoroughly. Reading a passage several times, each time for different purposes is an efficient

technique: for example, getting the general drift or the main ideas, predicting, reading for details, etc.

**b) Formally Practicing with Sounds and Writing Systems**, is another strategy, whose focus is often on sound perception (pronunciation and intonation) rather than on the understanding of meaning. This strategy can be extended to include not only listening, but also speaking. Tapes or records are helpful for this strategy. They allow students to record themselves in order to hear and compare their own voices with the voice of a native speaker.

**c) Recognizing and Using Formulas and Patterns** in the target language significantly improves the understanding and production of the learner. Formulas are expressions that are unanalyzed, whereas patterns have at least one slot that can be filled with an alternative word. Examples of formula are *A demain*. (see you tomorrow in French) *Bis spater*. (until later in German) *A tout a l'heure!* (See you later in French). Patterns might include *Per piacere, dove* . . . (Please, where is …in Italian) etc.

***d)*** **Recombining** involves creating a meaningful sentence or longer expression by putting together familiar elements in new ways, which always provides useful practice. Rosine knows the three expressions *weather's fine, I think I'd like . . ., and take a walk*. In practicing her spoken English, she creates the following new sentence from these three expressions with some additional words: *The weather's fine today, so I think I'd like to take a walk.*

**e) Practicing Naturalistically** focuses on using the language for actual communication. As applied to listening, this learning strategy involves understanding the meaning of the spoken language in a naturalistic context.

**Receiving and Sending Messages** consists of two strategies: Getting the idea quickly and using resources for receiving and sending messages.

**a) Getting the idea quickly**, used for reading and listening helps home learners to understand exactly what they need or want, and it helps them to ignore the rest or use it as background information only. Skimming and scanning are two techniques that make up this strategy. Skimming involves looking for the main ideas that the speaker wants to convey, while scanning means searching for the learner's specific details.

**b) Using Resources for Receiving and Sending Messages** consists of use of resources to find out the meaning of what is heard or read in the new language, or to convey

messages in the new language. Printed resources such as grammar books, dictionaries, word lists, thesauruses, target language dictionaries, and bilingual dictionaries may be valuable. Non-print resources include tapes, TV, videocassettes, radio, museums, and exhibitions, among others.

Analyzing and Reasoning include five strategies mentioned below.

a) **Reasoning Deductively** includes hypothesizing the meaning of what is heard through general rules already known to the learner. For instance, Julio, who is learning English, hears his friend say, "Would you like to go to course at nine o'clock?" Julio correctly understands that he is being asked a question to which he must respond, because he recognizes that part of the verb comes before the subject (a general rule he has learned).

**b) Analyzing Expressions** is an efficient method that dissolves into its component parts a new word, phrase, sentence or even paragraph**.** So, for example, Maria is learning English. She does not immediately understand the phrase *premeditated crime*, which she hears in a TV news broadcast. She breaks down this phrase into parts that she does understand: *crime* (bad act), *meditate* (think about), and *pre*- (before). Thus, she understands the meaning of the whole phrase: an evil act that is planned in advance.

c) **Analyzing Contrastively** is a fairly easy strategy that most learners use naturally. It consists of analyzing elements (sounds, words, syntax) of the new language to distinguish likenesses and differences in comparison with one's own native language. We can refer to Halle's case, who recognizes through contrastive analysis that the German word *katze* sounds like the English word *cat.*

**d) Translating** enables students to use their own language to understand what they are hearing or reading in a new language**.**

e) **Transferring** means directly applying previous knowledge to facilitate new knowledge in the target language. This strategy relates to all four skills and usually works well if language elements or concepts are directly parallel, but this doesn't usually happen. Controversially, if learners convey irrelevant knowledge across languages, this can result in inaccuracy.

Creating structure for input and output includes taking notes, summarizing and highlighting, which obviously help learners sort and arrange data in the target language that crosses their path. For example, **note-taking** is often considered an advanced tactic that can be used at high levels of proficiency, even though this skill is taught at very early stages. **Summarizing**

means making the original passage a condensed, shorter version. It can be more demanding (and sometimes more helpful) to write a summary than to take notes, because it often requires more sum-up-skills. Sometimes, learners profit by attaching notes and summaries to another strategy, which is **highlighting**. It dramatically emphasizes the main issues by means of color, underlining capital letters, initial capitals, big writing, bold writing, * stars, etc.

The last, but not the least, are **Compensation Strategies**, which include

- Guessing intelligently
- Overcoming limitation in speaking and writing

In listening and reading, it is crucial to guess. It helps learners to see beyond the belief that every single word must be recognized and understood before they can comprehend the overall meaning. Two compensation strategies relevant to listening and reading involve using linguistic clues and other clues.

a) **Using Linguistic Clues** - Previously acquired knowledge of the target language, the learners ' own language, or some other language can provide the meaning of what is heard or read with linguistic clues. Suffixes, prefixes and word order are useful language clues for the conjecture of meanings. For example, Anthony recognizes *shovel, lawn, mower*, and *grass*, so he knows the conversation is about gardening.

b) **Using Other Clues** - Besides clues that come from pure language knowledge, there are clues from other sources, as well. Some clues are language-related but go beyond them (such as address forms that imply social relationships). Careful examination of nonverbal behavior, such as voice tone of the speaker, facial expression, emphasis, and language of the body (gestures, distance, posture etc.), help students understand what is being said. Knowing what has already been said often makes it important to get the meaning of what's being said at the moment and to anticipate what's going to be said later.

The second point mentioned above, Overcoming Limitations in Speaking and Writing, is a very familiar strategy by new learners. It includes:

a) **Getting help**, which means requesting someone to help in a conversation by hesitating or explicitly asking for the missing expression.

b) **Using Mime or Gesture**, where instead of a phrase during a conversation, the learner uses physical movement, such as mime or gesture, to indicate the meaning.

c) **Avoiding Communication Partially or Totally,** consists of avoiding communication when difficulties are anticipated or encountered. In these cases, this requires complete avoidance, such as when necessary to use persuasion skills or to compete with others for the turn to speak. It also includes avoiding certain subjects for which the learner does not know the new language's words, concepts or grammar structures.

d) **Selecting the Topic** is a strategy in which learners want to make sure that the topic is one in which they are interested and for which they possess the needed vocabulary and structures. For example, Rachel, is interested in baseball and knows a lot about it, including useful terms, so she often directs conversation to this theme, since she is well conscious of these vocabulary.

*e)* **Adjusting or Approximating the Message** is used to alter the message by omitting some items of information, make the ideas simpler, or say something slightly different that carries the same meaning. For instance, instead of writing *"I can't go to New Zealand, because I lack the necessary funds,"* Nella writes *"I cannot go to Australia, because I do not have money."*

f) **Coining Words** means inventing or creating new words to communicate a notion for which the learner does not have the right vocabulary. For instance, Helen who is German, does not know the expression *bedside table* and therefore coins the expression *night table*, a direct translation of the German *Nachttisch*

g) **Using a Circumlocution or Synonym** is the strategy in which the learner uses a circumlocution or a synonym in order to convey the intended meaning. We can refer to the case of Billy, a learner of English, who does not know the word *car seatbelt*. Thus, he says, *"I'd better tie myself in."*

## CONCLUSION

As a conclusion, there is a wide range of direct strategies that will help learners of a new language understand and memorize new words or structures easily. As explained above, all these methods, in cooperation with each other, help to achieve a good command of a new language. They do not really work well without one another. This is why, it is strongly recommended and extremely needed an in-depth comprehension of these strategies by the teachers all around the world, and also the ability to use and practice them during their classes. We, as learners,

encountered these methods when we started to learn a foreign language, but we were not conscious of knowing them theoretically. Except of direct strategies, there are also indirect ones, and the best result of students, requires the use of them both, direct and indirect strategies, as an important means of learning a new language.

**Bibliography:**


- "Language Learning Strategies": Theory and Research by Carol Griffiths
- "Task-Based Language Teaching" by David Nunan - University of Hong Kong
- "Cognitive Linguistics Research, Space, Time, and the Use of Language"- An Investigation of Relationships by Thora Tenbrink
- "Language Learning Strategies" by Rebecca L.Oxford – University of Alabama
- "Promoting Behavior for Learning in the Classroom: Effective strategies" – Simon Ellis, Janet Tod
- "Effective Language Learning: Positive Strategies for Advanced Level Learning" – S.Graham,
- "Modern Languages and Learning Strategies" - Carol Griffiths

# PARANDALIMI I KRIMINALITETIT

**Doc. Dr. Dashmir Nasufi**

**International University of Struga**

## Abstract

Termi prevencion është huazuar në mënyrë pragmatike nga vokabulari dhe praktika mjekësore. Në kuptimin e vetë të gjerë janë profiluar dy përmbajtje themelore të këtij nocioni. I pari prej tyre ka të bëjë me intervenimin si formë primare e prevencionit. Kjo qasje në esencë ka shënuar intervenimin ndaj dukurive të caktuara me mjete të përcaktuara që më parë. Përmbajtja e dytë lidhet me prefiksin pre që shënon reaksionin e parakohshëm, më saktësisht reaksionin para se të jetë manifestuar dukuria e padëshiruar.

Në gjuhën latine, praeventio (prae-venio, veni, ventum, praeventus, praevenire) shënon përcaktimin dhe termin e kaloj, arrijë përpara, e kapërcej një dukuri të caktuar, ose si siç do të mund të thuhej në bazë të mendjes së shëndoshë parandalim, mbrojtje paraprake, pengim, shmangie që më parë. Që nga shekulli XV në praktikën angleze socio – politike dhe kriminale – politike përdoret shprehja prevent, me të cilën dëshirohet të theksohet çdo përmbajtje me të cilën në periudhën e ardhshme do të pengohen sjelljet e dënueshme në kuptim të ngushtë të përcaktimit të tyre. Nga kategorizimi i cekur më parë, mund të vërejmë se nocioni parandalim përmban në vete të gjitha masat e ndërmarra në mënyrë të planifikuar, të paramenduar dhe të organizuar me të cilat do të bëhen përpjekje të mënjanohen ose së paku të zvogëlohen shkaqet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të sjelljeve të dënueshme (Horvatiq, Cvitanoviq, 1999). Disa autorë me parandalimin nënkuptojnë vetëm atë lloj të aktivitetit që ndërmerret në drejtim të pengimit të kriminalitetit nga ana e opinionit, bashkësisë lokale, organeve dhe shërbimeve në përgjithësi, (Van, Dijk, De Waard 1991).

**Keywords** – *Parandalim, kriminalitet, e drejtë, penale*

**Hyrje**

Vetë njohuria mbi kriminalitetin, siç e kemi cekur tashmë, është shumë e vjetër, kurse idetë mbi parandalimin e dukurive të tilla në shoqëri janë të një date relativisht më të re. Kur flitet për parandalimin qoftë në fillim të aplikimit të tij ose në botëkuptimet më të reja, në radhë të parë mendojmë në strategjinë sociale. Pra, konstanta në shumësinë e variablave që paraqiten në përpjekjen e përcaktimit jo vetëm të parandalimit, por edhe të vetë politikës së luftimit të kriminalitetit, që depërton në orientime të shumta, ka qenë pa dyshim i ashtuquajturi reaksioni shoqëror (social). Sipas këtij orientimi, si koncept i përkrahur dhe i themeluar social i aktivitetit, parandalimi paraqet padyshim frontin më të gjerë dhe më human në luftë kundër kriminalitetit në bashkësitë bashkëkohore shtetërore.

Në domethënien e vetë pragmatike, politika e parandalimit të kriminalitetit përfshin veprime të niveleve të ndryshme.

Veprat penale, sipas kuptimit të ngushtë të nocionit të kriminalitetit, të sjelljeve të dënueshme përfshin aktivitetet primare (ante delictum), me të cilat bëhen përpjekje të pengohen sjelljet kriminale dhe të zvogëlohet numri i tyre para se të konkretizohet akti kriminal. Koncepcioni diçka më i ngushtë nënkupton nivelin e parandalimit me instrumentet penale – juridike (post delictum) sipas të cilit veprohet në mënyrë preventive pas kryerjes së veprës penale, (post judicem) pas aktgjykimit të shqiptuar të formës së prerë dhe të ndihmës postpenale, d.m.th. të veprimit pas sanksionit të ekzekutuar ose të aplikuar penal– juridik.

Në procesin e definimit të parandalimit të kriminalitetit problemi që shkoqitet është plotësisht i qartë duke pasur parasysh vetë natyrën e tij. Për të kuptuar problemin e cekur është e domosdoshme të parashtrohen disa postulate themelore që me siguri pasqyrohen në faktin që me aktivitetet preventive nënkuptohet një varg i tërë masash, veprimesh dhe procedurash, që reciprokisht dallohen mjaft. Në këtë mënyrë parandalimi paraqet kompleksin më të gjerë të politikës bashkëkohore kriminale.

Interesimi i saj nuk përfundon vetëm në fenomenin e kriminalitetit (në kuptim të ngushtë), por në fenomenin e sjelljeve të dënueshme në përgjithësi. Sipas disa botëkuptimeve trendet bashkëkohore të parandalimit nënkuptojnë edhe marrjen me të ashtuquajturën sferën para delikuente të sjelljes (sidomos në trajtimin e të miturve) që mund të renditen në fushën e sjelljeve sociopatologjike në një shoqëri.

Parandalimi i kriminalitetit përfshin edhe aktivitetet e subjekteve të ndryshme që nënkuptojnë masat preventive. Masat e tilla të parandalimit të kriminalitetit mund të nënkuptojnë: forumet shtetërore dhe forumet me autorizime publike, organizatat joqeveritare, shoqatat, fondacionet private, institucionet e informimit publik, shtypin, mediat elektronike, institucionet edukative, përkatësisht arsimore, rrethin profesional në kuptimin më të gjerë të fjalës, institucionet fetare, familjen si grup fundamental social të çdo shoqërie.

Aktiviteti i vetë shtetit në këtë plan fokusohet në miratimin dhe perfeksionimin e projekteve ligjore, d.m.th. me dizajnimin e legjislacionit penal, kurse më vonë me operacionalizimin përmes masave preventive të policisë dhe të shërbimeve të specializuara shtetërore, që merren me kriminalitetin në kuptim të ngushtë dhe të gjerë të domethënies së tij. Mirëpo, siç e kemi cekur parandalimi i kriminalitetit shumë shpesh ka të bëjë edhe me zbatimin e disa masave nga ana e vetë qytetarëve, qoftë në mënyrë të pavarur, qoftë nëpërmjet disa organeve, shërbimeve të specializuara, pastaj shoqatave të krijuara në mënyrë spontane ose të planifikuar, si dhe të disa sektorëve të tjerë të jetës shoqërore, siç është sektori i informimit etj[18].

Qëllimi i parandalimit të kriminalitetit është pengimi i një vargu të tërë të veprimeve të ndryshme kriminale siç janë: deliktet pasurore, deliktet lidhur me drogën, deliktet e dhunës pastaj, sot për opinionin delikti interesant dhe shumë i shfrytëzuar nga ana mediale i kriminalitetit të organizuar. Këtë po e apostrofojmë në mënyrë që të kuptojmë se është fjala për forma dhe aktivitete shumë përmbajtjesore që është vështirë të përfshihen me një masë ose me një instrumentarium unik, dhe nga ky aspekt mund të flitet për lloje të ndryshme të parandalimit të kriminalitetit.

Shumë shpesh paraqet arsyen për njëjtësimin konceptual të represionit dhe të parandalimit. Aktivitetet strategjike që është e domosdoshme të implementohen brenda qëllimeve preventive mund të realizohen në format më të ndryshme. Në këtë kontekst duhet nisur nga eliminimi i përgjithshëm i kushteve objektive sociale që prevalojnë në dukurinë e kriminalitetit në një hapësirë të caktuar, e me siguri mund të pohohet se ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në fenomenin e hulumtuar të sjelljes së dënueshme.

Kjo veprimtari para se gjithash nënkupton reaksionin social pasi që fjala është për dukuritë që janë rezultat i një pasqyre sociale të shoqërisë[19]. Identifikimi i vatrave që dijagnostifikohen në bazë të vlerësimeve kualitative të rrezikimit paraqesin fondamentin për ndërmarrjen e masave të nevojshme me qëllim të zvogëlimit të situatave potenciale që mund të shkaktojnë lindjen e sjelljeve kriminale. Dizajni ekologjik i mjedisit, shumësia e masave tjera që ndërmerren në një masë të madhe paraqesin hap të sigurt drejtë sigurimit të bashkësisë nga kriminaliteti.

Mirëpo, veprimet nuk mund t'i arrijnë rezultatet pa ndërlidhjen e sistemit të prevencës sociale me sistemin penal – juridik të një shteti. Pra, fjala është për veprimin e barazuar, sistematik dhe në fund komplementar të të gjitha nënsistemeve mbrojtëse të shoqërisë. Problemet megjithatë paraqiten për shkak të vështrimit të ngushtë të problemit të kriminalitetit.

Nëse kriminaliteti trajtohet ekskluzivisht si problem juridik, me këtë në një masë të konsiderueshme përjashtohet dhe kufizohet pjesëmarrja e disa profesioneve – kriminalistëve, sociologëve, psikologëve, mjekëve, pedagogëve etj. Pikërisht këto kufizime të koncipimit dhe të programimit preventiv kanë për pasojë shumë vështirësi në zbatimin e parandalimit të

[18] Krivokapiq, 2002.
[19] Ketu hyne varfëria, papunësia etj....

kriminalitetit. Lidhur me këtë, disa bartës të programeve preventive në aktivitetet e veta mbesin vetëm dhe shumë shpejtë humbin motivimin për punë.

Ndërlidhja organizative me mileun social dhe institucionet në përgjithësi në zbatimin e programeve preventive, është hap jashtëzakonisht i rëndësishëm që nuk është i zbatueshëm pa pjesëmarrjen e ekspertëve që nga aspekti interdisiplinar do të japin udhërëfimin e nevojshëm shkencor– profesional për konkretizimin e përmbajtjeve preventive. Prandaj, çdo mungesë e bashkëpunimit, e koordinimit dhe e analitikës në parandalimin e kriminalitetit midis institucioneve shkencore, profesionale dhe institucioneve të tjera, shpie në margjinalizimin dhe kufizimin Brenda formave më pak të rëndësishme, joformale, jashtinstitucionale, sporadike ose deklarative të kundërvënies ndaj kriminalitetit.

**Shenjat themelore mbi parandalimin e kriminalitetit me vështrim të shkurtër mbi zhvillimin e tij historik**

Parandalimi i kriminalitetit nuk është kurrfarë risie. Në të vërtetë, qysh se njerëzit kanë qenë në pozicion të viktimës, janë paraqitur edhe përpjekjet e mbrojtjes së vetes dhe të mbrojtjes së familjes së vet. Mirëpo, nocioni "parandalimi i kriminalitetit" vetëm para do kohe ka marrë domethënien e grumbullit të ideve për luftë kundër kriminalitetit.

Në histori mund të identifikohen shumë aktivitete nga e kaluara e afërt që renditen në parandalimin e kriminalitetit. Në të vërtetë, " idetë e reja" dhe teknikat lidhur me parandalimin e kriminalitetit jo rrallë herë janë diçka më tepër se riinkarnim i përvojave të kaluara ose të perfeksionimit të qasjeve themelore në të kaluarën (e largët).

Format e prevencionit kanë ndryshuar me të madhe nga shekulli në shekull – prej hakmarrjes përmes përcjelljes, frikësimit, inxhinieringut shoqëror deri te dizajni fizik e më tej.

Përgjigjet më të hershme lidhur me kriminalitetin i janë lënë individit ose familjes së tij.

Nuk ka ekzistuar kurrfarë forumi shoqëror që do të intervenonte në emër të individit të dëmtuar. Në vend të kësaj, vetëndihma ka qenë e vetmja formë e luftës.

Ndëshkimi dhe hakmarrja kanë qenë forca lëvizëse përgjatë tërë historisë së hershme. Lex talionis, parimi "sy për sy", u ka dhënë legjitimitet aksioneve të individëve, të qytetarëve.

Ekzistimi i çfarëdo sistemi formal të kontrollit shoqëror është ide relativisht e re. Është lehtë e mundur të identifikohet "aktiviteti i policisë" në disa civilizime të mëhershme (siç është Perandoria romake ose Franca). Ato kanë qenë shumë më të koncentruara në qytete, vendosjen e rendit dhe të qetësisë publike kryesisht e ka bërë ushtria, kurse ç'është më e rëndësishmja, ligjet zbatimin e të cilave e ka siguruar kjo "polici" kryesisht kanë pasur të bëjnë me çështjet e shtetit qendror dhe fiset (përkatësisht mbretin). Për shkak të dobisë së limituar të këtyre formave të

hershme të policisë njerëzit kanë pasur nevojë për shfrytëzimin e mëtejshëm të metodave të vetëndihmës. Pushtimi i Anglisë nga ana e Normanëve më 1066 ka sjellë formën e obligueshme të vendosjes së rendit dhe të qetësisë nga ana e qytetarëve. Pas pushtimit, qytetarët, meshkujt kanë qenë të obliguar të ndahen në grupe me qëllim të disiplinimit reciprok. Nëse dikush nga grupi do ta dëmtonte grupin ose individin që nuk është anëtar i grupit, anëtarët e tjerë do të kishin për detyrë t'a burgosnin dhe ta sanksiononin kryerësin. Mosndërmarrja e aksionit vetvetiu ishte e dënueshme. Kjo praktikë në një pjesë të madhe ishte e dedikuar për mënjanimin e kërcënimeve ndaj monarkisë.

Përveç këtij aktiviteti të obligueshëm, paraqiten shumë forma të bashkëpunimit që mbështeten në pjesëmarrjen e qytetarëve në mbrojtjen e bashkësisë dhe të individëve të saj. Një praktikë e tillë "rojtarët dhe mburojat ("Watch and ward), pasqyrohet në mbajtjen e rojës përreth qytetit ose regjionit. Nëse individi do të identifikonte kërcënimin, do të shpallte alarmin dhe "ndjekjen" ("hueand cry"). Pastaj vendimi i takonte tubimit të përgjithshëm të qytetarëve që ta burgoste dhe dënonte keqbërësin.

Individët që i përgjigjeshin ftesës për ndihmë ishin qytetarë të rëndomtë. Qasja e përmendur në aktivitetet policore u kodifikua më 1985 në ligjet nga Winchesteri (Klockars, 1985). Përveç kësaj, ligjet gjithashtu i obligonin meshkujt që të kishin në dispozicion armë për shfrytëzim kur të ftohen ("assize of ams"), dhe definonin rolin e kryeoficerit ("constable"), që ishte pozitë pa pagesë e angazhuar për koordinimin e sistemit të rojës dhe të mbrojtjes e të mbikëqyrjes së aspekteve të tjera të ligjit. Këto ishin fillet e para të parandalimit të kriminalitetit që ishte përgjegjësia kryesore e qytetarëve.

Përgjegjësia individuale, shpeshherë vullnetare për parandalimin e kriminalitetit kryesisht ekzistonte deri në fillim të shekullit XIX.

Ajo që dallohet në këtë periudhë është zhvillimi i policisë së paguar, private të sigurisë për industritë ose grupet e specializuara.

Miratimi i Ligjit mbi hajdutët rrugor ("Highwayman Act") në Angli më 1692 vendos praktikën e pagesës së shpërblimit për individët që i zënë hajnat dhe e kthejnë pasurinë (në fillim ishte e dedikuar si mbrojtje e dërgesave të mallrave që shkonin nga qyteti në qytet), por kishte ndikim në opinionin e gjerë. Ishin bërë më të njohur si "kapës të hajnave". Deri kah mesi i shekullit XVIII, ata ishin të organizuar nën udhëheqjen e gjykatësve anglez për kundravajtje ("magistrates)". Për herë të parë u formua policia legjitime, e organizuar nën kontrollin e Qeverisë në Londër më 1829 (policia Metropolitan).

Përgjegjësia kryesore e zbatimit të ligjit dhe e mbrojtjes së opinionit kalon nga qytetarët në policinë e paguar profesionale. Çështje qenësore tek kjo organizatë e re policore ishte ideja mbi parandalimin e kriminalitetit. Ata e shihnin si parim themelor punën policore përmes metodave siç janë patrullat preventive, përmirësimi i ndriçimit të rrugëve dhe pastrimi i rrugëve.

Forcat formale të policisë, që e kopjonin lëvizjen në Angli, paraqiten nga mesi i shekullit XIX dhe ishin të kufizuara para se gjithash në qytetet më të mëdha amerikane dhe në verilindje, kurse qytetarët liheshin që edhe më tej të shfrytëzonin vetëmbrojtjen.

Ekzistojnë shembuj të shumtë të qasjeve alternative në luftë kundër kriminalitetit.

Dy shembuj kanë qenë shfrytëzimi i mureve dhe i hendeqeve rreth qyteteve për mbrojtjen e komunitetit nga invazioni i jashtëm.

Shumë qasje për të cilat tashmë është bërë fjalë përfshinin përcjelljen dhe mbikëqyrjen si instrument për identifikimin e problemeve para se ato të dilnin jashtë kontrollit. Edhe një formë e parandalimit kishte të bënte me ristriksionin në posedimin e armës së zjarrit, si mjet për eliminimin e sjelljes së dhunshme. Përkundër këtyre shembujve, trendi dominues para paraqitjes së policisë formale në shekullin XIX ishte mbështetja në aftësinë e individit që vetë të mbrojë veten.

Përveç policisë paraqiten edhe forcat e tjera që ballafaqoheshin me sjelljen kriminogjene dhe devijuese.

Fushat në rritje të psikologjisë dhe të sociologjisë nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX kishin filluar t’i hulumtonin shkaqet e sjelljes devijuese. Hulumtuesit kishin filluar t’i vërenin modelet përsëritëse (ku dhe kur ndodhnin veprat penale dhe kush vihej në lidhje me ato vepra) dhe t’i vinin këto fakte në lidhje me strukturën ndryshuese shoqërore dhe raportet personale. Rezultati logjik i këtij studimi në rritje ishin aktivitetet që do të fokusoheshin në sjelljen devijuese.

**Shpëtimi i atyre që janë më pak të lumtur**.- Shembull i formës së hershme “ të parandalimit të kriminalitetit” ishte formimi i gjykatës për të mitur dhe të përpjekjeve të saj për luftimin e problemit të varfërisë, të mungesës së arsimimit dhe të edukimit të keq ndër shtresat e ulëta të shoqërisë. Fëmijët merreshin nga familjet problematike dhe fqinjësia në përpjekje që t’ju ofrohet dashuria, edukimi dhe arsimimi i nevojshëm dhe të aktivizohen në jetën produktive. Filozofia parens patriae ishte qëndrimi që të rinjve u nevojitet ndihma, dhe se procesuimi pranë gjykatave të rregullta orientohej në dënimin në vend të parandalimit. Shtojcë e kësaj filozofie ishte zgjerimi i jurisdikcionit të gjykatës së të miturve në veprat statusore.

Besohej se shkelja e orës policore, pirja e duhanit dhe sjelljet e ngjashme ( nga të cilat asnjë nuk ishte përfshirë në ligjin penal) ishin indikacione për sjelljen e mëvonshme kriminogjene. Intervenimi lidhur me këto vepra statusore ishte mjet i parandalimi të kriminalitetit të mëvonshëm. Së këndejmi sistemi i të miturve ishte qartë përpjekje e parandalimit të kriminalitetit.

**Ndryshimi i teksturës shoqërore** .- Forma më e njohur e veprimit më të hershëm preventiv lidhej me Projektin e regjionit të Çikagos ku ishte konstatuar se kriminaliteti dhe delikuenca ishin të koncentruar në zonat qendrore të Çikagos. Fluktuimi i përhershëm i popullsisë rezulton në pamundësinë që njerëzit të bëjnë çfarëdo kontrolli shoqëror mbi individët në atë zonë.

Njerëzit më tepër brengoseshin për mirëqenien e situatës së vet dhe braktisjen e asaj zone sesa për përmirësimin e jetës dhe mbetjen në atë zonë.

Për këtë arsye kriminelët mund të vepronin po thuaj pa dënim në ato kuarte.

Zgjidhja e propozuar ishte puna e përbashkët me popullsinë në ndërtimin e bashkëjetesës, që do t'i inkurajonte njerëzit të mbesin dhe t'i vejnë nën kontroll aktivitetet e njerëzve në atë zonë.

**Pamja fizike e rrethinës**.- Parandalimi i kriminalitetit ndoshta kishte marrë nxitjen e vetë më të madhe me aplikimin e pamjes fizike të rrethinës. Të metat identifikoheshin si shkaqe ose nxitëse të sjelljes kriminogjene. Newman (1972), me profesion arkitekt, kishte paraqitur tezën që karakteristikat fizike të ndonjë zone mund t'u sugjerojnë banorëve dhe kriminelëve potencialë që ajo zinë ose është e ruajtur dhe e mbrojtur mirë, ose është e hapur për aktivitete kriminale. Newman ishte fokusuar në radhë të parë në mikrozonat e braktisura banesore. Willson dhe Kelling (1982) kishin zgjeruar këtë mendim në blloqe të tëra të qytetit:

- "Dritaret e thyera" kanë të bëjnë me shenjat fizike të moskujdesjes për zonën e caktuar (ndërtesat e braktisura, prania e hedhurinave, dritaret dhe dritat e thyera, grafitet etj) që u sinjalizojnë kriminelëve potencialë se aty nuk është askush që do t'i parandalonte.
- Shenjat shoqërore të problemit të njëjtë mund të jenë papunësia e rinisë, pijanecët në rrugë, prostitucioni dhe të pastrehët. Indikatorët fizikë dhe shoqërorë interpretohen si shenja të moskujdesit që i tërheqin kriminelët në atë zonë. Me mënjanimin e shenjave të tilla zona do të duhej të dukej më i mbrojtur dhe më pak vend premtues për kriminalitet.

Kjo shpinte në një numër të madh të hulumtimeve dhe të intervenimeve viteve të 70-ta dhe të 80-ta të shekullit të kaluar, kur ishin aplikuar programe qëllimi i të cilëve ishte ndryshimi i ndërtesave publike banesore, ndryshimi i komunikacionit dhe i rrugëve, vendosja e dritës dhe të bravave më të mira, pastrimi i ndërtesave dhe i kuarteve, pastaj lëvizja e interaksionit midis qytetarëve. Qëllimi ishte i dyfishtë – të inkurajohen qytetarët që të ndërmarrin kontrollin në zonën ku jetojnë dhe t'u dërgohet sinjali kriminelëve potencialë që për ta në atë zonë ekziston rreziku i shtuar.

Organizimi i opinionit – ndryshimet fizike të rrethinës nuk mund ta ndalin plotësisht kriminelin, as nuk mund ta zënë dhe nuk garanton inkuadrimi e banorëve në aksion, dhe për këtë arsye është i domosdoshëm angazhimi aktiv i qytetarëve bashkë me ndryshimin e pamjes fizike të rrethinës.

Viteve të 70-ta të shekullit të kaluar ishte rritur në mënyrë drastike numri i programeve më të njohura si "roje në fqinjësi" ("Neighborhood/Block Watch"). Këto programe udhëhiqeshin nga ajo që:

- kriminelët potencialë nuk do të bënin vepër penale nëse vërejnë aktivitetet e qytetarëve dhe kujdesin në zonën e caktuar, - komponentë tjetër kishte të bënte me pranimin e policisë që vetë

nuk mund ta ndalte kriminalitetin, as t'i zgjidhte problemet, prandaj ishte e domosdoshme që të merrnin ndihmën aktive nga qytetarët, numri më i madh i të cilëve bënte pjesë në rojën në fqinjësi. Ky lloj i mbikëqyrjes ndryshon nga vendosja e dritave, deri te mënjanimi i pengesave në mënyrë që gjërat të mos ua zinin horizontin, e ka dy elemente të përbashkëta:

- anketat e sigurisë - shërbimi i qenësishëm që ofronin shumë grupe ku grumbulloheshin informatat që formonin bazën për shënimin e pasurisë, instalimin e bravave më të mira, njoftimin e fqinjëve kur shtëpia të jetë e zbrazët, lënia e dritës së ndezur edhe kur nuk jeni në shtëpi dhe mënjanimi i shenjave sipas të cilave dihet se në shtëpi nuk është askush (siç është bari i rritur ose sënduku i plotë postar) dhe
- distribuimi i risive mbi kriminalitetin dhe parandalimin e kriminalitetit. Kjo mund të arrihet me anë të mbledhjeve.

Rezultatet e evoluimit tregojnë se pjesëmarrja dhe veprimi i drejtpërdrejtë i qytetarëve është më efikas sesa të nisen nga ajo që do të pasojë pas ndryshimit të pamjes fizike të rrethinës.

Problemet më të shpeshta paraqiten tek vetë organizimi i bashkësive dhe i zonave të cilave më së shumti u nevojitet ndihma.

Përkundër këtij fakti, shumë drejtori policore dhe bashkësi ndërmerrnin përpjekje të mëdha për organizimin e qytetarëve dhe sigurimin e përkrahjes së tyre në aktivitetet për parandalimin e kriminalitetit.

Qasjet situacionale - qasja më e re në parandalimin e kriminalitetit është fokusimi i aktivitetit dhe intervenimi për zgjidhjen e problemeve specifike, në vend dhe në kohë. Clarke (1983) propozon parandalimin situacional si “masa që janë të orientuara në forma shumë specifike të kriminalitetit që përfshijnë” ndryshimet në pamjen e rrethinës, e të cilat “do të zvogëlojnë mundësinë për kriminalitet dhe të shtojnë rreziqet e tij”.

Shembujt e parandalimit situacional përfshijnë vendosjen e pajisjes për mbikëqyrje në vendparkingje në të cilat është e shpeshtë dukuria e vandalizmit, montimi i vizirëve të sigurisë në sportelet e bankave në mënyrë që të pengohen vjedhjet, ndryshimet e regjimit të komunikacionit me fqinjësi ku shitet droga, shfrytëzimi i kartelave elektronike për lëndën bibliotekare dhe aplikimi e shërbimeve të regjistrimit të numrit të thirrjes në telefonin me rastin e pranimit të ftesave vulgare.

**Perfundime dhe rekomandime**

Jemi te mendimit se parandalimi nënkupton shumësin e të gjitha masave, të mjeteve dhe të teknikave jashtë suazës së sistemit të jurisprudencës penale, që kanë për qëllim zvogëlimin e llojeve të ndryshme të dëmeve të shkaktuara me vetë ekzekutimin e veprës, që shteti i ka shënuar ose inkriminuar në Ligjin e vet penal si vepër penale.

Në procesin e definimit të parandalimit të kriminalitetit problemi që shkoqitet është plotësisht i qartë duke pasur parasysh vetë natyrën e tij.

Në këtë mënyrë parandalimi paraqet kompleksin më të gjerë të politikës bashkëkohore kriminale.

Qëllimi i parandalimit të kriminalitetit është pengimi i një vargu të tërë të veprimeve të ndryshme kriminale siç janë: deliktet pasurore, deliktet lidhur me drogën, deliktet e dhunës pastaj, sot për opinionin delikti interesant dhe shumë i shfrytëzuar nga ana mediale i kriminalitetit të organizuar.

# ABSTRACTS

# PËRFAQËSIMI DHE RRËGULLIMI ME LIGJ I TIJ NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

**Bsc. Armand Braho**

(**a.braho17@eust.edu.mk**)

**Msc. Amarilda Dule**

(**a.dule@eust.edu.mk**)

**Abstrakt**

Përfaqësimi është një ndër institutet më të rëndësishme në të drejtën civile. Ajo lind në momentin kur një person, ka nevojë imediate që t'ja delegojë të drejtat një personi tjetër, për arsye personale ose ligjore.

Në Republikën e Shqipërisë përfaqësimi është rrëgulluar mjaftë mirë në Kodin Civil të vendit. Në të njëjtin, rrëgullohen me përpikmëri mbartja e të drejtave të përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit, që nga moment që lind kjo marrëdhjënje juridike deri sa ajo shuhet.

Jo në të gjitha ç'ështjet mund të kemi përfaqësues, në të Drejtën Civile, përcaktohen dhe këto raste, që specifikiohen me detaj dhë në këtë punim. Që nënkuptohet se jo gjithçka mund të jetë e drejtë për t'u dhënë për përaqësim. Në këto raste ruhen të drejtat e individit, kryesisht në shprehjen e vullnetit direkt.

Përfqësimin mund ta shohim në tre forma të cilat janë: ( Përfaqësimi Ligjor, Përfaqësimi Statuor dhe Përfaqësimi më Autorizim ( Prokurë ). Të njëtjtat herë janë të drejta të garantuara dhe hërë janë të drejta të dhuruara.

**Fjalë Kyçe:** *Përfaqësim, E Drejtë, Delegim, Institut.*

# MONITORING THE IMPLEMENTATION OF REPORTING STANDARDS, AN INSTRUMENT OF THEIR CONTINUOUS IMPROVEMENT

**Ph.D (c) Brikena Tolli**
**Marin Barleti University**
**(brikenatolli@gmail.com)**

**Abstract**

Current practice shows that there are various problems in applying financial reporting standards by for-profit or non-profit entities. Incorrect implementation is related to several factors, including the degree of difficulty in formulating the standards or in other words the lack of comprehensive guidance on their correct application by all entities. The lack of a monitoring structure for their implementation does not allow the field regulator to accurately identify problems in the implementation of standards that are directly related to the standard itself. Nothing would be resolved by a monitoring unit, if it were about an unwillingness or lack of incentives for an entity to present its financial statements in a truthful and reliable manner. There are other mechanisms that need to be incorporated into legal or sub-legal acts that, together with clarity and understanding of standards, would make standards easily and voluntarily enforceable.

In the new law on accounting and financial statements such a competence, the monitoring of financial statements in the light of the implementation of MRS and IFRS, is entrusted to the NQF, but the approach and operating procedures of such an entity are not determined.

This paper aims to analyze the approaches and procedures of some standard drafting bodies in developed countries in Europe with the aim of identifying the most successful international practices that can be effectively applied in our country.

The paper will present an introduction to the problem, a review of the literature on the issue raised for discussion, the findings, and their analysis. In the end the paper ends up with conclusions and recommendations.

**Keywords:** *NAS, IFRS, Financial reporting , Monitoring of IFRS.*

# KOMUNA SI VETËQEVERISJE LOKALE

**BSc. Marina Rrika**

**(m.rrika@eust.edu.mk)**

**BSc. Marta Geshtenja**

**(m.geshtenja@eust.edu.mk)**

**Abstrakt**

Qëllimi i këtij punimi është të hulumtojmë dhe kuptojmë rolin e komunës si vetëqeverisje lokale lidhur me mënyrën e funksionimit dhe organizimit të saj. Kjo ka qënë edhe arsyeja e cila na nxiti që të zgjedhim pikërisht trajtimin e kësaj teme, duke sjellë në vëmendje komunën si pjesë e vetëqeverisjes lokale në Republikën Maqedonisë së Veriut, më konkretisht analizimin e Komunës së Strugës.

Ky punim ka në thelb studimin dhe analizën e funksionimit të saj dhe përgjigjen e hipotezës:

a) A funksionon informimi i qytetarëve rreth buxhetit, fondeve, projekteve dhe funksionimin konkret të Komunës së Strugës?

**Fjalë kyçe:** *Komuna e Strugës, Ndarje administrative, qytetarë, informim, vetëqeverisje.*

# EMIGRIMI I KAPITALIT NJERËZOR NGA REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

**Prof.Dr. Gëzim Selimi**

**(g.selimi@eust.edu.mk)**

**Abstrakt**

Çdo vend (shtet) që t'i realizon qëllimet dhe strategjinë e përcaktuar, detyrimisht duhet jo vetëm të disponon me burime (resurse) të nevojshme, por edhe t'i përdorë të njëjtat në mënyrë sa më racionale, efikase dhe efektive. Faktorët e prodhimit apo burimet me të cilat disponon një shoqëri tregtare janë: toka, kapitali, puna dhe sipërmarrësi ose thënë ndryshe: burimet financiare, fizike, të informacionit dhe ato njerëzore (humane).

Kur flasim për burimet njerëzore mendojmë për njerëz të cilët i kryejnë punët, puna e të cilëve kërkon organizim për realizimin e qëllimeve. Ata kanë vlerë dhe dobishmëri duke qenë se ndihmojnë në procesin e prodhimit apo ndihmojnë në zinxhirin krijimit të vlerës të shfrytëzueshme. Njerëzit janë pasuria më e madhe e një vendi, andaj është e papranueshme që ata të barazohen me faktorët tjerë të prodhimit.

Për realizimin e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik çdo vend, së pari, duhet të sigurojë burime materiale dhe financiare dhe së dyti, edhe burimet e nevojshme njerëzore, që kanë qenë dhe akoma janë burimi më i çmuar dhe më i dalluar i çdo vendi. Qeveria e çdo vendi i realizojnë qëllimet dhe strategjinë e vendosur me anë të njerëzve, me aktivizimin e burimeve njerëzore, duke shfrytëzuar përpjekjet fizike e mendore të tyre në pozita dhe vende të caktuara në bazë të strukturës së caktuar organizative. Burimet njerëzore kanë rëndësi jetësore dhe vendimtare për suksesin e veprimtarisë së çdo ekonomie vendore. Burimet njerëzore janë burimi më i mirë që mund të çojë vendin në përparësi konkurruese ndaj vendeve tjera dhe luan rol të rëndësishëm si në arritjen e qëllimeve organizative ashtu edhe në plotësimin e objektivave tjera të vendit.

**Fjalë kyçe:** *Emigrim, kapital njerëzor, zhvillim, faktorë.*

# TË DREJTAT E NJERIUT DHE SFIDAT E SË ARDHMES

**MSc. Abidin TRENA**

**a.trena@eust.edu.mk**

## Abstrakt

Suksesi në realizimin e të drejtave të njeriut kërkon sukses edhe në fusha të tjera, përfshirë ndërtimin e qeverive më të afta, të përgjegjshme, të efektshme dhe jo të korruptuara, që kanë të bëjnë me shtetet e dështuara, rritjen e produktivitetit ekonomik, përmirësimin e statusit të fuqisë së grave, përmirësimin e arsimit, etj. dhe menaxhimin e tensioneve ndërkombëtare dhe konflikteve. Realizimi i të drejtave të njeriut në të gjithë botën është një punë e vështirë që kërkon shumë veprimtarë që kryejnë lloje të ndryshme pune. Të drejtat e njeriut tani pranohen më gjerësisht sesa janë pranuar ndonjëherë. Ato bëhen pjesë e monedhës së marrëdhënieve ndërkombëtare, dhe shumica e vendeve marrin pjesë në sistemin e të drejtave të njeriut. Megjithatë, duke i analizuar trendet bashkëkohore dhe nevojat e shoqërisë sës sotme, të drejtat e njeriut nuk janë në nivelin e duhur qoftë për nga zbatimi i tyre, qoftë për nga rregullimi që i'u është bërë atyre me kodifikimet juridike nga shtetet individuale.

**Fjalë kyçe:** *e drejtë, sfidë, barazi, evoluim*

# ADVENTAGES AND DISADVENTAGES ON USING VIDEOS IN THE CLASSROOM

**Rezarta Merko**
**rezarta.merko@eust.edu.mk**
**International University of Struga**

**Reis Kerim**
**r.kerim@eust.edu.mk**
**International University of Struga**

**Abstract**

Thanks to the internet and thanks to the global economy the world is becoming smaller. People every day try different methods to learn English language. People more and more use English language as a way to communicate between each other. But learning language today is very much related to technology. Technology is used in all aspects of life; it is included into most college projects and is required for every type of employment. Nowadays students need strong computer skills in order to compete in the global economy, which has pushed many countries towards integrating plans to ensure that graduates are ready to compete in the 21st century.

Surely it can't be argued that today's students need strong computer skills but integrating technology into the classroom is more than teaching essential computer skills. Technology can provide a richer, interactive learning experience and environment. There are many different ways how teachers can use technology in their classrooms, and each method provides several different benefits for students.

Education as a main factor for people’s professional and non-professional development is making a progress by changing the methods for teaching and learning, adding new prototypes of teaching, introducing new ideas, using new technologies in its curricula.

In order to make the process of second language learning easier teachers must consider successful second language acquisition as one of their main goals and they must try to use all methods to make it quicker, more effective, easier, and logical.

**Keywords:** *using videos, classroom activities, era of computers, ESL, using technology*

# POLITIKA E ZGJËRIMIT TË BE-SË, SFIDAT E EVROPIANIZIMIT TË R. TË MAQEDONISË (SË VERIUT) PAS MARRËVESHJES TË PRESPËS

**Msc. Senada Laçka( phd can.)**

**(s.lacka@eust.edu.mk)**

**PhD. Shemsije Demiri**

**(sh.demiri@eust.edu.mk)**

**PhD. Guximtar Rushani**

**(g.rushani@eust.edu.mk)**

**Abstract**

Qëllimi i këtij studimi është trajtimi i procesit të zgjërimit evropian dhe impaktin e tij në Ballkanin Perëndimor, duke ofruar nje prezantim sistematik të literaturës për sa i përket kuadrit konceptual dhe teorik mbi Zgjërimin Evropain dhe Evropianizimin në vendet kandidate si dhe të rasteve studimore nga vendet e Ballkanit Perëndimor.Nga njëra anë, trajtohet debati mbi zgjërimin dhe evropianizimin e vendeve kandidate kurse nga ana tjetër, pasqyron transformimet aktuale që po kalon rajon si rezultat i procesit të integrimit evropian.

Europa nuk ka qenë kurrë më e lirë dhe më e sigurtë se sa që është tani. Luftrat dhe dhuna e shkaktuar në shekullin e XX, Evropës i ka hapur një rrugë drejt paqes, stabilitetit dhe prosperitetit të gjithëmbarshëm. Krijimi i Bashkimit Evropian ka qenë themelor në këtë zhvillim, ai i ka transformuar mardhëniet ndërmjet shteteve dhe jetën e qytetarëve Evropianë.Vendet Evropiane kanë premtuar të përballen paqësisht me veshtirësitë dhe të bashkvëprojnë nepërmjet institucioneve të caktuara. Zgjërimi i suksesshëm i BE-së do ishte një vizion që Kontinenti Evropian të jetë i bashkuar,  paqësor dhe me një zhvillim ma të mire ekonomik.

Para një viti e gjysmë, veçanërisht pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës, takimet e Samitit Evropian në vendin tonë perceptohen si një ngjarje që do të përcaktojë nëse do të jemi apo jo pjesë e BE-së. Samiti i fundit në mes të tetorit 2019 nuk bën përjashtim nga ky rregull. Në ditët e ardhshme, vendet anëtare të BE-së do të ulen përsëri në tryezë për të provuar të arrijnë një konsensus nëse do të mbështesin rekomandimin e Komisionit Evropian që vendi ynë të fillojë negociatat e pranimit.

**Fjalë Kyçe**: *BE, Ballkani Perëndimor, Evropianizim, Zgjërim.*

# ZHVILLIMI I MARRËDHËNIEVE EKONOMIKE DHE TREGTARE TË VENDEVE TË RAJONIT TË BALLKANIT

**Msc. Semra Bujari**

**s.bujari@eust.edu.mk**

**Rezarta Mamudi**

**r.mamudi@eust.edu.mk**

## Abstrakt

Gadishulli i Ballkanit - Gadishulli Ilirik, është një rajon gjeopolitik dhe kulturor i Evropës juglindore. Emri "Ballkan" vjen nga fjala turke qe do të thotë "një zinxhir i maleve te pyllëzuara".Gadishulli Ballkanik shtrihet në Evropën Jugore dhe ka formën e një trekendeshi, që futet thellë në Detin Mesdhe, midis Detit Adriatik, Detit Jon në perëndim, dhe Detit Marmara e Detit Egje në lindje. Pozita e se ciles eshte shume e veçantë me klimë te volitshme.

Ballkani, që nga vitet 1990 e deri më sot, nuk bën pjesë në rajonet me rritje ekonomike në botë. Përkundrazi, sipas llogaritjeve të bëra, tregohet se pjesa e vendeve të Ballkanit brenda Prodhimit të Brendshëm Bruto sa vjen edhe tkurret. Ajo që është më dramatike është se në dy shekujt e fundit distanca e mirëqenies mes Evropës Perëndimore dhe Ballkanit sa vjen e rritet edhe më shumë.

Deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, vendet e Ballkanit në përgjithësi, vazhduan ekonominë bujqësore dhe në drejtimin e tregtisë mbetën të varura nga vendet Perëndimore. Ndërsa pas Luftës së II Botërore, Bashkimi Sovjetik, përveç Greqisë, arriti të eksportojë në Ballkan sistemin ekonomik që njihet si planifikim qendror.

Luftërat e Ballkanit të përjetuara gjatë viteve 1912-1913 dhe luftërat botërore të përjetuara më pas gjatë viteve 1914-1918 dhe 1939-1945, përkeqësuan edhe më shumë gjendjen social-ekonomike në Ballkan. Shtetet e Ballkanit kishin marrë borxhe, ishin dëmtuar ekonomikisht dhe kishin përjetuar humbje të mëdha në popullsi.

**Fjalë Kyçe:** *vendet e ballkanit, zhvillimi ekonomik, integrimi, tregtia, investimet.*

# DIRECT LEARNING STRATEGIES

**Msc. Xhiljola Abdihoxha**
**(xhiljola_a@yahoo.com)**
**Marin Barleti University**

**Abstract**

The focus of this research paper is the use of direct strategies, such as Cognitive Strategies, Memory Strategies and Compensation Strategies in order to enhance the performance in the four language skills (writing, reading, speaking and listening). The paper will be mainly focused on the specific ways how the subsets of the above-mentioned strategies work together to facilitate the process of learning a foreign language (such as creating mental linkages, applying images and sounds, semantic mapping, associating/elaborating etc.).

In this research paper it is clearly shown how some direct strategies, (such as taking notes), work across all four skills, whereas some others, (like getting the idea quickly), are efficient for only a subset of skills. But, in order to have good results from the use of direct strategies, a good collaboration with indirect strategies, is vitally needed.

The purpose of this paper is also to show in a very practical and effective way the cooperation of these elements for a better understanding and memorization of a new language.

**Keywords** – *direct learning strategies, mental linkages, grouping, semantic mapping , mechanical techniques, acquisition of a new language, retrieve target language information, practice, analyze, recombine, deductive reasoning, translate, guess, coin words*

# PARANDALIMI I KRIMINALITETIT

**Doc. Dr. Dashmir Nasufi**

**International University of Struga**

## Abstract

Termi prevencion është huazuar në mënyrë pragmatike nga vokabulari dhe praktika mjekësore. Në kuptimin e vetë të gjerë janë profiluar dy përmbajtje themelore të këtij nocioni. I pari prej tyre ka të bëjë me intervenimin si formë primare e prevencionit. Kjo qasje në esencë ka shënuar intervenimin ndaj dukurive të caktuara me mjete të përcaktuara që më parë. Përmbajtja e dytë lidhet me prefiksin pre që shënon reaksionin e parakohshëm, më saktësisht reaksionin para se të jetë manifestuar dukuria e padëshiruar.

Në gjuhën latine, praeventio (prae-venio, veni, ventum, praeventus, praevenire) shënon përcaktimin dhe termin e kaloj, arrijë përpara, e kapërcej një dukuri të caktuar, ose si siç do të mund të thuhej në bazë të mendjes së shëndoshë parandalim, mbrojtje paraprake, pengim, shmangie që më parë. Që nga shekulli XV në praktikën angleze socio – politike dhe kriminale – politike përdoret shprehja prevent, me të cilën dëshirohet të theksohet çdo përmbajtje me të cilën në periudhën e ardhshme do të pengohen sjelljet e dënueshme në kuptim të ngushtë të përcaktimit të tyre. Nga kategorizimi i cekur më parë, mund të vërejmë se nocioni parandalim përmban në vete të gjitha masat e ndërmarra në mënyrë të planifikuar, të paramenduar dhe të organizuar me të cilat do të bëhen përpjekje të mënjanohen ose së paku të zvogëlohen shkaqet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të sjelljeve të dënueshme (Horvatiq, Cvitanoviq, 1999). Disa autorë me parandalimin nënkuptojnë vetëm atë lloj të aktivitetit që ndërmerret në drejtim të pengimit të kriminalitetit nga ana e opinionit, bashkësisë lokale, organeve dhe shërbimeve në përgjithësi, (Van, Dijk, De Waard 1991).

**Keywords** – *Parandalim, kriminalitet, e drejtë, penale*

The Heritage

Çmimi 15 Euro

ISSN 1857-7482
10.21520/R.22-2019